

GIOVANNI BOCCACCIO

DEKAMERONI

NOVELA DHE TREGIME

BOTIMET TOENA

GIOVANNI BOCCACCIO

DEKAMERONI

novela dhe tregime

Përktheu nga origjinali italisht
Ali Hashorva

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2020

Autori: Giovanni Boccaccio (Xhovani Bokaço)
Titulli në origjinal: Decameron

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Redaktore: Anrila Spahija
Korrektore letrare: Edona Marku
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-96-1

© *në shqip* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

Mbi përkthimin e këtij libri

Babai im, Ali Hashorva, shkruan në kujtimet e tij se e kishte filluar përkthimin e këtij libri gjatë pushimeve të verës së vitit 1927, kur qe student në Firence, dhe punoi për të deri në vitin 1932, kur mbaroi universitetin. Në këtë kohë kishte përkthyer më shumë se gjysmën e librit, 60 rrëfenja. Më pas, gjatë punës në Shqipëri, me transferime të herëpashershme, pothuaj i gjithë ky përkthim humbi.

Në gusht të vitit 1948, e rifilloi përkthimin dhe me intervale të lira midis punëve të shkurtra dhe pushimeve të gjata, punoi deri në dhjetor të vitit 1955, vit në të cilin e mbaroi.

Në një periudhë të zbutjes së klimës politike në vend, aty nga viti 1958, Ali Hashorvën e lejuan të fillonte punë në Shtëpinë Botuese “Naim Frashëri” si korrektor letrar. Duke përfituar nga rasti, paraqiti aty disa përkthime të bëra deri në atë kohë, midis të cilave edhe “Dekameronin”. Drejtori i atëhershme i asaj shtëpie botuese, Drago Siliqi, i pa përkthimet dhe i vlerësoi tej mase. Ai dha urdhër që disa prej tyre të daktilografoheshin menjëherë me qëllim botimi e pastaj të shiheshin dhe të tjerat. Ndërmjet atyre që u daktilografuan dhe u botuan në atë kohë ishte edhe “Dekameroni”, por u vendos të botohej vetëm gjysma e tij, pasi pjesa tjetër u gjykua si e papërshtatshme për lexuesin e asaj kohe dhe, ndofta, ishte e drejtë. Ai libër u botua në vitin 1959. Më pas, me shtrëngimin përsëri të klimës politike, nuk u bë më fjalë për botimin e shumë përkthimeve të mbetura. Kështu, një numër librash të përkthyer mbetën në formë dorëshkrimesh me laps, të cilat, sot, të dëmtuara nga koha, gati nuk kanë mundësi të restaurohen.

Unë deri vonë nuk bëra ndonjë përpjekje për restaurimin dhe botimin e këtyre përkthimeve, pse kisha fushën time të punës dhe shkrimeve që ishin të ndryshme prej tyre. Megjithatë, falë një këshille që më dha zoti Nasho

Jorgaqi në vitin 2000, i cili kishte parë dikur në Shtëpinë Botuese “Naim Frashëri” përkthimin e babait tim të librit “Maria Antoneta” të Cvajgut dhe e kishte pëlqyer, më sugjeroi që ta çoja për botim te Shtëpia Botuese “Omska”. E çova dhe ajo e botoi menjëherë.

Në qershor të vitit 2017, gazeta Drita botoi një shkrim të Moikom Zeqos për historinë e përkthimit të “Dekameronit” në shqip, sipas së cilit, kishte qenë De Rada i pari që e kishte përkthyer këtë vepër dhe, më pas, po në atë shkrim, zoti Zeqo shtonte:

“Vite më parë në rininë time kam lexuar përkthimin në shqip të “Dekameronit”, bërë mjeshtërisht nga një njeri i kulturuar i quajtur Ali Hashorva, emri i të cilit duket sikur sot ka mbetur në humbëtitë dhe në harresë.

“Përkthimi i përkorë, me frazeologji të mrekullueshme të shqipes, i Ali Hashorvës është një nga përkthimet më të mëdha që janë bërë ndonjëherë në gjuhën shqipe” dhe, më pas, për ilustrim, jepte një fragment nga përkthimi.

Nëse ky vlerësim është i drejtë apo jo, mbase nuk ka shumë rëndësi, por ka rëndësi se ishte pikërisht ky vlerësim i Moikomit që më bëri mua të lija punët e mia dhe të merresha me ringjalljen e disa përkthimeve të babait tim, të cilat i kishte zënë pluhuri dhe i kishte fshirë koha. Deri tani, kam botuar dy prej tyre: “Skënderbeu”, i Aleksandër Kutolos dhe “Princi” i Makiavelit të cilat kishin qenë të daktilografuara nga Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”. “Dekameroni” ishte pjesërisht i daktilografuar. Atij i mungonte një e treta, por kisha dorëshkrimin. Pjesën e daktilografuar e hodha vetë në kompjuter, ndërsa pjesën tjetër ma hodhi një daktilografiste profesioniste kundrejt pagesës. Pastaj punova intensivisht me të mbi një vit dhe e përgatita për botim.

Në përgatitjen për botimin e këtij varianti të “Dekameronit” pata kujdes të ktheja gjuhën shqipe të mbi shtatëdhjetë vjetëve të shkuara, në gjuhën e sotme standarde shqipe, të shmangia disa prej fjalëve turqisht që përdorshin atëherë në të folurën popullore dhe të përdorura në këtë libër, si dhe të shmangia disa fjalë apo shprehje dialektore. Gjithashtu aty-këtu kam bërë disa saktësime dhe redaktime të vogla, duke u konsultuar edhe me një përkthim të mirë në anglisht të këtij libri. Të gjitha këto i kam bërë duke pasur kujdes që të mos ndryshoja stilin e përkthimit.

Në shënimet që ka lënë mbi përkthimin e “Dekameronit”, Ali Hashorva, ndërmjet të tjerave, thotë: “... Duhet vënë re se përkthimit jam munduar t’i

jap pak ngjyrë të vjetër dhe popullore, sipas natyrës së rrëfenjave, prandaj jam shtrënguar të përdor dhe ca fjalë turqishte, që hasen përgjithësisht në gjuhën e popullit. Jam përpjekur të mos përdor fjalë të huaja që kanë hyrë kohët e fundit në gjuhën shqipe, me përjashtim të disa të paktave... Jam përpjekur t’i mbahem besnik origjinalit, duke i dhënë njëkohësisht një frymë dhe dukje shqiptare. Emrat historikë i kam lënë të pandryshuar, kurse të tjerët, aty-këtu, i kam shqipëruar ose u kam dhënë trajtën shqipe.”.

Shënimet e vendosura në fund të rrëfenjave janë të gjitha të përkthyesit.

Duhet pasur parasysh se Bokaçoja është bashkëkohës i Dantes dhe i Petrarkës. Gjuha e tyre është ajo që flitej në shekullin e katërmëdhjetë në Itali, pra një gjuhë e vjetër italiane, jo e lehtë për t’u kuptuar sot, por fatmirësisht është në dialektin fjorentin, dialekt nga e ka bazën italishtja standarde e sotme. Bokaçoja të “Dekameroni” ka përdorur gjuhën e të folmes popullore fjorentine të asaj kohe. Ndërsa kryevepra e Dantes quhet “Komedia hyjnore” kryevepra e Bokaços mund të quhet “Komedia njerëzore”.

Pasi të jetë lexuar, lexuesi do të ketë në dorë të përcaktojë nëse vlerësimi që i bën Moikom Zeqo këtij përkthimi është apo jo i drejtë.

Ilir Hashorva, Nju-Jork, 2019

Xhovani Bokaço, i biri i një tregtari të quajtur Bokaço di Kelino (Boccaccio di Chellino) prej Çertaldoje (Certaldo) dhe i një gruaje të panjohur, u lind në vitin 1313, ndofta në Paris. I ati e dërgoi të vogël në Firence për të mësuar fillimet e gramatikës. Më pas u përpoq ta bënte tregtar dhe e dërgoi në Napoli, pranë tregtarësh të ndryshëm për t'i ngjallur dëshirën e tregtisë. Por Xhovani nuk dha prova të mira në këtë mjeshtëri dhe aty nga viti 1330 u vu të studionte të drejtën ekonomike, duke u marrë njëkohësisht me poezi, prej të cilave tërhiqej shumë. Kështu, ai hartoi një numër vjershash, të cilat i dogji sapo njohu Petrarkën.

Më 1362, kur fama e Bokaços ishte përhapur në gjithë Italinë, njëfarë Pjetër Petroni, që njihej si shenjti, kur ishte duke vdekur, porositi një nga shokët e tij që të vinte t'i thoshte Bokaços, në formë qortimi, që të hiqte dorë nga studimet profane dhe t'u kushtohej atyre të Perëndisë, përndryshe e kishte të shpejtë vdekjen dhe do të dënohej në ferr për jetë të jetëve. Nga kjo Bokaçoja u trondit dhe vendosi t'i nënshtrohej këtij urdhri. Vendimin ia bëri të ditur Petrarkës, por ky e porositi që librat t'i mbante, por të përpiquej të bënte një jetë më korrekte, duke frenuar pasionet.

Më 1373 Bokaçoja u sëmur dhe u tërhoq në Çertaldo për të shkuar me studime pjesën e fundit të jetës. Ai ndërroi jetë më 21 dhjetor të vitit 1375, duke lënë të bashkëkohësit e te të pastajmit kujtimin e një njeriu shpirtmadh, zemërmirë e mendjendritur.

Është një përkim i bukur që tre nga mendimtarët dhe shkrimtarët më të mëdhenj italianë: Dantja (1265-1321), Petrarka (1304-1375) dhe Bokaçoja (1313-1375) ishin afërsisht bashkëkohës dhe bashkëvendës: të tre në të njëjtin shekull e të tre nga Toskana.

Bokaçoja shkroi në prozë e në poezi, në italisht e në latinisht. Përveç "Dekameronit", që është kryevepra e tij dhe që e ka bërë të përmendur si një nga shkrimtarët më të mëdhenj të njerëzimit, ka shkruar edhe një sërë veprash të tjera, por këto përgjithësisht sot kanë rënë në harresë. Vepra që, me gjithë të metat e saj, ka mbetur si përmendore e përhershme e që lexohet

e studiohet prej të gjithëve, që është përkthyer në të gjitha gjuhët e botës dhe prej së cilës janë frymëzuar shkrimtarë të përmendur të botës, është “Dekameroni”.

Në këtë vepër Bokaçoja përfytyron sikur në kohën e murtajës së vitit 1348, shtatë vasha dhe tre trima florentinë, të ikur nga Firencja për t’i shpëtuar lëngatës, ishin tërhequr në një vilë në kodrat rrotull Firezolës, ku qëndrojnë për pesëmbëdhjetë ditë. Këtu ky grup të rinjsh, për të harruar mjerimin e sëmundjes, e shkonte kohën me dëfrime e gëzime, dhe në vapëherë, për dhjetë ditë, secili, në çdo ditë, kallëzon nga një rrëfenjë. Kështu, “Dekameroni”, fjalë që në greqisht do të thotë *dhjetë ditët*, është një përmbledhje prej njëqind rrëfenjash mbi tema të ndryshme, disa syresh të marra nga populli, disa nga autorë klasikë e disa të tjera nga burime të Lindjes. Një pjesë, më tepër se rrëfime, janë anekdota mbi persona historikë të kohës së autorit dhe të marra nga goja e popullit.

Me “Dekameronin” Bokaçoja fitoi emrin si shkrimtar nga të radhës së parë, si prozator i përsosur, si krijuesi i rrëfenjës klasike dhe si model i kallëzimitarit të mbaruar. Me këtë vepër ai hodhi themelet e prozës italiane, e cila sapo kishte lindur dhe s’kishte marrë edhe një drejtim të qëndrueshëm. Me Bokaçon proza italianë fitoi fuqi dhe rrjedhësi. Stili i tij është i lëvizshëm, i ëmbël dhe plot hir e elegancë. Duke iu përshtatur rasteve e ngjarjeve, Bokaçoja herë ndihet i lartë e madhështor, herë i përmbajtur, herë komik, herë tragjik, herë familjar, herë elokuent. Gjuha që përdor është popullore dhe jo letrare. Këtyre dhuntive të formës së jashtme u duhen shtuar njohja e thellë prej tij e të metave dhe dobësive të fisnikërisë si dhe zotësia e pakrahasueshme prej kallëzimitarit të përsosur që kalon pa vështirësi nga një ngjarje gazmore në një tjetër serioze e anasjelltas, duke u përshtatur të gjithave stilin, ngjyrën e tonin, pa iu shmangur kurrë të kallëzuarit të gjallë e të natyrshëm. Bokaçoja është një nga humoristët më të thellë dhe nga pikturuesit më të gjallë të karaktereve në letërsinë italiane.

Por këto dhunti të rralla dhe të shquara të shkrimtarit, e humbasin pak vlerën e tyre për shkak të një të mete të rëndë që na shfaqet te “Dekameroni”. Bokaçoja ka një mënyrë të shprehuri të shfrenuar e nganjëherë të neveritshme. Për këto të meta autori që kritikuar nga bashkëkohësit e tij dhe kritikohet ca më shumë sot, kur qytetërimi modern s’mund t’i tresë disa përshtime të paraqitura troç në realitetin e tyre të ndotur, ndonëse ka qenë i shtyrë, ndofta, nga dëshira për të na dhënë një pasqyrë besnike të gjendjes së kohës së tij, në të cilën gjendeshin, si edhe sot, fundi-fundit, vajza që shkallmonin të ardhmen, gra që tradhtonin burrat, priftërinj, fretër e murgesha të padenja për misionin e tyre.

Zvetënimi dhe korruptimi i klerit në kohë të Bokaços ka qenë karakteristikë e shekullit. Shumë nga shkrimtarët italianë të kohës e kanë theksuar këtë gjë. Dantja në “Komedinë Hyjnore” ia caktoi vendin papë Bonifacit të VIII në ferr para se ky të vdiste. Por, Bokaçoja s’ mjafton me aq, ai tërhiqet vetiu nga argumente imorale dhe këtu qëndron faji i tij, ngulmon në hollësira të pahijshme, në vend që t’i fshehë, ose t’i kapërcejë, a t’i lerë në heshtje për t’i nënkuptuar vetë lexuesi, sikundër bëjnë shumë shkrimtarë të tjerë. Ndofta për këtë gjë ka qenë dhe i shtrënguar, për të ruajtur karakterin popullor të rrëfenjave, nga ku e kanë burimin shkrimet e tij. Bokaçoja nuk mund të shfajësohet për këtë të metë, sado që si njeri qe, me të vërtetë, i ndershëm, i urtë, zemërbardhë, modest e i çiltër.

Të tërhequr nga arti i tij, e përkthjem kryeveprën e tij, sado të rënda që janë të metat që theksuam më sipër. Të rinjtë tanë mendohet të jenë aq të pjekur e të formuar që të mos tërhiqen nga gjërat e shëmtuara të shkrimtarit, por nga dhuntitë e artit të tij të lartë.

Ky është pra Xhovani Bokaçoja, babai i prozës italiane dhe krijuesi i rrëfenjës klasike dhe kjo është vepra e tij më e lartë. Tani lexuesi mund ta çmojë e ta gjykojë vetë, nëpërmjet përkthimit, kryeveprën e tij.

Ali Hashorva, Tiranë, 1955

Dekameroni

Këtu fillon libri i quajtur “Dekameroni”, që njihet edhe si Princi Galeot¹ e që përmban njëqind rrëfenja, të kallëzuara në dhjetë ditë nga shtatë vasha dhe tre trima.

Hyrje

Dhembshuria për të pikëlluarin është një ndjenjë njerëzore që duhet ta ketë cilido. Këtë e kuptojnë më mirë ata që kanë pasur nevojë për ngushëllim dhe e kanë gjetur në të tjerë dhe, në qoftë se ka pasur njeri nevojë për ngushëllim ndonjëherë, e ka lakmuar dhe është përdëllyer prej tij, ai njeri jam unë vetë, sepse, që nga të ritë e mi e gjer më sot, kam qenë ndezur nga një dashuri e fortë, e lartë dhe fisnike, aq sa, ndofta, nuk do të përkonte me gjendjen time të ulët që ta tregoja. Sado që disa njerëz të matur, që e kishin mësuar këtë gjë, më lëvdonin për të dhe më quanin si njeriun më të shquar, unë, megjithëkëtë, kam vuajtur jashtë mase, sigurisht jo nga ndonjë qëndrim mizor i së dashurës sime, por nga një zjarr i tepruar që më kishte pushtuar shpirt e zemër e që ishte shkaktuar nga një pasion i përvëlur e i verbër. Ky pasion, duke mos më lënë të qetë thujse asnjë minutë, shpesh më mërziste më tepër nga ç’duhej. Kur gjendesha kështu i mërzitur dhe i shqetësuar, kaq tepër më qetësonin bisedat e këndshme dhe ngushëllimet me vend të disa miqve, sa që jam më se i sigurt se, nëpërmjet tyre, unë munda të shpëtoja jetën. Por, si desh Perëndia që, duke qenë vetë i amshuar, caktoi për çdo gjë të kësaj bote, me ligje të pandryshueshme, një mbarim, dashuria ime e përvëlur, të cilën s’kishte mundur ta thyente a ta përkulte asnjë fuqi

¹Ndofta është një kujtim nga Dantja. Do të thotë se Dekameroni do të shërbejë si Galeoti, domethënë si ndërmjetës dashurie.

vendimi, këshille, turpi publik a rreziku që mund të rridhte sojet, me kalimin e kohës, u venit vetvetiu dhe sot nuk më ka lënë në shpirt, veç atë ndjenjë kënaqësie e lehtësimi, që zakonisht u lihet atyre që nuk shtyhen të vozitin larg bregut në detin e thellë dhe të errët. Prandaj, ndërsa atëherë e ndieja veten të munduar, sot, si m'u largua çdo brengë, e ndiej veten të çelur e të kënaqur.

Por, megjithëqë morën fund vuajtjet e mia, prapë s'mund të harroj mirësitë që pata prej atyre dashamirësve atëherë kur mundimet e mia ishin të rënda dhe s'kam për t'i harruar kurrë, siç besoj, veçse në vdekje. Dhe, meqenëse unë mendoj se mirënjohja duhet lëvdur midis gjithë virtyteve, sikundër mosmirënjohja duhet dënuar, për të mos u dukur mosmirënjohës, vendosa me vete, me sa të më vinte përdore, tani që mund ta quaj veten të lirë nga dashuria, si shpërblim të mirësive që kam pasur, të përpiqem të zbavit në njëfarë mënyre me talentin tim të pakët, në mos vetë ata që më patën ndihmuar (të cilët, ndofta, pse janë njerëz të pjekur, ose për fatin e mirë të tyre, s'kanë nevojë për zbavitje nga unë), së paku, ata që mund të kenë nevojë. Dhe, sado që ndihma ime ose balsami, si të themi, s'do të jetë krejt i mjaftueshëm për ata që kanë nevojë, megjithëkëtë, ashtu, sido që është, mendoj se duhet përdorur më mirë aty ku nevoja është më e madhe, aq pse do të jetë më e dobishme, sa dhe pse do të pritet me kënaqësi më të madhe.

Kush mund të më kundërshtonte se kjo ndihmë është më e udhës t'u jepet grave të bukura sesa burrave? Sepse ato, nga frika e turpit, e fshehin flakën e dashurisë brenda kraharorëve delikatë dhe kështu bëhet dashuri shumë më e fuqishme nga ajo që mund të shprehet lirshëm, dashuri që e njohin vetëm ato që e kanë provuar. Përveç kësaj, ato, të shtrënguara nga dëshirat dhe urdhrat e etërve, mëmave, vëllezërve e burrave të tyre, e kalojnë më të shumtën e kohës brenda katër mureve të dhomave të tyre dhe, duke ndenjur duarkryq, dashur pa dashur, në një kohë e sipër, rrahin me mend gjithfarë mendimesh të cilat s'mund të jenë gjithnjë të gëzueshme. Dhe, atëherë, kur i kap ndonjë brengë e lindur nga ndonjë dëshirë e zjarrtë, për shkak të këtyre mendimeve, janë të detyruara të mbeten aty ku janë, të mërzitura pamasë, në qoftë se nuk u largohet mërzitja me anë të ndonjë zbavitjeje, pa, në marshim parasysh pastaj edhe se ato janë shumë më të dobëta se burrat për t'i bërë ballë mërzisë, mund të marrim me mend se në ç'gjendje shpirtërore ndodhen. Burrave të dashuruar nuk u ndodh një gjë e tillë, siç mund të shohim faqeza. Këta, në qoftë se i kap ndonjë brengë a mërzi, kanë shumë mënyra sesi t'i lehtësojnë e t'i kalojnë, sepse, po të duan, mund të shëtisin, të dëgjojnë e të shohin shumë gjëra, të zënë zogj, të venë për gjah, të peshkojnë, të baresin kaluar, ose të shesin e të blejnë.

Këto mënyra të kalimit të kohës kanë fuqinë ta bëjnë njeriun tërësisht apo pjesërisht më vete e t'ia largojnë mendimet e këqija, të paktën, për njëfarë kohe, pastaj, në njërën mënyrë a në një tjetër ata, ose sigurojnë ndonjë ngushëllim, ose mërzia lehtësohet.

Prandaj, për të shpërguar pjesërisht prej meje mëkatet e fatit, i cili tregohet dorëmbajtur në ndihmë të atyre ku kjo ndihmë është më e nevojshme, sikurse e shohim te gratë e dobëta prej natyre, në mbështetje dhe për zbavitje të këtyre grave që dashurojnë (sepse të tjerave u ka më shumë hije gjilpëra, boshti e vegu), mendoj të kallëzoj njëqind rrëfenja, a përralla, a parabola, a histori, si t'i duash quaji, të cilat kallëzohen në dhjetë ditë nga një grup prej shtatë vashash dhe tre trimash të ndershëm, grup që u formua në kohën e murtajes së kaluar vdekjeprurëse. Gjithashtu tregohen dhe disa këngë që këndohen për dëfrim nga vashat.

Në këto rrëfenja do të shihen raste të këndshme a të vrazhda dashurie dhe të tjera ngjarje fatlume që kanë ndodhur si në kohët moderne, ashtu dhe në ato të lashta. Gratë, për të cilat kam bërë fjalë më sipër, që do të lexojnë këto rrëfenja, mund të ndiejnë kënaqësi nga ngjarjet zbavitëse që hasen në to dhe njëkohësisht mund të marrin mësim të mira, sepse do të mund të njohin se ç'duhet të mos bëjnë dhe, po ashtu, se ç'duhet të bëjnë, gjë që s'besoj të ngjajë pa ua larguar mërzinë.

Në qoftë se ndodh një gjë, e tillë (dashtë Perëndia kështu qoftë!), le të falënderojnë *dashurinë* për të që, duke më liruar nga kthetrat e saj, më dha mundësi t'u kushtohem kënaqësive të tyre.

Dita e parë

Fillon dita e parë e “Dekameronit”, në të cilën, pasi autori tregon se përse u mblodhën për të biseduar së bashku njerëzit që do të shihen më poshtë, nën drejtimin e Pampinesë, flitet mbi tema të lira.

Hyrje

Sa herë, o gra hirplota, mendoj për ju me veten time sesa më shumë jeni të prekshme dhe të dhimbshme prej natyre, aq më tepër bindem se kjo vepër, për gjykimin tuaj, do të ketë një fillim të rëndë e të mërzitshëm, sikundër është kujtimi i hidhur i murtajës së kaluar, që përhapri zinë në të gjitha anët dhe që lemerisi pa përjashtim këdo që e pa ose e dëgjoi nga të tjerët, kujtim të cilin kjo vepër e sjell mu në ballë. Por nuk dua që kjo gjë t’ju fusë tmerrin për të lexuar më tutje dhe t’ju duket sikur tërë leximin do ta kaloni me psherëtima e me lot.

Ky fillim i tmerrshëm do të jetë për ju siç është për udhëtarët ngjitja në një mal të lartë e të thepisur, përtej të cilit shtrihet një fushë fort e bukur dhe e këndshme. Aq më tepër u duket udhëtarëve e këndshme një fushë e tillë, sa më e vështirë të ketë qenë për ta e ngjitura dhe e zbritura e malit. Dhe, ashtu sikurse kulmin e gëzimit e pason hidhërimi, edhe mjerimet marrin fund me gëzime të papritura.

Këtë mërzi të shkurtër (them e shkurtër se përmblihet në fare pak fjalë) e pason me të shpejtë ëmbëlsia dhe kënaqësia që ju pata premtuar më parë dhe që, ndofta, sikur të mos jua kujtoja, mund të mos e prisnit më, kur të shihnit një parathënie të tillë. Po të kisha mundur t’ju çoja me lehtësi aty ku dëshiroja nga një rrugë tjetër më e pëlqyer se kjo, që e di se është e hidhur, do ta kisha bërë me gjithë qejf por, meqenëse nuk është e mundur po të

mos tregoja shkakun se pse ndodhën ngjarjet që do të lexoni më poshtë, i shtrënguar, pra, nga nevoja, e ndiej veten të detyruar t'jua përshkruaj.

Them, pra, se një mijë e treqind e dyzet e tetë vite kanë shkuar qysh prej kohës së mishërimit frutdhënës së të birit të Perëndisë, kur ra murtaja vdekjeprurëse në Firencen madhështore, një nga më të bukurat qytete të Italisë. Shkakun e përhapjes së kësaj sëmundjeje ose duhet ta kërkojmë në ndikimin e trupave qiellorë, ose në zemërimin e drejtë të Perëndisë, që ndofta ka dashur të na ndëshkojë për veprat tona të këqija. Kjo sëmundje, ca vjet përpara, ishte përhapur në anët e Lindjes, duke shkaktuar vdekje të panumërta në çdo vend. Pastaj, duke u përhapur pak nga pak nga njëri vend te tjetri, arriti gjer në Perëndim me pasoja të tmerrshme.

Këtu, thuajse në fillim të pranverës së vitit të sipërtreguar, filluan të shfaqeshin rrjedhimet e saj të hidhura në mënyra të tmerrshme dhe të çuditshme. Nuk vlejten as urtësia, as masat e marra. Më kot njerëz të posaçëm pastronin qytetin nga ndyrësitë, më kot u ndalua hyrja e të sëmurëve në qytet, më kot u dhanë këshilla të shumta për ruajtjen e tij. Jo vetëm këto, por nuk ndihmuan as lutjet e shumta e të përvuajtura drejtuar Perëndisë, jo një herë, po kushedi sa herë, prej besimtarëve, qoftë me anë procesionesh, qoftë me mënyra të tjera. Këtu kjo sëmundje u shfaq në fillim të pranverës në mënyrë të ndryshme nga ç' ishte shfaqur në Lindje. Aty, të dalët e gjakut nga hundët ishte një shenjë që tregonte vdekjen e sigurt, ndërsa këtu, në fillim të sëmundjes, pa dallim, si burrave dhe grave, u shfaqeshin ca xhumba të mëdha nëpër shalë ose nën sqetulla, disa prej të cilave ishin sa një mollë e zakonshme, disa sa një vezë, disa më të mëdha e disa më të vogla. Në pak kohë e sipër këto xhumba të mëdha, që populli i quante lunga, përhapeshin në tërë trupin. Kjo sëmundje e tmerrshme nuk shfaqej kurdoherë me të njëjtat simptoma. Ngandonjëherë shfaqej edhe me njolla të zeza, ose të zeshkëta, që u dilnin më të shumtëve, kujt të mëdha e të rralla, kujt të vockla e të dendura nëpër llërë, nëpër kofshë dhe pastaj në tërë trupin. Këto njolla, si dhe lungat që thamë, ishin shenjat e vdekjes së afërme.

Për të shëruar këtë sëmundje, nuk vlenin as këshillat e mjekëve, as barnat. Kjo sëmundje ose ishte e pashërueshme prej natyre, ose mjekët me pazotësinë e tyre (përveç mjekëve profesionistë qenë dhe një numër i madh burrash e grash që e ushtronin këtë mjeshtëri pa ditur kurrë më parë se ç'qe mjekësia) nuk ishin në gjendje të gjenin nga se rridhte, le pastaj ta shëronin. Prandaj ishin të paktë ata që shëroheshin dhe shumica, mund të them tri ditë pas shenjave të përmendura, a pak më parë, a pak më pas, vdisnin dhe, në më të shumtën e herëve, pa pasur as ethe, as ndonjë simptomë tjetër.

Kjo sëmundje u bë edhe më e tmerrshme kur, nga të sëmurët u ngjitej të shëndoshëve që kujdeseshin për ta, pikërisht ashtu si përhapet zjarri, kur i afrohen sende të thata ose me lyrë. Lëngata shkoi edhe më tej: mjaftonte një njeri të fliste ose të rrinte me një të sëmurë, që të molepsej prej tij. Mjaftonte që ai të prekte rrobat ose çfarëdolloj sendi që kishte prekur ose përdorur i sëmuri, dhe humbte jetën bashkë me të.

Do t'ju tregoj një gjë të çuditshme që as unë s'kisha për ta besuar dhe s'do të kisha guxuar ta përshkruaja, po të mos e kisha parë vetë e me shumë të tjerë, sado të besueshëm të ishin ata që do të ma kishin thënë.

Them se kjo sëmundje ngjitej në mënyrë të çuditshme nga njëri tek tjetri. Jo vetëm njeriu ia lëshonte njeriut me lehtësi të madhe, po çka është më e çuditshme, mjaftonte një send çfarëdo i të sëmurit, ose i ndonjë të vdekuri, që ta ngordhte aty për aty çfarëdo kafshe që ta kishte prekur atë send. Një ditë, siç thashë më sipër, pashë me sytë e mi një gjë të tillë: dy derra, duke parë lecat e një të vdekuri prej kësaj sëmundjeje, të hedhura në rrugë, sipas zakonisht të tyre, u lëshuan mbi to duke i trazuar me turi e me dhëmbë dhe pastaj i përplasën në fytyrë. Dhe, pa kaluar shumë kohë, si erdhën dy tri herë rrotull me konvulsione, ranë të dy të ngordhur mbi lecka, sikur të ishin helmuar.

Nga ngjarje të këtilla e nga shumë të tjera si këto edhe më të tmerrshme, u hyri një frikë e madhe në zemër të gjithë atyre që kishin shpëtuar nga vdekja, saqë të gjithë, pa përjashtim, shikonin si e si t'i braktisnin të sëmurët në mëshirën e fatit bashkë me plaçkat e tyre dhe të mërgoheshin syresh sa të ishte e mundur më larg, duke bërë kështu të mundur, të paktën, të shpëtonin jetën e tyre.

Disa ishin të mendimit që, për t'i bërë ballë kësaj fatkeqësie, duhej ndjekur një rrugë e thjeshtë jete, duhej qëndruar larg nga çdo gjë e tepërt. Kështu, njerëzit mblihdeshin në grupe të vogla dhe jetonin të veçuar nga të tjerët. Këta mblihdeshin në ato shtëpi ku s'kishte asnjë të sëmurë dhe, për të jetuar më mirë, përdornin për të ngrënë gjellë nga më të shijshmet dhe verëra nga më të mirat, por, me masë. Nuk lejonin njeri të fliste apo të dëgjonte për ato që thuheshin për të sëmurët dhe për të vdekurit jashtë. Nuk pyesnin se kush sëmurej e kush vdiste. Kohën e kalonin me muzikë e me argëtimet që lejonin rrethanat. Të tjerë, përkundrazi, e mendonin ndryshe, këta ishin të bindur se i vetmi bar i sigurt për të shpëtuar nga një sëmundje e tillë, ishte të pinin shumë, të dëfreheshin, të bridhnin duke kënduar e duke u zbavitur, të kënaqnin çdo dëshirë që ishte e mundur dhe ta merrnin me të tallur e me të qeshur gjithë ç'po ngjante. Dhe kështu bënë me të vërtetë: natë e ditë kohën e kalonin nga një mejhane te tjetra, duke pirë pamasë, ose më shumë duke

vajtur në shtëpitë e të tjerëve, mjaft të merrnin erë nëse kishte në to ndonjë gjë që t'u pëlqente e t'i kënaqte. Dhe këto gjëra i bënin pa hasur në asnjë pengim se, secili, sikur s'do të jetonte më, bashkë me veten kishte braktisur të gjithë pasurinë. Nga ky shkak, shumica e shtëpive ishin bërë të përbashkëta; mund t'i përdorte një i huaj që qëllonte, ashtu siç mund t'i përdorte edhe vetë i zoti. Përveç këtyre sjelljeve jonjerëzore, këta përpiqeshin si e si, me sa t'u vinte përdore, t'u rrinin larg të sëmurëve.

Në një të tillë gjendje kaq të pikëlluar dhe të mjeruar të qytetit tonë, kishin rënë nga fuqia thuajse kryekëput edhe ligjet hyjnore, edhe ato njerëzore, sepse nëpunësit e drejtësisë dhe zbatuesit e ligjeve, si të gjithë njerëzit e tjerë, ose kishin vdekur, ose dergjeshin të sëmurë, ose iu kishin vdekur të gjithë të dashurit dhe nga hidhërimi s'u bënte zemra të kryenin detyrat që kishin. Për këtë arsye secili bënte si të donte pa e penguar njeri.

Shumë nga qytetarët mbanin një rrugë të mesme midis atyre që treguam më sipër: s'hanin pak si të parët dhe nuk lëshoheshin në të pira dhe në shkatërrime si të dytët, por përdornin çdo gjë sipas nevojës, me udh'e me vend. Pa u mbyllur brenda, dilnin rrotull kush me nga ndonjë lule në dorë, kush me nga ndonjë fije bari aromatike e kush me sende me aroma të ndryshme. Duke iu marrë erë këtyre, shpresonin që me to të largonin sëmundjen, se duhet shënuar se, nga çdo anë, ajri kutërbonte nga kufomat, nga sëmundja e nga barërat mjekësore.

Një palë tjetër ishin të një mendimi më mizor. Këta besonin se mënyra më e mirë për të shpëtuar nga murtaja ishte të largoheshin prej vendit dhe të shtyrë prej këtij mendimi, s'mendonin për gjë tjetër, veç si të shpëtonin kokën. Kështu, një shumicë e madhe burrash e grash lanë qytetin, shtëpitë, të afërmit e pasurinë e tyre dhe u përhapën nëpër katunde rrotull qytetit apo gjetkë. Dukej sikur besonin se Zoti, i mërzhitur me ligësitë tona, kishte vendosur ta rrëronte fare këtë qytet dhe se murtaja e dërguar prej tij nuk do të binte, veç mbi kokët e atyre që gjendeshin brenda mureve të tij, ose pandehnin se nuk do të mbetej këmbë njeriu në këtë qytet fatzi dhe se kish arritur koha e tij e fundit.

Këta, të cilët, siç u pa, në mënyra të ndryshme, u përpoqën të shpëtonin nga sëmundja mizore, nuk vdiqën të gjithë, por, as nuk shpëtuan të gjithë. Një shumicë prej të gjitha kategorive e në çdo vend u sëmurën dhe, ashtu siç e kishin dhënë vetë shembullin kur kishin qenë të shëndoshë, thuajse të neveritur prej të gjithëve, lëngonin në çdo anë.

Në këtë mynxyrë kaq të madhe që kishte zotëruar dhe tmerruar zemrat e burrave dhe grave, jo vetëm qytetari rrinte larg nga qytetari, por fqinji thuajse nuk kujdesej fare për fqinjin e farefisin. Të afërmit, ai ose s'i vizitonte fare,

ose i vizitonte rrallë. Tmerri ishte aq i madh, sa vëllai linte vëllanë, ungji nipin, motra vëllanë dhe shpesh e shoqja të shoqin, por gjëja më e çuditshme dhe më e pa besueshme ishte që etërit dhe mëmat largoheshin prej fëmijëve që dergjeshin të sëmurë, sikur të mos i kishin të tyret.

Për këto arsye, kush kishte në shtëpi një numër të madh të sëmurësh femra e meshkuj, s'kishte tjetër ndihmë, veç të ndonjë miku zemërmirë (dhe këta ishin fare të paktë) dhe të shërbëtorëve makutë, të cilët tërhiqeshin në këto punë nga shpërblimet e majme që merrnin. Por, me gjithë shpërblimet e mira dhe të padëgjuaara që merrnin, ata ishin fare të paktë. Dhe, ata të paktë që ishin, përgjithësisht ishin burra e gra të pagdhendura dhe më të shumtit s'kishin haber nga kësi shërbimesh. Pra, merret me mend se s'mund të bënin gjë tjetër, veç t'i shpinin të sëmurit ndonjë gjë që kërkonte, ose ta ruanin kur të vdiste. Por, duke bërë këto shërbime, shumë herë humbnin kokat e tyre bashkë me fitimet.

Braktisja e të sëmurëve prej fqinjëve, prej prindërve, prej miqve dhe mungesa e shërbëtorëve, bëri që të lindte një zakon i ri që nuk ish parë e dëgjuar thuajse kurrë: gruaja, sado e bëshme dhe bujare që të kishte qenë, kur sëmurej, s'e kishte fare për gjë të pranonte shërbime nga ana e një shërbyesi, cilido që të ish ai, i ri ose jo dhe, pa turp fare, sikur ai që kishte përpara të ishte ndonjë grua, i zbulonte të gjitha pjesët e trupit kur e lypte nevoja e sëmurdjes. Kjo gjë u bë shkak, natyrisht, që nderi i grave që mundën të shpëtonin nga vdekja pas sëmurdjes të mbetej pak i cenuar.

Shumë vetë do të kishin shpëtuar nga vdekja, po të kishin ndihmën e dikujt. Kështu që, ca nga të mos pasurit e kujdesit të duhur e ca nga rreptësia e madhe e sëmurdjes, ishte shtuar shumë numri i atyre që vdisnin ditë e natë, saqë mbeteshe pa mend jo vetëm t'i shihje, por dhe t'i dëgjoje. Për këto arsye, lindnin vetvetiu, midis atyre që mbeteshin gjallë, zakone të kundërta nga ato të parat të qytetit tonë.

Në kohë të para, siç shohim edhe sot, kur vdiste ndonjëri, gratë e farefisit dhe fqinjët mblidheshin në shtëpinë e të vdekurit dhe e vajtonin bashkë me më të afërmit e tij. Nga ana tjetër, përpara shtëpisë së të vdekurit mblidheshin të afërmit e tij me fqinjët e me shumë qytetarë dhe, sipas rëndësisë së të vdekurit, vinte priftëria, pastaj, si e merrnin në krahë të vdekurin me salltanetet e rastit, me qirinj e me kungime, e shpinin në kishën që kishte caktuar ai vetë para se të vdiste. Të gjitha këto zakone, me shtimin dhe ashpërsimin e murtajës, u shuan krejt, apo pjesërisht dhe, në vend të tyre, lindën plot të tjera të reja, sepse njerëzit vdisnin jo vetëm pa pasur në krahë një grup grash, sipas zakonit, por shumica shkonte nga kjo jetë pa pasur pranë asnjë dëshmues. Shumë të paktë ishin ata të vdekur që vajtoheshin me dhembshuri

e me lot të hidhur prej njerëzve të tyre, se përgjithësisht të qarët e vajtimet ishin zëvendësuar me gaze, shakara e tallje, me të cilat njerëzit përcillnin të vdekurit në varr. Këtë zakon të ri e përhapën sidomos gratë, të cilat për të shpëtuar kokën, e kishin lënë përgjithësisht në harresë dhembshurinë e tyre. Ishin të rrallë ata të vdekur që çoheshin në kishë prej më shumë se dhjetë a dymbëdhjetë vetash, të cilët s'ishin qytetarë fisnikë e të ndershëm, por hamej e varrmihës nga klasa më e ulët, e që e kryenin këtë punë për të fituar të holla. Këta hamej, që thamë, e rrëmbenin në krahë arkivolin dhe bashkë me katër a gjashtë priftërinj, me pak qirinj, dhe nganjëherë edhe pa to fare, me hapa të shpejtë, e shpinin të vdekurin jo te kisha që kishte caktuar ai përpara se të vdiste, por, në të shumtën e herës, te kisha më e afërme që qëllonte. Këta priftërinj, me ndihmën e hamejve, pa u lodhur me kungime të shumta, e lëshonin të mjerën kufomë në të parin varr të zbrazët që gjenin.

Në këtë mynxyrë të madhe, fati i vegjëlisë dhe thuajse i pjesës më të madhe të klasës së mesme ishte më i mjerueshëm. Këta shpeshherë, të mbajtur nga shpresa dhe të ndalur nga varfëria, qëndronin në shtëpitë e tyre pranë të sëmurëve. Me mijëra sëmureshin në ditë e, meqenëse s'gjendesh kush t'u shërbente dhe t'i ndihmonte me gjësendi, të gjithë vdisnin thuajse pa formalitetet fetare të zakonshme. Të shumtë ishin ata që e mbaronin jetën e tyre, qoftë ditën e qoftë natën, mu në mes të rrugës së madhe të tjerët, që vdisnin në shtëpitë e tyre, mbeteshin brenda gjersa qelbeshin e kutërbimi ua bënte të njohur fqinjëve vdekjen e tyre. Numri i këtyre të vdekurve dhe i të tjerëve më çdo anë, ishte i pasosur.

Shumë herë fqinjët vepronin për të njëjtën arsye: më tepër se mëshira për të vdekurin, i shtynte frika se mos infektoheshin nga era që kutërbonte. Ata, pra, ca vetë, ca me ndihmën e hamejve në rast se gjendeshin, nxirrnin prej shtëpive kufomat e të vdekurve dhe i vinin përpara portës. Nëpër porta, në mëngjes sidomos, po të dilje jashtë, mund të shihje kushedi sa kufoma. Pasi i nxirrnin përjashta, dërgonin e sillnin arkivole, për t'i çuar me to në jetën e përherëshme. Nganjëherë, kur mungonin arkivolet, i vinin në copa dërrasash.

Në një arkivol nuk vinin një kufomë vetëm, por dy a tri së bashku. Shumë herë mund të shihje në një arkivol burrin dhe gruan, dy ose tre vëllezër, t'anë me të birin e ku ta di unë sa të tjera këso çudirash. Mijëra herë ngjante që dy ose tre priftërinj, me nga një kryq në dorë, të shoqëronin tre ose katër arkivole njëherësh, të mbajtura prej hamejve. Në qoftë se priftërinjtë pandehnin se kishin vetëm një të vdekur për të varrosur, u ndodhte që të kishin gjashtë ose tetë dhe, ndonjëherë, edhe më shumë. Në varrim të vdekurit nuk nderoheshin as me lot e as me qirinj. Vdekja ishte bërë aq e zakonshme, saqë në atë kohë njeriut mund t'i dhimbsej i vdekuri, aq sa mund t'i dhimbset atij sot një dhi

e ngordhur. Prandaj u duk sheshit se, një gjë që s'mund ta mësojnë të urtët ta durojnë me burrëri në kohëra normale, e mësojnë ta durojnë me gjakftohtësi njerëzit e thjeshtë e të paditur në kohë anormale.

Meqenëse s'mjaftonte vendi për të kallur numrin e madh të kufomave që silleshin orë e çast, sidomos në rast kur njerëzit e të vdekurit donin një vend të vetin të veçantë në tokën e shenjtë të kishës sipas zakonit të vjetër, pasi çdo vend ishte mbushur, miheshin gropa të mëdha nëpër varrezat e kishave dhe në këto gropa hidheshin me qindra kufoma, njëra mbi tjetrën që vinin më pas, pikërisht ashtu siç vihen stivë njëra mbi tjetrën plaçkat në një anije. Pastaj këto gropa mbuloheshin me pak dhé gjersa të rrafshohej balta.

Që të mos zgjatemi më në hollësitë e mjerimeve që i ngjanë qytetit tonë, shënoj vetëm se, atëherë kur kjo mynxyrë e madhe e kishte zotëruar atë, s'duhet kujtuar se rrethet përçark kishin mbetur të paprekura, për të mos folur për kështjellat, që, me gjithë vogëlsinë e tyre, nuk ndryshonin fare nga qytetet. Flas për bujqit e mjerë e të varfër e për familjet e tyre, të përhapura nëpër fusha, të cilat po vdisnin ditë e natë, pa ndihmën e mjekut a të ndokujt tjetër, nëpër rrugë, nëpër ara e nëpër shtëpi, jo si njerëz, por si kafshë. Prandaj edhe ata, si qytetarët, s'ua vinin veshin fort zakoneve, nuk interesoheshin më për gjë e për punë, përkundrazi, të gjithë, mu sikur të kishte arritur dita e fundit e jetës së tyre, nuk çanin më kokën të kujdeseshin për kafshët e arat e mbjella me aq mundim, por përpiqeshin si e si, në të gjitha mënyrat, që të shkrinin e të harxhonin çdo gjë që u ndodhej brenda. Të gjitha kafshët i kishin përzënë nga shtëpitë. Mund të shihje të livadhishnin pa zot nëpër arat e mbjella e të pakorrura që, gomarë, dhen, dhi, derra, pula e qen. Edhe qentë, që janë aq besnikë te njeriu, i kishin nxjerrë jashtë shtëpive. Shumë kafshë, sikur të ishin të pajisura me gjykim njeriu, pasi kullotnin tërë ditën, mbrëmanet, të ngopura, pa i udhëhequr asnjë bari, ktheheshin nëpër shtëpitë e tyre për të kaluar natën.

Le ta lëmë fshatin tani dhe të kthehemi përsëri në qytet. Po, ç'mund të shtojmë? Kaq llahtarisëse ka qenë mizoria e Perëndisë dhe, ndofta, pjesërisht mizoria e njerëzve, saqë prej marsit e gjer në korrik të atij viti, besohet me siguri të plotë se brenda mureve të qytetit të Firences të kenë vdekur më tepër se njëqind mijë veta, ca prej tyre nga rreptësia e murtajes, ca nga kujdesi i paktë e të mos pasurit fare kujdes, meqenëse vendi ishte braktisur nga frika e sëmundjes. Siç shihet, pra, në këtë gjëmë ngjethëse mund të thuash se s'mbeti këmbë njeriu nga banorët e këtij qyteti.

Oh, sa pallate të mëdha, sa shtëpi të bukura, sa banesa madhështore, që përpara oshtinin nga njerëzit, nga zotërinjtë e nga zonjat, sot kanë mbetur shkretë e s'gjendet në to as edhe një shërbëtor! Oh, sa e sa oxhaqe të shquara,

sa trashëgimi të pafundme, sa pasuri të famshme, mbetën pa trashëgimtarët e tyre! Sa burra trima, sa gra të bukura, sa djem të hijshëm që vetë Galeni, Hipokrati dhe Eskulapi² i kishin gjykuar krejt të shëndetshëm, në drekë hëngrën së bashku me prindërit e tyre, me shokët e miqtë dhe darkën e bënë aty, në botën tjetër, me njerëzit e tyre të vdekur.

Edhe mua vetë më ngjethet mishi duke u zgjatur kaq shumë në përshkrimin e kaq mjerimeve. Prandaj, duke lënë tani një pjesë të tyre, që s'më prish punë, them, pra, se në kohën kur qyteti ynë kishte mbetur shkretë fare, kam dëgjuar nga një njeri i besueshëm se një të martë në mëngjes, u ndodhën për të dëgjuar meshën në kishën e adhuruar të “Shën Mërisë së Re”, shtatë vasha, ndofta të vetmet në atë meshë, të veshura të gjitha me të zeza, sikundër e lypte gjendja. Të gjitha kishin njëfarë lidhje me njëra-tjetrën. Ato ishin mikesha, fqinje e kushërira. Më e madhja prej tyre s'i kishte mbushur njëzet e tetë vjeçët dhe më e vogla nuk ishte më shumë se tetëmbëdhjetë vjeçe. Secila ishte e zgjuar dhe fisnike, e bukur, e hijshme, me veti të mira dhe të ndershme. Një arsye e drejtë më ndalon që t'i tregoj emrat e vërteta të këtyre vashave dhe arsyeja është se unë s'dëshiroj që ndonjë prej tyre të turpërohet në të ardhmen nga gjërat që ka kallëzuar e dëgjuar, pasi sot janë ndryshuar krejt ligjet e dëfrimeve, ndërsa në atë kohë, për arsyet që kemi treguar, kishte liri të plotë, jo vetëm për të rejat, por edhe për ato që ishin të kaluara në moshë. Një arsye tjetër është se s'dua t'u jap rastin ziliqarëve që janë gati në çdo orë të thumbojnë çdo sjellje të lavdërueshme, të prekin në ndonjë farë mënyre nderin e vashave shpirtmëdha me fjalë të pahijshme. Që paskëtaj të kuptohen mirë e pa pështjellim ato që do të kallëzojë secila prej tyre, do t'u ngjit emra që iu përshtaten tërësisht ose pjesërisht cilësive të secilës.

Të parën, që ish dhe më e madhja, do ta quaj Pampine, të dytën Fjametë, të tretën Filomenë, të katërtën Emili, të pestën Lauretë, të gjashtëm Neifilë dhe asaj të fundit, me plot arsye, do t'i jap emrin, jo pa qëllim, Elizë³. Këto vasha, pra, pasi u hasën rastësisht e pa ndonjë qëllim në një kënd të kishës, iu afruan njëra tjetrës kur mbaroi mesha, duke formuar një qark të vogël dhe pasi psherëtinë disa herë, filluan të hapnin biseda të ndryshme mbi ngjarjet e kohës. Pas këtyre bisedave, si pushuan të tjerat, Pampineja tha këto fjalë:

- Të dashura shoqet e mia, mund t'ju ketë rënë në vesh shumë herë, sikundër më ka rënë dhe mua vetë, se kush përdor me nder të drejtën e vet, nuk dëmton askënd. Është një e drejtë e cilitdo të lindur në këtë botë të mbajë, të ruajë dhe të mbrojë jetën e vet sa më mirë që të jetë e mundur

² Që të tre mjekë të famshëm grekë.

³ Elizë në gjuhën kartagenase do të thotë e virgjër.

dhe për këtë gjë, dikush mund të vrasë edhe tjetrin kur prej tij i kërcënohet jeta. Në është, pra, se këto ligje i sigurojnë çdo njeriu këtë të drejtë, nuk duket e arsyeshme, për ne, si dhe për çdo njeri tjetër, që pa i bërë kujt dëm, të marrin të gjitha masat e duhura për mbrojtjen dhe sigurimin e jetës sonë? Sado herë që mendoj mbi fjalët që shkëmbyem sot, sikundër dhe në ditët e tjera, kuptoj - dhe këtë mund ta kuptoni dhe ju - se secila prej nesh i trembet kokës dhe për këtë gjë s'ka pse të çuditet. Por çudi e madhe është që, të pajisura siç jemi, me ndjenja prej femre, nuk vendosim dot të marrim masa të menjëhershme kundër shkaktarës së frikës sonë të arsyeshme.

- Më duket se po rrimë këtu për të mbajtur listën e gjithë të vdekurve që varrosëm ose për të përgjuar, vallë, a e thonë meshën në orët e caktuara këta fretër që po pakësohen nga dita në ditë, ose, më së fundi, për t'i treguar me rrobat tona të përzitura çdo njeriu që na shfaqet, gjithë gjëmën e madhe që na ka mbuluar. Kur dalim së këtejmi, s'shohim veç të vdekur e të sëmurë që vinë rrotull, s'pjekim veç njerëz të ligj të përzënë dikur nga qyteti për zullumet e tyre dhe që sot, duke parë se njerëzit e drejtësisë kanë vdekur ose janë sëmurë, si për t'u tallur me ligjet, kanë filluar t'i bien vendit kryq e tërthor; s'hasim veç njerëzit më të fëlliqur të qytetit tonë, të cilët, të nxitur nga gjaku ynë, e thërrasin veten varrmihës dhe, për të na plasur ne, shkojnë kaluar, duke u fjalosur nga çdo anë dhe, me këngë të turpshme, përflasin mjerimet tona. Asgjë tjetër s'dëgjojmë, veç "akëcilët vdiqën" dhe "akëcilët po vdesin" dhe, sikur të gjendeshin akoma njerëz, do të na shurdhoheshin veshët nga të qarat dhe nga ulërimat.

- Nuk di në ju ngjan dhe juve si mua. Unë kur vete në shtëpi, - që dikur oshtinte nga njerëzit, - dhe s'gjej njeri, veç shërbëtores, më hipën një frikë në zemër, që bën të më ngrihen përpjetë qimet e kokës. Kudo që vete dhe në çdo vend që qëndroj, më duket sikur shoh hijet e të vdekurve dhe jo me pamjen që kishin më parë, por me një pamje të re të tmerrshme që nuk di si ta tregoj.

- Për gjithë këto arsye, s'gjej qetësi as këtu, as jashtë, as në shtëpi. Shqetësimi më shtohet ca më shumë kur mendoj se nga të gjithë njerëzit që kanë mundësi dhe prona jashtë qytetit, ku mund të tërhiqen, vetëm ne kemi mbetur këtu. Dhe ku, pa? Në vendin e turpit e të ndyrësisë. Kam dëgjuar shumë herë se njerëzit që kanë mbetur këtu, pa bërë dallim midis gjërave të ndershme dhe të pandershme (mjaft që t'u pëlqejë), qofshin vetëm a në shoqëri, dit' e natë, s'lenë të zezë pa bërë për të kënaqur sa më shumë epshet e tyre. Jo vetëm gratë e tjera, por edhe murgeshat, duke shkelur betimet e bindjes, lëshohen në dëfrimet më të turpshme, duke dhënë të kuptohet se edhe për ato duhet të jetë e lejueshme ajo që është për gratë e tjera.

- Në qoftë kështu puna, - dhe kështu është se shihet sheshit, - ç'po bëjmë ne këtu? Ç'presim? Ç'ëndërrojmë? Përse të jemi ne më përtace dhe më të plogëta nga gjithë qytetarët për të shpëtuar kokën? Mos na duket, vallë, jeta jonë më e pavlefshme se e të tjerave, apo mos pandehim se mos jeta jonë është e lidhur me trupin në mënyrë më të fortë se e të tjerave e prandaj s'duhet të çajmë kokën se mos na e dëmtojë gjë? Gabohemi, na gënjen mendja. Duhet të jemi budallaçka në qoftë se mendojmë kështu dhe për këtë gjë do të bindemi sado herë që të sjellim ndër mend sa të rinj e të reja të bukura e të shëndosha kanë rënë fli e kësaj sëmundjeje të tmerrshme. Pra, që të mos na takojë edhe neve me plogështinë dhe me mospërkujdesjen tonë fatkeqësia e atyre që thamë, fatkeqësi që mund ta largojmë po të duam, unë jam e mendjes, - nuk di në ju pëlqen edhe juve, - se do të jetë shumë mirë të bëjmë si ato që kanë dalë dhe po dalin nga qyteti, duke u larguar edhe ne prej tij. Në këtë mënyrë edhe kemi për të shpëtuar nga vdekja dhe nga shembujt e turpshëm të të tjerëve, edhe kemi për të shkuar me nder kohën në ndonjë nga pronat tona (të gjitha sa jemi kemi plot prona) e aty, pastaj, mund t'u jepemi dëfrimeve, gëzimeve e brohorive, por, natyrisht, me kufi e me vend, që të mos na cenohet nderi.

- Aty kemi për të dëgjuar këngët e zogjve, kemi për të soditur gjelbërimin e kodrinave dhe të fushave, të arave të mbjella me drithëra që lëkundin si tallazet e detit, kemi për të parë bimë gjithfarëshe, qiellin më të kthjellët, qiellin që, ndër fusha, edhe kur është vrenjtur, e ruan bukurinë hyjnore e madhështore. Të gjitha këto e bëjnë jetën aty më të këndshme se në qytetin tonë të shkretuar. Përveç këtyre, ajri aty është më i freskët, të gjitha sendet e nevojshme për jetën gjenden me shumicë, ndërsa mërzia është fare e pakët. Se, megjithëse edhe aty bujqit vdesin si vdesin këtu qytetarët, prapë brenga është më e paktë, se vdekjet janë më të rralla, ashtu si janë më të rralla shtëpitë e banorëve. Këtu ne, nga ana tjetër, në s'gabohem, nuk braktisim njeri, përkundrazi mund të them, pa gabuar, se të tjerët na kanë braktisur ne, sepse njerëzit tanë janë ose duke vdekur, ose duke u larguar për të shpëtuar nga vdekja. Këta ikën e na lanë vetëm në një pikëllim kaq të madh si të mos ishim të tyre.

- Kurrkush, pra, s'ka për të na qortuar, po të bëjmë siç thashë unë. Po të mos bëjmë ashtu, mund të pësojmë hidhërime, brenga, ose, ndofta, edhe vdekje. Prandaj, po t'ju pëlqejë edhe juve, marrim me vete shërbëtorët tanë dhe të gjitha gjërat e nevojshme dhe vemi gjëtkë, nëpër vendet më të këndshme. Aty le të shijojmë gjithë dëfrimet e stinës, gjersa të shohim, po shpëtuam nga vdekja, çfarë drejtimi do t'u japë Zoti këtyre fatkeqësive. Dhe jua përsëris se vetë nderi ynë e lyp që të largohemi prej këtij qyteti ku

mbretëron pështjellimi dhe ku s'mund të zgjasë shumë që ne të humbasim nderin.

Vashat, si dëgjuan fjalët e Pampinesë, jo vetëm e pëlqyen, por me dëshirën që ta nisin sa më parë, kishin filluar të mendonin me hollësi se në ç'mënyrë t'ia dilnin ndanë kësaj pune. Dukej sikur do të nisin udhëtimin që në atë kohë, me t'u larguar prej andej. Por, megjithëkëtë, Filomena që ishte shumë e matur, e quajti me vend të bënte këto vërejtje:

- Megjithëse Pampineja, tha fjalë me mend, prapë s'duhet të nxitohemi e të ikim me të shpejtë, kështu si doni ju. Mendoni se jemi të gjitha femra dhe s'besoj të jetë ndonjë prej jush aq e papjekur, sa të mos kuptojë sesi sillen gratë kur janë me njëra-tjetrën, pa pasur një mashkull që t'i udhëheqë e t'i rregullojë. Ne gratë jemi vetiu të lëvizshme dhe të paqeta, dyshuese, të ndrojtura e frikacake. Për këto arsye unë kam frikë se shoqëria jonë, s'ka për të zgjatur shumë, po të mos kemi marrë masat më parë për një udhëheqës e për një mbështetje. Prandaj duhet ta shikojmë mirë këtë punë, në dëshirojmë të jemi të nderuara gjatë kohës që do të qëndrojmë në fushë.

- Me të vërtetë, - tha atëherë Eliza, - burrat janë kryet e grave dhe pa ndihmën e tyre, rrallë veprat tona arrijnë një përfundim të pëlqyer. Mirëpo, ku mund t'i gjejmë këta burra? Secila prej nesh e di se burrat tanë më së shumti kanë vdekur. Ata të paktë që kanë mbetur gjallë, po bredhin tej e këtej me grupe të ndryshme për t'iu shmangur fatkeqësisë, së cilës kërkojmë edhe ne t'i mënjano kemi dhe ne s'dimë fare se ku janë. T'u luteshim të huajve, s'do të ish punë e nderuar për ne, prandaj në duam të ruajmë shëndetin, duhet më parë të marrim masa, të rregullohemi në mënyrë që kudo që të vemi për dëfrim apo qetësi, të mos na ngjasin as brennga, as skandale.

Ndërsa vashat po bënë këto fjalë, në kishë po hynin tre trima, më i riu prej të cilëve mund të ishte nja njëzet e pesë vjeç. Këtyre, as prapësia që mbretëronte, as humbja e miqve dhe farefisit, as rreziku që u rrinte mbi krye, s'ua kish shuar as ftohur dashurinë në zemër. Njëri ndër ta quhej Panfil, tjetri Filostrat dhe i treti Dione⁴. Që të tre ishin të hijshëm dhe të sjellshëm. Kishin ardhur në kishë me shpresë që të shihnin të dashurat e tyre e për t'u kënaqur pak në mes të mynxyrës. Dhe, për fat, të dashurat e tyre ndodheshin në grupin e shtatë vashave, prej të cilave disa ishin edhe farefis me ta.

Sapo u ra në sy grupi i vashave dhe vashat i panë këta, Pampineja, duke vënë buzën në gaz, u tha shoqeve:

⁴ Emra të krijuar me fjalë greqisht, ashtu siç janë edhe emrat e shërbëtorëve që vinë më poshtë.

- Ja se si fati po u ndih qëllimeve tona, ja ku na paraqiten trima të matur dhe të zotë, të cilët do të pranojnë me gjithë qejf të bëhen udhëheqësit dhe shërbyesit tanë, po t'i ftojme në këtë punë.

Neifila atëherë, e skuqur në fytyrë si prushi nga turpi, pasi ishte e dashura e njerit prej trimave, tha:

- O Zot! Mendo pak, Pampine, se ç'po thua. Unë jam e bindur se këta janë njerëz të fortë e të mirë, ndofta edhe më të mirë nga ç'duhet të jenë. Po ashtu, mendoj, se shoqërimi i tyre do të ishte i mirë dhe i nderuar jo për ne, por edhe për të tjera më të bukura dhe më të hijshme se ne, por, meqenëse dikush prej tyre i vjen rrotull ndonjëres prej nesh, na duhet të kemi pak mendjen, sepse sapo t'i marrim të na udhëheqin, kam frikë se, pa pasur faj as ne as ata, bota do të na marrë në gojë dhe do të na humbasë emri i mirë që kemi.

- Kjo ne s'na prish fare punë, - tha Filomena, - gjersa unë rroj me nder dhe e kam ndërgjegjen të qetë, njerëzit le të thonë ç'të duan. Zoti dhe e vërteta kanë për të marrë armët në mbrojtjen time. Moj, në qoftë se ata pranojnë të vinë me ne, ashtu siç tha Pampineja, s'kam dyshim se fati do të na ndihmojë në nisjen tonë.

Vashat e tjera, duke dëgjuar këto fjalë, jo vetëm s'kundërshtuan, por njëzëri të gjitha vendosën t'i thërritnin trimat për t'iu shfaqur qëllimin e tyre dhe për t'iu lutur që të kishin mirësinë t'i shoqëronin në këtë udhëtim. Kështu, pa i zgjatur fjalët, Pampineja, e cila ish edhe kushërira e njerit prej trimave, u çua në këmbë dhe u drejtua tek ata, të cilët kishin qëndruar dhe po i vështronin për së largu. I përshëndeti me fytyrë të gëzuar, u shfaq vendimin që kishin marrë dhe iu lut, edhe nga ana e shoqeve, që t'i shoqëronin si miq e si vëllezër aty ku do të venin.

Në të parë trimat pandehën se ato talleshin, por, pastaj, si panë që ato e kishin me gjithë mend, iu përgjigjën se do t'i shoqëronin me gjithë dëshirë dhe pa humbur kohë. Para se të dilnin nga kisha, vendosën mbi gjithçka që duhej të bënin për nisjen.

Kështu, përgatitën mirë e bukur gjithë gjërat e nevojshme dhe i nisën më parë te vendi që kishin caktuar. Të nesërmen në mëngjes, që gdhihej e mërkurë, sapo zuri të hapte dita, vashat të shoqëruara prej disa shërbëtorëve dhe trimat prej qehajave të tyre, dolën nga qyteti dhe nisën rrugën. Pasi ecën nja dy milje, arritën te vendi që kishin caktuar.

Vendi ishte majë një bregu të lartë, nga çdo anë i mënjanuar nga rrugët, rreth e qark i veshur me drurë të ndryshëm e me bimë të gjelbra që t'i kish ënda t'i shihje. Në majën e bregut, ngrihej një pallat madhështor me një oborr të madh e të bukur në mes, rrethuar me qemerë po të bukur. Sallonet dhe dhomat e tij, të gjitha të bukura e të qeshura, ishin të stolisura me

piktura të këndshme. Rreth e qark shtriheshin livadhe dhe kopshte me puse që kishin ujë të ftohtë akull. Qilarët e pallatit ishin dëng me verë nga më e mira, e vlefshme për pijanikë të pangopur, por jo për vasha të velura dhe të ndershme. Miqtë e rinj e fshinë dhe e pastruan mirë e mirë të gjithë pallatin, shtruan shtretër dhe në çdo anë vunë lule dhe barëra aromatike, meqenëse ishte stina e tyre.

- Urtësia juaj, o vasha, më tepër se zgjuarsia jonë, na ka sjellë këtu - tha Dioneu. - Nuk di ç'keni vendosur t'i bëni brought tuaja, se unë të miat i lashë brenda portave të qytetit sapo u largova prej andej bashkë me ju. Prandaj, ose bëhuni gati të qeshim, të këndojmë dhe të brohorasim së bashku (natyrisht aq sa është e hijshme për dinjitetin tuaj), ose më jepni leje të kthehem prapë në hallet e mia dhe të vete të rri në qytetin e martirizuar.

Pampineja, e cila, po ashtu, i kishte lënë mënjatë brought e saj, iu përgjigj e gëzuar:

- Fjalë me vend thua o Dione. Po, duhet të brohorasim dhe ky ka qenë i vetmi shkak që u larguam nga hidhërimet. Por, meqenëse s'është e mundur që një shoqëri të vijojë gjatë pa një rregullore dhe meqenëse kam qenë unë shtytësja e formimit të një shoqërie kaq të bukur, e quaj të arsyeshme t'ju parashtroj se, për të vijuar shoqërinë tonë, të zgjidhet midis nesh si drejtues një kryetar, të cilin, ne të tjerët, ta nderojmë dhe t'i bindemi. Ky duhet të përqendrojë të gjithë fuqinë e mendjes së tij për të na e bërë sa më të gëzueshme jetën. Dhe, me qëllim që secili prej nesh ta provojë barrën e drejtimit dhe njëkohësisht edhe kënaqësinë e epërsisë dhe, që mos t'i vijë keq ndokujt se mos nuk qëllon të zgjidhet, mendoj që zgjedhja të bëhet midis dy sekseve, në mënyrë që çdo një nga ne të ketë mundësi të zgjidhet për një ditë, duke marrë përsipër përgjegjësitë dhe të drejtat e drejtimit. Ai që do të bëhet i pari kryetar, le të zgjidhet nga ne të gjithë. Ata që do të zgjidhen pas këtij, do t'i caktojë, aty afër muzgut, ai ose ajo që do të ketë qenë kryezoti i ditës, duke barrosur kë të dojë midis meshkujve dhe femrave që s'janë zgjedhur dhe, ai që do të zgjidhet, le të vendosë dhe të japë urdhrat e duhura, sipas dëshirës së vet, mbi vendin dhe mënyrën se si do të kalojmë kohën për periudhën gjatë së cilës do të vijojë sundimi i tij.

Këto fjalë të Pampinesë u pëlqyen fort dhe njëzëri u zgjodh kjo mbretëreshë për të drejtuar ditën e parë dhe Filomena, që dinte se fletët e dafinës mbahen në nderim të madh dhe se e bëjnë të denjë për nderime atë që e ka merituar të kurorëzohet, vrapoi sakaq te një dafinë, këputi ca degë, bëri një kurorë nderimi madhështore e të bukur dhe ia vuri mbi krye. Prej këtij çasti, kurora do të bëhej shenjë zotërimi mbretëror dhe madhështie për të gjithë ata që do të zgjidheshin gjersa të zgjaste shoqëria.

Me t'u bërë mbretëreshë, Pampineja dha urdhër të heshtnin të gjithë, pastaj dërgoi e thirri tre shërbëtorët e trimave dhe katër shërbëtoret e vashave dhe, në heshtje të përgjithshme, tha këto fjalë:

- Që t'ju jap unë e para shembullin të gjithëve, që shoqëria jonë të shkojë mir'e më mirë, që të zgjasë aq sa të na pëlqejë me rregull dhe me dëfrime dhe pa ndonjë gjë të pahijshme, unë së pari caktoj Parmenin, shërbëtorin e Dioneut, si ministrin tim të Oborrit dhe i jap si detyrë të përkujdeset për qeverisjen e të gjithë familjes sonë dhe për gjithçka që i përket shërbimit të sallës së të ngrënit. Sirisku, shërbëtori i Panfilit, dua të jetë arkëtari ynë dhe të përmbushë pikë për pikë urdhrat që do të marrë nga Parmeni. Tindari, shërbëtori i Filostratit, do të shërbejë jo vetëm në dhomën e të zot, por edhe në dhomat e dy zotërinjve të tjerë, në rast se shërbëtorët e tyre do të jenë të zënë me punë të tjera. Misia, shërbëtorja ime, dhe Liçiska, shërbëtorja e Filomenës, do të rrinë kurdoherë në kuzhinë dhe do të gatujnë me kujdes gjellët që do t'u urdhërojë Parmeni, Kimera e Lauretës dhe Stratilja e Fjametës, dua që të kenë kujdes dhe dhomat e grave, dhe pastrimin e vendeve ku rrimë. Dua dhe urdhëroj, më së fundi, që të gjithë sa jemi të kënaqemi vërtet në shoqërinë tonë. Të keni mendjen në çdo vend që të veni, nga çdo anë që të ktheheni, nga çdo gjë që të shihni ose të dëgjoni. Këtu të mos na sillni tjetër gjë nga jashtë, veç lajme të gëzueshme.

Pasi dha këto urdhra të shkurtra që u pëlqyen të gjithëve, u ngrit e gëzuar dhe tha:

- Këtu ka kopshte e luadhe, këtu gjenden kaq vende të këndshme; shkoni të gjithë ndër to, dëfrehuni gjer në orën nëntë dhe pastaj kthehuni të hamë bukë në një vend të freskët.

Si u lejuan prej mbretëreshës së re, të gjithë së bashku, trimat dhe vashat e bukura, u larguan me hapa të ngadalshëm, duke biseduar për shumë gjëra të këndshme. Pastaj hynë në një kopsht, ku e shkuan kohën me kënaqësi, kush duke gërshtuar kurora me gjethe të ndryshme e kush duke kënduar kënga të përmallshme.

Pasi qëndruan aq sa u kish thënë mbretëresha, në orën e caktuar, u kthyen në shtëpi ku panë se Parmeni kishte nisur si jo më mirë detyrën e tij. Salla e të ngrënit në katin përdhes ishte përgatitur për bukuri. Tryezat ishin shtruar me peceta të bardha si bora dhe me gota që dukeshin si prej argjendi. Çdo enë ishte stolitur me lule gjineshtre. Këtu, sipas urdhrat të mbretëreshës, të gjithë shpëlanë duart dhe u ulën të hanë në vendet që u kishte caktuar Parmeni.

Të tre shërbëtorët shërbenin në heshtje. Gjellët që shërbeheshin ishin fort të shijshme dhe të lehta, vera ishte nga më e mira. Meqenëse rregulli që

mbretëronte i kënaqi të gjithë, e kaluan darkën plot gëzim, brohori e shakara të bukura.

Pasi mbaruan darkën, meqenëse të gjithë, vasha e trima, dinin të hiqnin valle dhe disa syresh dinin t'u binin veglave muzikore dhe të këndonin fare mirë, mbretëresha dha urdhër të sillnin veglat dhe po me urdhrin e saj, Dioneu mori në dorë një lahutë dhe Fjameta një violë dhe që të dy nisën t'u binin me ëmbëlsi. Atëherë mbretëresha, pasi dërgoi shërbëtorët për të ngrënë, bashkë me të gjitha shoqet dhe me dy trimat, zuri e hoqi një valle me hap të ngadalshëm. Pas valles vijuan këngë të ëmbla e të gëzueshme.

Kështu mbetën gjersa mbretëresha pa se erdhi koha e fjetjes. Atëherë i lejoji të gjithë të tërhiqen. Të tre trimat vajtën në dhomat e tyre të veçuara nga ato të vashave. Si trimat dhe vashat i gjetën dhomat e tyre me shtretër të shtruar për bukuri dhe të stolisur me lule si salla e të ngrënit. Në këtë mënyrë, secili u zhvesh dhe ra të flejë.

Pas cazë, aty nga ora tre, mbretëresha u ngrit dhe dërgoi e ngriti të gjithë të tjerët, sepse mendoi se gjumi i shumtë i ditës ishte i dëmshëm. Si u ngritën, vajtën të gjithë në livadh, ku bari gjelbëronte dhe rrezet e diellit s'mund të hynin nga bimët që i rrethonin. Aty, përmes fladit të ëmbël që frynte, sipas urdhrin të mbretëreshës, u ulën të gjithë mbi bar, duke krijuar një qark të vogël dhe zunë të dëgjonin mbretëreshën që u thoshte:

- Sikundër e shihni, diellin e kemi mbi kokë dhe vapa është e madhe, s'dëgjohet gjë tjetër veç gjinkallës nga ullinjtë, prandaj, sikur të vemi gjëkund gjetkë, do të ish marrëzi. Këtu vendi është i bukur dhe i freskët dhe, sikundër e shihni, kemi tavllë e shah me të cilat secili mund të dëfrehet sipas dëshirës. Dhe, veç këtyre, në qoftë se më dëgjoni mua, do t'ju tregoj një tjetër mënyrë sesi ta shkojmë më mirë kohën. Në lojë, ju e dini se ca gëzohen e ca hidhërohen, se ca fitojnë e ca humbasin, ndërsa ata që rrinë e shikojnë, s'provojnë ndonjë kënaqësi. Ne, për të shkuar këtë copë vapë, - them unë, - është e mira, - se kështu do të kënaqemi të gjithë, - që të kallëzojmë nga një rrëfenjë për shoq. Para se të mbarojmë, duke kallëzuar secili nga një rrëfenjë, dielli ka për të perënduar dhe vapa ka për të pushuar, kështu, atëherë mund të vemi të dëfrehemi ku t'ju pëlqejë. Pra, në ju pëlqeftë mendimi im, - pse unë s'dua t'i prish qejfin njeriu, - bëjmë si them unë, përndryshe, secili të bëjë si t'i pëlqejë gjersa të ngryset.

Si vashave ashtu edhe trimave u pëlqeu fort mendimi i mbretëreshës që të kallëzonin rrëfenja.

- Meqenëse ju pëlqyeka, - tha mbretëresha, - atëherë, për ditën e sotme dua që secili të flasë mbi një temë të lirë.

Dhe, si u drejtua nga Panfili, që e kishte në të djathtë, i tha me ëmbëlsi të fillonte ai i pari me ndonjë nga rrëfenjat që dinte.

Me të marrë urdhrin nga mbretëresha, ndërsa të tjerët zunë të dëgjonin, shpejt e shpejt, Panfili filloi rrëfenjën e tij.

Dita e parë, rrëfenja e parë

Çepareloja, njeri i të nëntëdhjetë e nëntave, kur i arrin dita e vdekjes gënjen një frat të shenjtë në të rrëfyer dhe për gënjeshtat që bën, pas vdekjes merret si shenjt dhe quhet Shën Çapalet.

Është e udhës që çdo punë që bën njeriu, vasha të dashura, ta nisë nga emri i mrekullueshëm dhe i shenjtë i atij që është krijuesi i gjithësisë. Prandaj, duke qenë se më përket mua të filloj kallëzimin e rrëfenjës së parë, po e nis me një nga mrekullitë e tij. Rrëfenja ime do të na e mbushë mendjen t'i vëmë të gjitha shpresat tek Ai dhe të lëvdojmë kurdoherë emrin e Tij.

Sikundër shihet sheshit, gjërat e kësaj bote janë të gjitha të përkohshme dhe jetëshkurtra, ato janë në vetvete plot mërzi, brenga, mundime e rreziqe dhe ne që jetojmë me to dhe jemi pjesë e tyre, as nuk do t'i duronim e as nuk do të mbroheshim dot prej tyre, posaqë mëshira e Perëndisë të mos na jepte fuqi dhe ndihmë kundër tyre. Por, s' duhet të pandehim se mëshira e Perëndisë na është falur se e kemi merituar. Këtë mëshirë e kemi nga mirësia e Tij dhe lutjeve ndaj atyre që dikur kanë qenë njerëz vdekatarë si dhe ne, dhe që më pas janë bërë të pavdekshëm dhe të bekuar pasi, sa qenë gjallë, zbatuan urdhrat e Tij. Këtyre shenjtërve që janë si mbrojtësit tanë e që i njohin nga përvoja e tyre dobësitë e njeriut, duhet t'u drejtojmë lutjet tona për të pasur ato që dëshirojmë, pasi na mungon kuraja t'ia kërkojmë vetë drejtpërdrejt Perëndisë.

Veçse, duke qenë të sigurt në mëshirën e Tij të pafundme, na qëllon ngandonjëherë të gënjahemi dhe, duke mos mundur ta shohim mirë me sytë tanë fshehtësinë e mendjes së Tij të hyjnueshme, vëmë si ndërmjetës pranë Tij, të gënjer nga mendimi i përgjithshëm, ndonjë që është i dënuar prej Tij të rrojë në mërgim të përhershëm. Megjithëkëtë, Perëndia, që njeh gjithçka e dëgjon cilindo që i drejtohet, sikur ndërmjetësi të ishte një prej të zgjedhurve dhe jo prej të dëbuarve prej Tij, ka këqyrë më tepër qëllimin e mirë të atij që lutet, sesa paditurinë e tij për ndërmjetësin dhe i përgjigjet atij. Kjo gjë do

të shihet sheshit në rrëfenjën që do të kallëzoj: sheshit them, duke ndjekur gjykimin e njerëzve, jo atë të Perëndisë.

Thuhet, pra, se njëfarë Mushat Francezi, tregtar i madh e shumë i pasur, na u paskësh bërë kalorës dhe iu desh të shoqëronte në Toskanë vëllanë e mbretit të Francës, Karlin e Patokë, të cilin e kishte ftuar aty papë Bonifaçi. Mirëpo, duke qenë se punët e tij, sikundër iu ndodh dundur tregtarëve, i kishte të ngatërruara tej e këtej dhe nuk do të mund t'i rregullonte aq lehtë në kohën e duhur, mendoi se më mirë t'ua bënte barrë disa njerëzve të tjerë, dhe për çdo punë e gjeti njeriun e duhur. Vetëm për të mbledhur të hollat që i detyroheshin shumë prej burgonjasve e kishte të vështirë dhe nuk vendoste dot.

Shkaku që s'mund të vendoste mbi këtë, ishte se e dinte se burgonjasit ishin njerëz grindarë, të ligj dhe të pabesë, dhe s'besonte të gjente një njeri aq të prapë sa, me anën e tij, t'i bënte ballë prapësisë së tyre.

Si mendoi gjatë, më së fundi iu kujtua një njeri nga Pratoja, i cili kish për zakon të kërkonte strehë ngandonjëherë në shtëpinë e tij në Paris e quhej Çeparel, por, meqë ishte trupvogël dhe i pispillosur mirë, francezët, duke mos ditur se ç'do të thoshte fjala Çeparel, pandehnin se një emër i tillë do të thoshte kurorë në gjuhën e tyre dhe në vend që të thërrisnin Çeparel, e thërrisnin Çapelet, me zvogëlim, meqenëse, sikundër thamë, ishte trupvogël. Kështu, të gjithë e njihnin me këtë emër. Ishin të paktë ata që e quanin Çeparel.

Doni të dini tani se çfarë njeriu ka qenë ky Çapeleti? Ja: duke ushtruar profesionin e tij si noter, e kishte për turp të madh, po të mos gjendej i falsifikuar një nga aktet e shumta të bëra prej tij. Mashtrime të këtilla mund të bënte sa të donte, dhe i bënte me qejf më të madh darovisht, se sa më shpërblime të mëdha, siç i bënin të tjerët. Dëshmitë e rreme i bënte me ëndje të madhe, qoftë në ishte i ftuar për të dëshmuar, qoftë i paftuar fare dhe, meqenëse ndër ato kohë në Francë u zihej më shumë besë betimeve dhe ai nuk kundërshtonte për të dhënë betime të rreme, kishte ftuar me poshtërsi të gjithë paditë, në të cilat ishte ftuar të thoshte të vërtetën mbi sa dinte.

E kishte për gëzim të madh të bënte ç'mundte për të shkaktuar ligësi, armiqësi e skandale midis miqsh, kushërinjsh e çfarëdo njerëzish të tjerë dhe, sa më shumë të këqija rridhnin nga këto orvatje, aq më i gëzuar ndihej. Po ta ftonte kush si dëshmitar në ndonjë vrasje ose tjetër prapësi, nuk thoshte kurrë jo, por vente gjithë gëzim. Shumë herë ishte ndodhur vullnetarisht për të vrarë apo për të plagosur njerëz me duart e veta. Ishte mallkues i madh i Perëndisë e i shenjtorëve, ish zemërak si askush tjetër. Zemërohej edhe për gjëra fare të vogla.

Në kishë s'vente kurrë, sakramentet e saj i tallte me fjalë të neveritshme, përkundrazi, vizitonte me ëndje të madhe mejhanet e vendet e turpit. Për femra kishte aq mall, sa kanë qentë për shkopin, por, nga ana tjetër, dëfrehej me burra më keq nga çdo derëmbyllur. Mund të grabiste dhe të vidhte të gjithë me atë ndërgegje që njeriu zemërbardhë ndan lëmosha; ish hamës i madh e pijanec i dëgjuar, aq sa nganjëherë pirja e tepër e katandiste si mos më keq. Ish kumarxhi i madh dhe i përmendur në të hedhurin e zareve me hile. Po pse po zgjatem kaq tepër? Ai ishte më i ligu njeri që mund të ketë parë bota. Mashtrimet për një kohë të gjatë i kishin shtuar pasurinë dhe i kishin ngritur emrin dhe kjo e shpëtonte atë si nga njerëzia, të cilëve shpesh u sillte ngatërresa, edhe nga qeveria, të cilën s'e linte kurrë të qetë.

Si i erdhi ndër mend ky farë Çapelet zotit Mushat, i cili e njihte mjaft mirë, mendoi se ky do të ishte pikërisht ashtu siç e lypte poshtërsia e burgonjasve, prandaj dërgoi e thirri dhe i tha:

- Ti e di tani, zoti Çapelet, se unë po largohem krejt së këtejmi dhe, meqenëse kam të bëj, përveç të tjerëve, edhe me burgonjasit, që janë njerëz plot gënjeshtër, s'di kujt t'i drejtohem më mirë se ty për të më mbledhur të hollat që kanë për të më dhënë, prandaj, meqenëse ti tani je pa punë, në do të marrësh përsipër këtë barrë, unë kam për të të siguruar ndihmën e oborrit mbretëror dhe kam për të të falur një pjesë të arsyeshme të të hollave që ke për të më mbledhur.

Çapeleti, duke parë veten pa punë dhe pa pëllëmbë tokë dhe duke parë, nga ana tjetër, që dhe i vetmi njeri që kishte pasur si mbështetës dhe mbrojtës për shumë kohë po i largohej, deshi-s'deshi, iu përgjigj se pranonte me gjithë zemër. Me këtë mënyrë lidhën fjalën.

Z. Mushat që në fillim i dorëzoi Çapeletit letërpërfaqësimin e tij dhe letërsigurimin e mbretit, sikundër i pat premtuar.

Sapo z. Mushat u nis, Çapeleti arriti në Burgonjë, ku thujse nuk e njihte kurrkush. Aty, kundër natyrës së tij, e nisi urtë e butë mbledhjen e të hollave dhe përmbushjen e detyrës që i qe ngarkuar, sikur të mos donte ta tregonte veten, veçse në fund fare.

Kur po merrej kështu me këto punë, kishte rënë si mik në shtëpinë e dy vëllezërve fjorentinë, që merreshin me lëshimin e parave me kamatë, të cilët, për hatër të zotit Mushat, e mbanin me shumë nderime. Por, papritur e pa kujtuar, Çapeleti na u sëmur dhe të dy vëllezërit i prunë mjekë e shërbëtorë për t'i shërbyer e për t'u kujdesur në çdo mënyrë.

Mirëpo çdo ndihmë ishte e kotë. I uruari Çapelet, që ishte plak dhe kishte bërë një jetë të çrregullt, me sa thoshte mjeku, bëhej nga dita në ditë më keq

dhe s'kishte shpresë të shpëtonte. Një gjë e tillë i dëshpëroi shumë të dy vëllezërit dhe një ditë, zunë të flisnin midis tyre në një vend afër dhomës ku dergjej i sëmurë Çapeleti.

- Ç'ta bëjmë ne këtë? - i thoshin njëri-tjetrit, - na ka zënë hall i madh me të. Në qoftë se e nxjerrim jashtë nga shtëpia të sëmurë siç është, do të tregohemi të pamatur dhe do të merremi nëpër gojë. Ç'do të thotë bota për ne që e pritëm, i shërbyem dhe e mjekuam me kujdes, kur të na shohë ta flakim jashtë të sëmurë për vdekje pa na bërë ndonjë të keqe? Nga ana tjetër, ky ka qenë kaq njeri i keq, saqë s'ka për të pranuar kurrë të rrëfëhet te prifti as ka për të dashur sakramentet e kishës dhe, duke vdekur pa u rrëfyer, asnjë kishë s'ka për ta pranuar kufomën e tij, madje ka për t'u hedhur në ndonjë gropë si qen. Por, edhe në qoftë se rrëfëhet, mëkatet e tij janë kaq të shumta dhe kaq ngjethëse, sa prapë ai fat ka për t'i takuar, se s'besoj të ndodhet ndonjë frat a prift që të mund të falë mëkate si të tijat, prandaj ai njeri i ngarkuar me mëkate, prapë ka për të përfunduar në gropë. Në rast se ngjan një gjë e tillë, vendasit këtu, të cilët s'duan të na shohin me sy, për shkak të punës sonë që iu duket shumë e keqe dhe që përherë na i hedhin në sy, po të shohin edhe këtë gjë, me qëllim që të na vjedhin pasurinë, do të ngrihen kundër nesh dhe kanë për të bërtitur "s'duhën mbajtur më këtu këta qen lombardas¹, që s'i pranon as kisha" dhe kanë për të na grahur në shtëpi, e për fatin tonë të keq, jo vetëm kanë për të na grabitur pasurinë, por mbase kanë për të na marrë edhe shpirtin. Prandaj, sidoqoftë, në qoftë se ky vdes, pisk e kemi punën.

Çapeleti që, siç thamë, dergjej aty afër ku këta po fjaloseshin, duke i pasur veshët pipëz, sikundër iu ndodh shpesh të sëmurëve, i dëgjoi të gjitha ç'thoshin për të, i thirri e u tha:

- Unë s'dua t'ju shqetësoj, s'dua të keni frikë se mos pësoni ndonjë të keqe nga shkak i im. Unë i dëgjova të gjitha ç'thoshit për mua dhe jam i sigurt se do të ngjante ashtu siç thoshit ju po të vente puna si e mendonit ju, por mos u trembni se puna s'vete ashtu. Unë, në jetën time e kam fyer aq shumë Perëndinë, saqë nuk do t'i shtoj as nuk do t'i pakësoj mëkatet e mia, në qoftë se e fyej edhe një herë një orë tjetër përpara vdekjes. Prandaj shkoni e më sillni këtu ndonjë frat të shenjtë dhe të zotë, sa më të mirë që të jetë e mundur, dhe lërmani mua në dorë punën, se e di vetë si ta rregulloj në dobinë time dhe tuajën. Do të shihni dhe do të mbeteni të kënaqur.

Të dy vëllezërit, sado që s'para u bindën nga fjalët e tij, vajtën në një vend fretërisht dhe kërkuan një frat të shenjtë e të urtë që të vente të dëgjonte

⁵Lombardas quheshin në Francë, atëherë, italianët përgjithësisht dhe tregtarët veçanërisht. Duhet shënuar se, sipas ligjeve të kohës, fajdexhinjtë ishin të mallkuar dhe s'mund të hynin në kishë.

rrëfimin e lombardit, i cili dergjej i sëmure në shtëpinë e tyre. Atëherë gjetën një frat të vjetër që kishte pasur një të kaluar të shenjtë dhe që ishte mjeshtër në shkrimet e shenjta. Të gjithë qytetarët kishin një nderim të veçantë për këtë njeri.

Sapo frati arriti në dhomën ku dergjej Çapeleti dhe iu ul afër në krah të tij, filloi ta ngushëllonte me të mirë dhe pastaj ta pyeste se sa kohë kishte që nuk ishte rrëfyer. Çapeleti që s'ishte rrëfyer kurrë në jetën e tij, iu përgjigj:

- Ati im, unë e kam për zakon të rrëfhem të paktën një herë në javë dhe në disa raste jam rrëfyer edhe më dendur, por, tani, e vërteta është se, nga tetë ditë e tëhu që kam qenë sëmure, s'kam mundur të rrëfhem se më ka mposhtur sëmundja.

- Mirë ke bërë, biri im, - i tha frati, - dhe kështu duhet të bësh dhe paskëtaj e, meqenëse rrëfesh kaq dendur, me sa shoh unë, s'do të mundohem shumë që të të pyes e të të dëgjoj.

- Ah, - bëri Çapeleti, - mos thoni kështu uratë! Unë sado herë që rrëfhem e kam për zakon t'i rrëfej të gjitha mëkatet që mbaj mend të kem bërë që nga dita e lindjes sime gjer te dita e rrëfimit dhe, prandaj, ju lutem uratë, që kështu, pikërisht, të më pyesni për çdo gjë, mu sikur të mos isha rrëfyer kurrë dhe mos mendoni se jam i sëmure, se për mua është më mirë t'i mendoj këto mishra sesa, duke i lënë të qeta, të shkaktoj humbjen e shpirtit tim që Shpëtimtari ynë e ka shëlbyer me gjakun e tij të vlefshëm.

Këto fjalë i pëlqyen fort uratës, i cili kuptoi se fjalët e tij rridhnin prej një ndërgegjeje të kthjellët e të kulluar dhe, si ia lëvdoi shumë këto zakone, zuri ta pyeste Çapeletin se mos vallë kish rënë ndonjëherë në mëkat në dëfrime seksuale me ndonjë grua.

- O ati im, - iu përgjigj Çapeleti, duke nxjerrë një psherëtimë të thellë, - më vjen turp, për Zotin, t'ju them të vërtetën mbi këtë pikë dhe trembem se mos bie në ndonjë mëkat mendjemadhësie.

- Fol mor bir, pa frikë, - i tha frati i shenjtë, - se njeriu kur thotë të vërtetën s'bie kurrë në mëkat.

- Meqenëse më siguroni për këtë, - iu përgjigj Çapeleti, - atëherë po ju them: unë edhe tani që po rrëfhem jam i virgjër, uratë, ashtu si kam dalë nga barku i nënës.

- Ah, qofsh i bekuar nga Perëndia! - tha frati, - sa mirë paske bërë! Ti, duke bërë kështu, ke fituar një lavdi shumë të madhe, se, po të doje, e kishe në dorë fare mirë të bëje edhe të kundërtën, gjë që s'mund ta bëjmë vetëm ne fretërit dhe të gjithë ata që i janë nënshtruar ndonjë urdhri.

Pastaj frati e pyeti mos vallë i kishte prishur ndonjëherë qejfin Perëndisë me mëkatën e grykësisë. Çapeleti, duke psherëtirë nga fundi i zemrës, i tha

se ia kishte prishur qejfin kushedi sa herë, sepse, sipas fjalëve të tij, përveç kreshmës së zakonit që mbajnë njerëzit fetarë, kishte zakon të mbante kreshmë, të paktën, edhe tri ditë të tjera në javë, duke qëndruar vetëm me bukë e ujë dhe në kësi rastesh, thoshte, mbante mend se kishte pirë ujë me kënaqësi dhe me etje të madhe, ashtu si pijanecët e mëdhenj kur gjenden përpara pijeve dhe, sidomos, shtonte, se i kishte ndodhur kjo fatkeqësi atëherë kur e kishte ndier veten tepër të lodhur nga lutjet e shumta që bënte, ose nga të udhëtuarit për në vende të shenjta. Shtonte, pastaj, se i tekej nganjëherë të hante njëfarë sallate me barishte, ashtu si bëjnë gratë kur dalin për verim dhe nganjëherë të ngrënit i qe dukur më i shijshëm sesa duhet t'i dukej një njeriu që mbante kreshmë për devocion, sikundër bënte ai.

- Këto janë mëkate të natyrshme dhe janë shumë të lehta, biri im, - ia ktheu frati, - prandaj nuk dua ta rëndosh ndërgjegjen më tepër nga ç'është e udhës. S'ka njeri, sado i shenjtë që të jetë, që të mos i duket i mirë të ngrënë pas një kreshme të gjatë dhe të mos i pëlqejë të pirët pas lodhjes.

- Ju lutem, - i tha Çapeleti, - ati im, mos m'i thoni këto për të më ngushëlluar. Ju e dini mirë se unë s'jam aq mendjelehtë sa të mos kuptoj që shërbesat që bëhen për lavd të Perëndisë, duhen bërë krejt të pastra, pa asnjë ndryshk shpirti dhe kushdo që bën ndryshe, bie në mëkat.

- Jam i gëzuar që mendon kështu, - i tha frati fort i kënaqur nga fjalët e tij, - dhe më pëlqen fort ndërgjegjja jote e pastër dhe e mirë në këtë pikë. Po, pa më thuaj, a ke bërë mëkat në koprraci, duke lakmuar më tepër nga ç'është e udhës, apo duke mbajtur gjësendi që s'të përkiste?

- Ati im, - tha Çapeleti, - mos pandehni se rri në shtëpinë e këtyre fajdexhinjve dhe jam si këta, unë s'kam të bëj fare me ta, përkundrazi, kisha ardhur për t'u hequr veshët dhe për t'i qortuar të hiqnin dorë nga një punë kaq e neveritshme dhe besoj se do t'ia kisha arritur qëllimit, po të kishte dashur Perëndia e të mos isha sëmurur. Ju duhet të dini se im atë më la të pasur, por pjesën më të madhe të pasurisë unë e ndava për hir të Perëndisë dhe, pastaj, për të jetuar dhe për të ndihmuar të varfrit e Krishtit, jam marrë me tregti të vogla. Në këto tregti kam lakmuar që të fitoj, por ato ç'kam fituar i kam ndarë përherë përgjysmë me të varfrit e Krishtit: gjysmën e fitimeve ua kam dhënë këtyre dhe gjysmën tjetër e kam përdorur për nevojat e mia. Në këtë punë më ka ndihmuar shumë Krijuesi, sepse gjithnjë punët më kanë shkuar mirë e më mirë.

- Mirë paske bërë, - i tha frati, - por, je zëmëruar gjë dëndur?

- Po, - iu përgjigj Çapeleti, - po jua them: shumë herë jam zemëruar. Dhe, kush mund ta mbajë veten, kur sheh tërë ditën njerëz që bëjnë punë të pështira, të mos bëjnë si ka urdhëruar Perëndia dhe të mos u tremben

gjykatësve të Tij? Shumë herë brenda një dite me ka qëlluar të doja më mirë të vdisja, sesa të mbetesh gjallë, kur shihja djem që venin pas punësh të kota, duke i parë të betoheshin e të bënin be të rreme, të venin nëpër mejhane, të mos venin në kishë e të ndiqnin më shumë rrugën e djallit, sesa të Perëndisë.

- Ky zemërim, - ia priti frati, - është me vend, saqë as di sesi të të detyroj për pendesë. Po, në ndonjë rast, nuk të ka qëlluar të të mposhtë zemërimi e të bësh ndonjë vrasje, ose të fyesh njeri, a të bësh ndonjë punë tjetër të paudhë?

- Ah uratë, - ia ktheu Çapeleti, - e ç'më thoni kështu? Ju më dukeni njeri i Perëndisë: si m'i thoni këto fjalë? Po sikur dhe një mendim të vogël të kisha pasur për të bërë njërën cilëndo nga këto gjëra që më thoni, a besoni ju se Perëndia s'do më kishte dënuar? Këto gjëra mund t'i bëjnë kriminelët e njerëzit e ligj. Sado herë që kam parë ndonjë të këtillë, i kam thënë "Perëndia të sjellte mend në kokë".

- Po tani, pa më thuaj, biri im, - i tha frati, - që qofsh bekuar nga Zoti, a ke dalë ndonjëherë dëshmues i rremë kundër ndokujt, a ke folur keq për ndonjë, ose i ke marrë gjë ndokujt kundër dëshirës së tij?

- S'mund ta mohoj, uratë, - iu përgjigj Çapeleti, - se s'kam folur keq për njeri. Njëherë kam pasur një fqinj që për turp e për faqe të zezë, s'bente punë tjetër, veç rrihte të shoqen dhe, kështu, unë, një ditë ua kallëzova çështjen njerëzve të së shoqes, duke folur keq për të dhe këtë gjë e bëra se m'u dhimbs shumë ajo e mjerë grua, të cilën, ai, sado herë që dehej, e ngordhte në dru.

- Po mirë, - i tha frati atëherë, - ti më thua se paske qenë tregtar, a ke gënjyer ndonjëherë njeri, ashtu siç bëjnë tregtarët?

- Po si, - i tha Çapeleti, - këtë s'e mohoj. Nuk di kush ka qenë njëherë që më solli ca të holla që m'i kishte borxh nga ca stofa që ia kisha shitur. Këto të holla unë i vura në një arkë pa i numëruar dhe pas ndonjë muaji gjeta që ishin dyzet qindarka më tepër. I ruajta ndonjë vit që të gjeja atë njeri dhe t'ia jepja, po si nuk e gjeta, i ndava në të varfër.

- Kjo, - i tha frati, - është një gjë pa rëndësi, por mirë bëre që veprime ashtu siç the.

Dhe, veç këtyre, frati i shenjtë e pyeti dhe mbi shumë gjëra të tjera dhe Çapeleti për të gjitha iu përgjigj në të njëjtën mënyrë. Kur frati desh i t'i shlyente mëkatet, Çapeleti i tha:

- Uratë, kam dhe mëkate të tjera që s'jua kam thënë.

Frati e pyeti për to dhe ai iu përgjigj:

- Mbjaj mend që, një të shtunë, vura shërbëtorin të më fshinte dhomën pas orës tre, duke mos treguar për të Shtunën e Shenjtë nderimin që i detyrohesh.

- Oh, biri im, - ja priti frati, - kjo është një gjë e vogël.
- Jo, - ia tha Çapeleti, - mos thoni gjë e vogël se e diela duhet nderuar shumë, se në këtë ditë u kthye nga vdekja Zoti ynë.

- Tjetër ke bërë gjë?

- Po, - tha Çapeleti, - njëherë, padashur, pështyva në kishën e Perëndisë.

- Kjo s'është gjë për t'u thënë, - i tha frati, duke vënë buzën në gaz, - ne vetë që jemi fretër pështyjmë tërë ditën në të.

- Dhe ju bëni një poshtërsi të madhe, - i tha atëherë Çapeleti, - se s'ka gjë që duhet mbajtur më pastër se tempulli i shenjtë në të cilin i flijohet Perëndisë.

Dhe, në një copë herë i tha dhe plot profka të tjera. Pastaj zuri të psherëtinte dhe më pas ia filloi një të qari me dënesë, ashtu siç dinte të bënte, kur ia lypte nevoja.

- Ç'ke biri im? - pyeti frati i shenjtë.

- Bobo! Uratë, ç't'ju them... më ka mbetur një mëkat që nuk e kam rrëfyer kurrë se më vjen turp i madh ta them dhe, sado herë që e kujtoj, qaj sikundër më shihni. Më duket se jam krejt i sigurt se Perëndia s'do ketë kurrë mëshirë për mua për shkak të saj.

- Hë, biri im, - i tha atëherë frati i shenjtë, - ç'është ai mëkat që do të më thuash? Shpirtmirësia dhe mëshira e Perëndisë janë aq të mëdha, sa sikur të gjitha mëkatet që ka bërë i gjithë njerëzimi, ose që do të bëjë sa të jetë bota, të grumbulloheshin te një njeri i vetëm dhe ai të pendohej duke ngrënë veten nga dëshpërimi, siç po bën ti dhe të rrëfehej, Zoti do t'ia falte menjëherë dhe prandaj thuaje dhe mos u ndruaj.

- Obobo, o ati im, mëkati im është shumë i madh dhe s'ma ha mendja se Perëndia do të më ndjejë pa ndërmjetësuar edhe ju me lutjet tuaja.

- Thuaje pa frikë, - tha frati, - se të jap fjalën se do t'i lutem Perëndisë për ty.

Çapeleti prapë qante e s'e thoshte mëkatin, ndërsa frati vijonte e mendohej ta bindte që ta thoshte. Si e mbajti fratin një copë herë pezull, duke qarë, pasi nxori një psherëtimë të madhe, tha:

- Ati im, meqenëse më jepni fjalën se do t'i luteni Perëndisë për mua, do t'jua them: mësoni se kur isha fëmijë fyeva njëherë time më - dhe, me të thënë këto, ia dha prapë të qarit më fort.

- Po, a të duket ky një mëkat kaq i madh, o biri im? - i tha frati, - po njerëzit mallkojnë tërë ditën Perëndinë dhe Ai i fal të gjithë ata që e kanë mallkuar dhe që janë penduar dhe ti s'beson se Ai s'do të të falë ty kaq gjë? Mos qaj, përmbahu, se sigurisht, edhe sikur të kishe qenë një nga ata që e vunë në kryq, duke qenë i penduar, siç po të shoh unë, Ai do të të falë.

- Oh, ati im, - i tha atëherë Çapeleti, - ç'po thoni? Mëmën time të dashur, që më ka mbajtur në trup të saj nëntë muaj natë e ditë? Kam bërë shumë keq që e kam fyer dhe është mëkat tepër i madh dhe po që se nuk i faleni ju Perëndisë për mua, s'ka për të ma falur.

Si e pa frati se s'kishte më ç't'i pyeste Çapeletit, i fali mëkatet dhe i dha bekimin duke e pandehur si njeri të shenjtë, pasi i kish marrë si krejt të vërteta gjithë sa i kish thënë ai. Dhe kush do të që ai që të mos i besonte, kur të shihte këtë njeri që fliste kështu në prag të vdekjes?

Pastaj frati tha:

- Me fuqi të Zotit, Çapelet, ju së shpejti do të shëroheni, por, në qoftë se ndodh që shpirtin tuaj të bekuar e të pastër ta thërresë Perëndia në qiell, do t'ju pëlqente që kufoma juaj të varrosej në kishën tonë?

- Me kënaqësi, - iu përgjigj Çapeleti, - përkundrazi, s'dua të varrosem gjatë, e para, se m'u zotuat se do t'i luteni Perëndisë për mua dhe e dyta, se unë kam pasur përherë një devocion të veçantë për Urdhrin tuaj. Prandaj, ju lutem që, sapo të ktheheni në kuvend, të më dërgoni atë të vërtetin Korp të Krishtit që ju në mëngjes e shuguroni në altar, sepse, ndonëse nuk jam i denjë për të, me lejen tuaj, dëshiroja ta kisha pas vajimit të fundit e të shenjtë, kështu që, sado që jetova si mëkatar, së paku të vdes si i krishterë.

Njeriu i shenjtë tha se i pëlqente fort mendimi i tij dhe se do t'ia dërgonte menjëherë. Kështu u bë.

Të dy vëllezërit që kishin frikë se mos i gënjente Çapeleti, ishin struktur prapa parvazeve që ndanin dhomën në të cilën dergjej ai, nga një dhomë tjetër ku ata mbanin vesh. Kështu dëgjonin, por jo kthjellët ato që i thoshte frati Çapeletit. Duke dëgjuar ato që ky i rrëfente se kishte bërë, ngandonjëherë menjë u shkripej të qeshurit dhe atëherë thoshin me njëri-tjetrin:

- Çfarë dreq njeriu qenka ky të cilit as pleqëria, as sëmundja, as frika e vdekjes së afërme, as vetë Perëndia përpara të cilit tani për pak do të paraqitet, s'kanë mundur ta luajnë nga ligësitë dhe as mos ta shtrëngojnë të mos vdesë siç ka jetuar?

Si panë që ishte bërë fjalë se do të varrosej në kishë, nuk u interesuan për gjë tjetër.

Çapeleti pas pak u kungua dhe meqenëse sa vente e po keqësohej, pati vajimin e fundit. Pastaj, si zuri të errej pak, dha shpirt po atë ditë në të cilën bëri rrëfimin që pamë. Të nesërmen, të dy vëllezërit bënë të gjitha përgatitjet e duhura dhe morën masat e nevojshme që të varrosej me nderime, natyrisht me të hollat e tij. Pas kësaj, dërguan fjalë në fretër që të venin atë natë e ta gdhinin sipas zakonit.

Frati i shenjtë tek i cili ishte rrëfyer, kur dëgjoi se kish ndërruar jetë, bashkë me *priorin*⁶ e kuvendit dhanë urdhër të grumbulloheshin në mbledhje të gjithë fretërit. Këtyre u tregoi se me sa kish kuptuar nga rrëfimi, Çapeleti duhej të kishte qenë njeri i shenjtë, dhe, duke pasur shpresë se Zoti, nëpërmjet të ndjerit, do të bënte kushedi sa mrekulli, u mbushi mendjen ta pranonin kufomën e tij në kishën e tyre me nderime e devocion të jashtëzakonshëm. Rreth kësaj pike *priori* e fretërit e besuan dhe pranuan të bënin si u tha frati i shenjtë. Atë mbrëmje vajtën të gjithë në shtëpinë e dy floquentinëve, ku dergjej kufoma e Çapeletit të cilin e gdhinë në mënyrë jashtëzakonisht madhështore. Në mëngjes, të veshur të gjithë me këmishë e mantele ceremoniale, me ungjij në duar e me kryqe përpara, e nxorën kufomën duke e kunguar dhe me ceremoni e shpunë në kishën e tyre. Pas i ndiqte thujse gjithë populli i qytetit, burra e gra, e, si e ulën në kishë, frati i shenjtë që e kish rrëfyer, hipi në predikatore dhe filloi të tregonte gjëra të mrekullueshme rreth tij, rreth jetës së tij, agjëtimeve, virgjërisë, maturisë, thjeshtësisë dhe shenjtërisë së tij. Midis të tjerash, theksoi ato që Çapeleti i kish rrëfyer duke qarë rreth mëkatit më të rëndë të tij, se si mezi kish mundur t'i mbushte mendjen se Perëndia kish për ta falur, pastaj iu drejtua turmës që po e dëgjonte:

- Dhe ju mëkatarë të T'im Zoti, një kashtë t'ju pengohet nëpër këmbë, mallkoni Perëndinë, Shën Mërinë e Shenjtorët.

Përveç këtyre, tha dhe shumë gjëra të tjera mbi besnikërinë dhe pastërtinë e shpirtit të tij dhe në një copë herë me fjalët e tij, të cilat populli i atij rrethi i besoi plotësisht, ua futi kaq fort në zemër si njeri të devotshëm, sa që me të mbaruar ceremonia, të gjithë sa ishin iu turrën grumbull kufomës për t'i puthur këmbë e duar, për t'i grisur ndonjë copë nga petkat, sepse e quanin veten të lumtur ata që mundnin t'i merrnin së paku një copë të vogël nga petkat e tij, dhe tërë atë ditë u mbajt kështu për të mos mbetur njeri pa e vizituar e pa e parë. Pastaj, në mbrëmje, e mbyllën në një arkë mermeri dhe e varrosën në kishë. Të nesërmen në mëngjes, njerëzit filluan përsëri ta vizitonin për t'i ndezur qirinj, për ta adhuruar, për t'iu lutur, për t'iu betuar dhe për t'i ngjitur fytyrë prej dylli sipas premtimit që kishin bërë.

Ndërkaq, fama e shenjtërisë dhe e devocionit për të u rrit aq, sa çdo njeri që gjendej në ndonjë të keqe, kurrë s'i lutej tjetër shenjtë, veç atij. E thirrën dhe e thërrasin edhe sot e gjithë ditën Shën Çapelet. Thuhej se Perëndia kishte bërë shumë mrekulli nëpërmjet tij dhe bëka përditë për ata që i luten atij me devocion.

⁶ Kryetari, i pari.

Kështu, pra, jetoi dhe vdiq Çapeleti nga Pratoja dhe u bë shenjt, sikundër e dëgjuat. Nuk mohoj se është e mundur që ai të jetë i lumtur pranë Perëndisë, meqenëse me gjithë poshtërsitë dhe zullumet e tij në jetë, mund të jetë penduar aq shumë në çastet e fundit, saqë Perëndia ndofta ka pasur mëshirë për të dhe e ka pranuar në mbretërinë e tij. Por, meqenëse këtë gjë ne nuk mund ta dimë, unë, me sa më duket e arsyeshme, besoj se ai mund të gjendet më tepër në duart e djajve në ferr, sesa në parajsë. Dhe, në qoftë kështu, mund të shohim shfaqur sa e madhe është kundrejt nesh mirësia e Perëndisë që nuk vë re gabimet tona, por pastërtinë e besimit dhe i dëgjon lutjet tona edhe pse ia dërgojmë nëpërmjet një njeriu që na duket i afërm i tij, por është armik i tij dhe i merr parasysht ato sikurse t'ia drejtonim me anën e një ndërmjetësi, me të vërtetë, të shenjtë. Prandaj, meqenëse për hir të tij shpëtuam shëndosh' e mirë në fatkeqësitë e tanishme dhe gjendemi në këtë shoqëri kaq të gëzueshme, duke lëvdur emrin e Tij me të cilin e filluam, t'i shprehim Atij përherë përvuajtësinë dhe nderimin tonë, t'i lutemi në nevojë dhe të jemi krejt të sigurt se do t'i dëgjojë lutjet tona.

Këtu Panfili mbaroi.

Dita e parë, rrëfenja e dytë

Çifuti Abraham, i nxitur nga Xhanotoja prej Çivinji për t'u bërë i krishterë, ndërron fenë pasi bindet se feja e krishterë lulëzon me gjithë zvetënimin e klerit të Romës.

Vashat e pëlqyen rrëfenjën e Panfilit dhe qeshën në disa pjesë të saj. Pasi e dëgjuan të gjithë me vëmendje këtë rrëfenjë, në mbarim të saj, mbretëresha i bëri zë Neifilës, që ishte pranë Panfilit, të thoshte ajo të sajën, për të vijuar në këtë mënyrë dëfrimin, ashtu siç e kishin filluar. Ajo, që ishte e stolisur për bukuri dhe me sjellje bujare, iu përgjigj e gëzuar se do ta thoshte me gjithë qejf dhe sakaq filloi:

Panfili na tregoi në rrëfenjën e tij se Perëndia me mëshirën e Tij bën sikur nuk i sheh gabimet tona, kur këto rrjedhin nga pamundësia jonë për t'i njohur. Dhe unë, me rrëfenjën time, dua t'ju tregoj sesi Perëndia me mëshirën e Tij, i duron me zemërgjerësi të metat e atyre, të cilët duhet ta dëshmonin këtë mëshirë me vepra e me fjalë dhe, prapë, bëjnë të kundërtën. Do ju tregoj se si bëhen këto gjëra argument i së vërtetës së pagabueshme të Tij dhe që ne, me bindjen më të thellë, të mund të praktikojmë atë që besojmë.

Sikundër kam dëgjuar dikur të bëhet fjalë, vasha fort të hijshme, në Paris ka qenë një tregtar i madh stofash që ish burrë dai, fort besnik e i drejtë e që quhej Xhanoto prej Çivinje. Ky zotëri na kishte miqësi të madhe me një çifut shumë të pasur që quhej Abraham, i cili, po ashtu si Xhanotoja, ishte tregtar mjaft i drejtë dhe besnik. Duke parë Xhanotoja drejtësinë dhe besnikërinë e tij, i vinte shumë keq që shpirti i një burri kaq të zotë, të urtë e të mirë, për shkak të fesë së gabuar që kishte, të shkonte në ferr. Prandaj, duke përfituar nga miqësia me të, filloi t'i lutej që ta braktiste fenë e tij të gabuar çifute dhe të kthehej në fenë e vërtetë të krishterë, të cilën, si e shenjtë dhe e vërtetë që ishte, ai mund ta shihte shkoqur që gjithnjë përparonte e shtohej në numër besimtarësh, ndërsa, përkundrazi, feja e tij gjithnjë pakësohej e zhdukej.

Çifuti iu përgjigj se, përveç fesë çifute, asnjë fe tjetër nuk i dukej as e shenjtë e as e mirë dhe se me atë fe kishte lindur dhe me atë fe mendonte të rronte dhe të vdiste. S'kishte gjë që ta tundte nga ky mendim. Xhanotos nuk iu ndenj pa ia përsëritur atë dëshirë edhe pas disa ditësh. Në mënyrë trashanike, ashtu sikundër bëjnë përgjithësisht tregtarët, i shpjegoi se për ç'arsye feja jonë ishte më e mirë se ajo çifute. Ngadalë, çifuti, sado që e njihte thellë fenë e tij, prapë, ose nga miqësia e madhe që kishte me Xhanoton, ose, ndofta, nga fjalët që shpirti i shenjtë i vë nganjëherë këto fjalë të goditura e të përshtatshme në gojën e një njeriu të paditur, filloi të tregonte interes në arsyetimet e Xhanotos. Megjithëkëtë, duke qenë i ngulur në besimin e tij, nuk bëri asnjë hap për të ndërruar fenë. Mirëpo, sa më tepër qëndronte i patundur, aq më tepër Xhanotoja vijonte ta nxiste, derisa çifuti, i mundur nga ajo këmbëngulje, i tha:

- Ja, Xhanoto, ty të pëlqen të bëhem i krishterë dhe unë jam gati të bëhem, por më parë duhet të vete në Romë, ku të shoh atë që ti thua se është përfaqësuesi i Perëndisë në tokë dhe të hetoj mënyrat e sjelljes së tij dhe, po ashtu, dhe të vëllezërve të tij kardinalë. Në qoftë se këta do të më duken të atillë që, sa nëpërmjet fjalëve tuaja, aq edhe nga vetë ata, të mund të kuptoj se feja juaj është më e mirë se imja, sikundër u përpoqe të më mbushje mendjen, unë do të bëj atë që të thashë. Po s'doli ashtu, do të mbetem siç jam.

Kur Xhanotoja dëgjoi këto fjalë, u hidhërua jashtë mase dhe tha me vete: "E humba kot mundimin që më qe dukur se e kisha përdorur shumë mirë, duke pandehur se ia kisha mbushur mendjen, sepse po të vejë ai në Oborrin e Romës dhe të shohë jetën e poshtër dhe të neveritshme të klerikëve aty, jo vetëm që i krishterë s'bëhet, po edhe sikur i tillë të ishte, çifut qe për t'u bërë". Dhe, duke iu drejtuar Abrahamit, i tha:

- Po pse, o miku im, kërkon të hysh në kaq telashe e shpenzime për të vajtur gjer në Romë? Pse kërkon të hysh në rreziqe, që, si i pasur që je mund të hasësh nëpër tokë e nëpër det? Nuk beson të gjesh këtu njerëz që të të pagëzojnë? Dhe, në qoftë se ke ende dyshime mbi fenë që të tregova, ku do të gjeje mjeshtër më të mëdhenj e njerëz më të rrahur me të se këtu, që t'i pyesësh e të të shpjegojnë çdo gjë që të duash? Për këto arsye, pas mendimit tim, vajtja jote aty është e kotë. Mendo se priftëria, si janë këtu, janë edhe aty dhe, ndofta, sa më afër bariut kryesor të gjenden, aq më të mirë janë. Prandaj, për mua, këtë mendim ruaje për një tjetër herë, për ndonjë pendesë për shembull. Atëherë, ndofta, të shoqëroj edhe unë.

- Unë e besoj, o Xhanoto, - iu përgjigj çifuti, - se është ashtu siç thua ti, por që të ta them me një fjalë, unë jam i vendosur që të vete, në qoftë se dëshiron të bëj atë për të cilën më je lutur kaq shumë, përndryshe s'mund të bëj gjë.

- Atëherë, - i tha Xhanotoja, duke parë dëshirën e tij të patundur, - udha e mbarë të qoftë!

Me vete mendoi se s'kishte për t'u bërë kurrë i krishterë, po të shihte oborrin e papës në Romë. Megjithatë, nuk e ndali se s'e kishte në dorë.

Çifuti ia shaloi kalit dhe hë e hë e shkoi në Romë ku, me të arritur, u prit me dashuri prej bashkëfshatarëve të tjerë të qytetit. Pa i kallëzuar njeriu qëllimin e vajtjes, filloi të hetonte me kujdes, për të mos rënë në sy, sjelljet e papës, të kardinalëve, të priftërinjve të tjerë dhe të gjithë oborrtarëve dhe sa pa, e kuptoi vetë, si njeri i zgjuar që ishte, dhe me sa dëgjoi edhe nga të tjerët, u bind se, që nga më i madhi, gjer te më i vogli, të gjithë klerikët, për turp e faqe të zezë, përgjithësisht ishin dhënë pas kurvërisë dhe, çka është më e keqe, edhe pas pederastisë. As mëkatet, as turpet nuk ua tronditnin ndërgjegjen. Fuqia e kurvave dhe e djemve të bukur, kur ndërhyenin për ndonjë punë, sado e madhe të ishte puna, peshonte pamasë. Përveç kësaj, ai vuri re hapur se të gjithë ishin bonjarë, të pangopur e pijanikë dejmarakë dhe sikurse shtazët, kujdesin më të madh pas kurvërisë, ia kushtonit barkut.

Duke vijuar hetimet, vuri re se të gjithë ishin koprracë e lakmues të parasë. Duke bërë tregti të madhe, shitnin e blinin pa dallim gjakun e njeriut, madje edhe të të krishterit si dhe sendet e Perëndisë, çfarëdo që të ishin, qoftë nga flijimet, qoftë nga mirëbërësia. Vendi ishte mbushur me aq shumë sekserë, sa që numri i tyre e kalonte atë të sekserëve të stofave e të sendeve të tjera të Parisit. Simonisë⁷ së dukshme i kishin ngjitur emrin "ndërmjetësi", bonjërisë "të ushqyer", sikur Perëndia të mos i njihte as kuptimet e fjalëve e as qëllimin e shpirtrave të poshtër edhe të gënjehej me emrat e sendeve, ashtu siç gënjehen njerëzit. Të gjitha këto sende dhe

shumë të tjera që s'duhet t'i përmendim, e neveritën çifutin pamasë, pasi ky ishte njeri i ngopur dhe i drejtë dhe e donte çdo gjë me masë. Pasi pa gjithë ç'mund të shihte, vendosi të kthehej në Paris dhe kështu bëri.

Xhanotoja, sapo mori vesh që ishte kthyer, pa pasur asnjë shpresë që ai të qe bërë i krishterë, i vajti dhe e përshëndeti me dashuri e me gëzim. Pastaj, pas disa ditësh që çifuti u çlodh, e pyeti sesi i qe dukur Ati i Shenjtë, kardinalët dhe oborrtarët e tjerë. Çifuti iu përgjigj menjëherë:

- Më vjen keq që Perëndia s'i përmbys gjithë sa janë. Të them kështu se, me sa kuptova unë, aty asnjë klerik nuk m'u duk të ishte pajisur me shenjtëri e devocion, s'pashë të bënte një vepër të mirë, të jepte një shembull të mirë a të bënte një gjë tjetër për të qenë. Që të gjithë ishin dhënë pas kurvërisë, koprracisë, bonjërisë e pas vesesh të tjera edhe më të këqija, nëse ka edhe më të këqija se këto. Unë e quajta atë vend më tepër një oficinë veprimesh djallëzore, sesa hyjnore. Dhe, me sa ma pret mendja, më duket se Bariu juaj dhe, për pasojë, të gjithë të tjerët, e kanë përqendruar të gjithë kujdesin dhe zotësinë e tyre djallëzore për ta zhdukur e për ta fshirë nga faqja e dheut fenë e krishtere, në vend që të ishin themelet e shtylla e saj. Dhe, meqenëse po shoh se, megjithëkëtë feja juaj po shtohet e po bëhet më e ndritur dhe më e shkëlqyer, me arsye më bëhet të mendoj se mbështetja dhe themeli i saj është Shpirti i Shenjtë që e bën atë, nga të gjitha fetë, si më të vërtetën dhe më të shenjtën. Prandaj, sado që jam treguar i ngurtë dhe i papërkulshëm ndaj këshillave tuaja, duke mos pranuar të kthehem në i krishterë, tani po ta them troç se mua s'mund të më ndalojë gjë pa u bërë. Të shkojmë, pra, në kishë dhe aty, sipas zakonit të domosdoshëm të fesë suaj të shenjtë, thuaju të më pagëzojnë atyre që merren me këtë punë.

Xhanotoja që priste një përfundim të kundërt, kur dëgjoji mikun të fliste kështu, ndjeu në shpirt një kënaqësi të thellë dhe shkoi me të shpejtë në kishën "Zonja Jonë" të Parisit për të kërkuar priftërinjtë që të pagëzonin Abrahamin.

Kur ata dëgjuan një gjë të tillë, nuk humbën aspak kohë. Xhanotoja e mbajti në Kruan e Shenjtë dhe i ngjiti emrin Xhovani e më pas, e stërviti plotësisht me anën e njerëzve të ditur të fesë sonë, të cilën ai e mësoi menjëherë dhe u bë njeri i mirë e bëri jetë të shenjtëruar.

⁷ Tregti me sende të shenjta.

Dita e parë, rrëfenja e tretë

Çifuti Melkisedek me anën e përrallës së tri unazave, i shpëton kurthit të ngritur nga sulltan Saladini.

Kur Neifila mbaroi rrëfenjën, të cilën e pëlqyen të gjithë, sipas dëshirës së mbretëreshës, filloi Filomena:

Rrëfenja e Neifelës më sjell ndër mend një rrezik që iu kanos një çifuti. Si u fol gjer tani mbi Perëndinë e mbi të vërtetën e fesë së krishtere, s' duhet të na mohohet pas kësaj drejta, që të merremi edhe me çështje e ngjarje të tjera të njerëzve. Me përmbajtje të tillë, dua t'ju tregoj një rrëfenjë që, si ta keni dëgjuar, ndofta do t'ju ndihmojë të bëheni më të matura në përgjigjet mbi çështje që mund t'ju parashtrohen. Duhet të dini, shoqe të dashura, se sikurse mendjehhtësia e heq njeriun nga një gjendje lumturie dhe e përplas në mjerim të madh, ashtu dhe mendjehollësia e nxjerr të urtin nga rreziqe të mëdha dhe e vë në një gjendje krejt të qetë e të sigurt. Që është e vërtetë që mendjehhtësia e sjell njeriun nga gjendja e mirë në mjerim, shihet nga shumë ngjarje, të cilat tani nuk kam ndër mend t'i përmend, sepse të tilla shohim shquar çdo ditë. Por që mendjehollësia është burimi, qetësimi dhe ngushëllimi, do t'jua tregoj shkurtazi me këtë rrëfenjëzë.

Saladini me zotësinë e tij, jo vetëm që prej një njeriu të rëndomtë u bë sulltan i Babilonisë, por doli ngadhënjimtar dhe në shumë luftëra kundër mbretërve myslimanë e të krishterë. Mirëpo, si harxhoi gjithë thesarin e tij në luftëra të ndryshme e në salltanete të mëdha e të shkëlqyera, pati nevojë të ngutshme për një shumë të madhe të hollash për një gjë që i ndodhi dhe, duke mos ditur se ku t'i gjente, iu kujtua një çifut i pasur i quajtur Melkisedek, i cili jepte para me kamatë në Aleksandri dhe mendoi se ky, po të donte, mund ta ndihmonte në këtë punë, por e dinte se ishte koprrac dhe s'do t'ia bënte këtë të mirë me dëshirën e tij. Nga ana tjetër, s'donte as t'ia merrte me përdhunë, por nevoja për këto të holla ish shumë e ngutshme dhe koha s'priste. Si e mendoi se në ç'mënyrë mund t'ia merrte, vendosi të gjente dhe të përdorte kundër tij ndonjë pretext të arsyeshëm. Kështu, dërgoi e thirri, e priti si të shtëpisë, e uli pranë dhe i tha:

- Kam dëgjuar nga shumë njerëz, zot i mirë, se ti je njeri shumë i urtë dhe i ditur në punë që i përkasin Perëndisë, prandaj kam dëshirë të madhe të di prej teje se cila nga të tria fetë është e vërtetë: feja çifute, myslimane, apo e krishterë.

Çifuti, që ishte, me të vërtetë, njeri i urtë, e kuptoi fare mirë se Saladini donte ta zinte në fjalë, për t'i nxjerrë pastaj ndonjë kleçkë, prandaj mendoi të

mos shprehej për asnjë nga fetë që Saladini të mos mund t'ia arrinte qëllimit. Prandaj, që të gjente një përgjigje të përshtatshme për të mos rënë në grackë, vrau mendjen dhe gjeti këtë:

- Madhështi, çështja që më parashtroni është e bukur, dhe për t'ju shfaqur mendimin tim rreth saj, jam i shtrënguar t'ju kallëzoj një përrallëz, siç do ta dëgjoni.

- Në s'gabohem, më bie ndër mend se kam dëgjuar që ka qenë dikur një njeri i madh e i pasur, i cili, midis stolive të rralla e të çmuara të thesarit të tij, kishte dhe një unazë të bukur e të vyer. Për vlerën dhe bukurinë e saj, ai desh t'i bënte nder kësaj unaze dhe t'ua linte, për sa të ishte bota, si trashëgim pasardhësve të tij. Atij të cilit do t'i linte si trashëgim këtë unazë, do t'i linte edhe fronin. Trashëgimtari pastaj do të nderohej dhe do të dëgjohej nga të gjithë të tjerët si më i madhi.

- Edhe ai, të cilit ia la, po kështu veproi me pasardhësit e tij, duke bërë si kishte bërë i pari i tij. Kështu, unaza kaloi nga dora në dorë në shumë pasardhës, gjersa në fund ra në dorën e njërit që kish tre bij të bukur, të sjellshëm dhe të bindur ndaj t'et. Për këtë arsye, i ati i donte të tre njëlloj. Secili nga këta djem, që e dinte punën e unazës, duke dëshiruar që të ishte më i nderuari, i lutej t'et, tashmë të plakur, që t'ia linte atij unazën.

- Burri i mirë që, siç thamë, i donte që të tre njëlloj, nuk vendoste dot se kujt t'ia linte dhe, që t'i kënaqte të tre, ia premtoi secilit prej tyre. Pas kësaj, fshehurazi, bëri te një argjendar i zoti edhe dy unaza të tjera, që i përngjanin aq fort së parës, saqë dhe ai vetë që i kishte bërë, mezi i dallonte. Kur i afroi vdekja, i ati u dha fshehurazi nga një prej këtyre unazave secilit prej bijve.

- Pas vdekjes së t'et, secili nga këta kërkonte të drejtën e nderit dhe të trashëgimisë dhe, meqenëse ia mohonin njëri-tjetrit këtë të drejtë, secili, për të arsyetuar kërkesën, nxori në shesh unazën e tij. Por, meqenëse unazat ishin aq të njëllojta me njëra tjetrën sa s'mund të dalloheshin se cila ishte e vërteta, çështja mbeti pezull dhe pezull mbetet edhe sot e kësaj dite se cili duhet të ketë të drejtën e trashëgimisë së fronit.

- Këtë gjë madhëri, po jua them edhe për të tria fetë që Perëndia u ka dhënë të tre popujve, çështje që ma parashtruat që ta zgjidhja. Secili beson se është trashëgimtari i vërtetë, se feja e tij dhe ligjet e saj janë më të vërtetata, por cila është vërtet më e vërteta? Sikurse puna e unazave, edhe kjo çështje ka mbetur pezull.

Saladini e pa se ai kish ditur fare mirë t'i shpëtonte kurthit që i ngriti përpara këmbëve dhe prandaj vendosi t'i thoshte hapur nevojën dhe të shihte nëse do ta ndihmonte. Kështu bëri, duke i zbuluar njëkohësisht edhe se ç'kishte pasur ndër mend t'i bënte, po të mos i ish përgjigjur me aq maturi.

Çifuti i dha me dëshirë të gjitha ndihmat që i kërkoi Saladini dhe ky pastaj e kënaqi plotësisht në çdo gjë. Përveç kësaj, i fali dhurata shumë të mëdha, e bëri mik të ngushtë dhe e mbajti pranë duke i dhënë shkallë të lartë e të nderuar.

Dita e parë, rrëfenja e katërt

Një murg bie në mëkat, por shpëton nga ndëshkimi i rëndë, duke paditur abatin për të njëjtin mëkat.

Filomena e kishte mbaruar rrëfenjën e saj të shkurtër dhe pa Dioneun që rrinte pranë saj. Duke ditur se, sipas radhës që kishte filluar, i përkiste atij të fliste. Pa pritur urdhrin e mbretëreshës, Dioneu filloi të fliste si më poshtë:

Në qoftë se e kam kuptuar mirë, të dashura shoqe, qëllimin e të gjithave, besoj se këtu jemi mbledhur të kallëzojmë rrëfenja me qëllim që të zbavitemi dhe prandaj, gjersa të mos jemi kundër një gjëje të tillë, mendoj që secili duhet të jetë i lirë të kallëzojë çfarëdo tregimi që mendon se do të na kënaqë më shumë, madje kështu tha se duhet të bëjmë pak përpara edhe mbretëresha jonë. Prandaj, tani që dëgjova se si Abrahami shpëtoi shpirtin e tij me këshillat e mira që i tha Xhanotoja prej Çivinji dhe se si Melkisedeku mbrojti me zgjuarsí pasurinë e tij nga prita që i vuri Saladini, me bindjen se nuk do të më qortoni, mendoj t'ju kallëzoj shkurtazi se me sa mjeshtëri një murg shpëtoi trupin e tij nga një ndëshkim shumë i rëndë.

Në Lunixhanë, që është një vend jo shumë larg prej këtu, ka qenë një manastir në zë dikur për shenjtëri dhe numër të madh murgjish, në të cilin, midis të tjerëve, na ishte dhe një murg i ri, fuqinë dhe freskinë e të cilit s'kishin mundur ta mposhtnin as agjërimet, as ungjëllimet. Ky murg, një ditë, për fat, aty nga mesdita, kur po flinin të gjithë të tjerët, duke qenë krejt vetëm dhe duke ardhur pa ndonjë qëllim rrotull kishës së tij, që ngrihej në një vend krejt të vetmuar, qëlloi të na shohë një vajzë mjaft të bukur, ndofta bijën e ndonjë punëtori të atij rrethi, që po mblidhte nëpër ara disa barishte. Sapo e pa, u zotërua prej një epshi të furishëm që e verboi.

Iu afrua, pra, sakaq dhe hyri në fjalë me të. Duke u shtyrë thellë nga fjala në fjalë, arriti ta rregullonte me të dhe ta shpinte në qelinë e tij, pa e marrë vesh njeri. Por, i shtyrë nga një vullnet i tepruar, s'pati kujdes të harbohej me të pak më me qetësi dhe zhurmën që bëri me të, e dëgjoi abati përpara qelisë së tij. Ky, për të njohur mirë zërat, u afrua te dera e qelisë, mbajti vesh dhe kuptoi shfaqur se brenda ishte një grua. Mendoj të trokiste në derë që t'ia

hapnin, por pastaj ndërroi mendje për të vepruar në tjetër mënyrë. U kthye në dhomën e vet dhe priti sa të dilte murgu.

Ky, sado që ish nxënë me këtë vajzë në dëfrim e kënaqësi të madhe, prapë, megjithëkëtë, kishte frikë dhe, kur dëgjoji këmbë nëpër fjetore, vuri syrin në një vrimë, e pa mirë abatin tek po e përgjonte dhe e mori me mend menjëherë se abati e kishte kuptuar që ai kishte futur një vajzë në qeli. Duke ditur se për këtë shkak do të pësonte një dënim shumë të rëndë, u dëshpërua tej mase, megjithëkëtë, në sy të vajzës s'e bëri veten, por pa humbur kohë, mendoi me vete mënyrën për të gjetur ndonjë mjet shpëtimi. Kështu, i ra ndër mend një dhelpëri e çuditshme, të cilën sapo e gjeti, e vuri në zbatim. Duke bërë kinse kish qëndruar mjaft me vajzën, i tha asaj:

- Unë do të vete të gjej ndonjë mënyrë se si të dalësh prej këndeje pa të parë njeri, prandaj rri këtu dhe mos u ndiej pa ardhur unë.

Doli, pra, murgu nga qelia, mbylli derën me çelës dhe shkoi drejt e ia dorëzoi çelësin abatin në dhomën e tij, sikundër bëjnë të gjithë murgjit kur dalin jashtë dhe, si pa gjë të keqe, i tha:

- Zotëri, unë nuk munda sot në mëngjes të gjeja mjet për të sjellë të gjitha drutë që kisha porositur për të prerë, prandaj me lejen tuaj dëshiroj të vete në pyll për të gjetur njeri që t'i sjell.

Abati, që të mund të mblidhte prova më të plota për fajësinë e tij, duke pandehur se ai s'dinte gjë që ky e kishte përgjuar dhe e kishte parë, u kënaq që deshi të dilte. Mori me gjithë dëshirë çelësin dhe i dha murgut leje që të dilte. Pastaj, si pa që murgu u largua, filloi të mendonte sesi të bënte: ta hapte, vallë, qelinë e tij në sy të gjithë murgjve, duke u treguar atyre fajin e tij, për të mos gjetur shkak të pëshpëritnin kundër tij kur ta ndëshkonte, apo të pyeste më mirë vajzën sesi kishte ndodhur puna. Dhe, duke menduar me vete se kjo mund të ishte ndonjë grua nga derë e mirë a e bija e ndonjë njeriu të ndershëm, së cilës s'dëshironte t'i bënte një turp të tillë, duke ua treguar të gjithë murgjve, mendoi t'i vente më parë vetë, për ta parë se cila ishte dhe pastaj të mendonte se ç'të bënte. Dhe shkoi qetë-qetë te qelia, e hapi, hyri dhe e mbylli derën nga brenda.

Vajza, kur pa abatin që hyri, krejt e tronditur dhe e turpëruar, filloi të qante. Zotëri abati, si ia nguli sytë dhe e pa që ishte e bukur dhe e kolme, sado që ishte plak, ndjeu menjëherë në trup gudulisje edhe më të forta nga ç'kishte ndier murgu i ri. Dhe, kështu, mendoi me veten e tij:

“Përse nuk përfitoj dhe unë nga rasti e të bëj qejf me të? Se, sa për brenga e mërzi, kam çdo ditë. Kjo është vajzë e bukur, njeri s'e di që gjendet këtu, po të arrij t'i mbush mendjen e të dëfrehem pak me të, pse të mos e bëj? Kush do ta marrë vesh? Kurrë s'ka për ta marrë vesh njeri. Një mëkat i

mbuluar është gjysmë i harruar. Ky rast mbase s' do të më vijë kurrë më. Unë mendoj se njeriu i urtë përfiton nga e mira që i zë derën". Dhe, duke menduar kështu, u largua krejt nga qëllimi për të cilin kishte vajtur, iu afrua më tepër vajzës dhe, me ngadalë, zuri ta merrte me të mirë, t'i lutej që të mos qante dhe, duke kaluar nga njëra fjalë te tjetra, arriti t'i shfaqte dëshirën e tij.

Vajza që s' ishte prej hekuri e as prej diamanti, iu nënshtrua me lehtësi dëshirës së abatit. Ky e pushtoi, e puthi shumë herë, pastaj hipi mbi shtratin e vogël të murgut dhe, duke marrë parasysht peshën e rëndë të dinjitetit të vet dhe moshën e re të vajzës, ndofta, duke pasur frikë se mos e shtypte me trupin e tij të rëndë, nuk hipi mbi trupin e saj, por vuri atë mbi trupin e tij dhe për një copë herë u dëfrye me të.

Murgu, që bëri sikur vajti në pyll, ishte fshehur në fjetore dhe, kur pa abatin që hyri vetëm në qelinë e tij, mendoi se plani i tij dhelparak kishte për të pasur me siguri të plotë përfundimin e dëshiruar dhe, kur pa pastaj që mbylli derën nga brenda, u sigurua me qind për qind. Prandaj doli andej nga qe fshehur dhe që aty vajti vuri syrin te një vrimë prej së cilës dëgjoji dhe pa çdo gjë që thoshte dhe bënte abati.

Abati, si qëndroi mjaft me vajzën, e mbylli atë në qeli, doli dhe u kthye në dhomën e vet. Aty, pas pak, kur dëgjoji murgun që u kthye, mendoi ta qortonte ashpër dhe ta burgoste, por, duke dashur që ta kishte vetëm për vetëm vajzën e fituar, dërgoi e thirri murgun dhe, me fytyrë të vrerët, e qortoi shumë rëndë dhe dha urdhër që të burgosej.

- Zotëri, - iu përgjigj murgu çast më çast, - unë s'kam shumë kohë që ndodhem këtu nën urdhrin e Shën Benediktit, sa ta njoh aq mirë në të gjitha hollësitë dhe ju s' më kishit treguar se murgjit duhet të mposhten nga femrat ashtu si mposhten nga agjërimet e ungjëllimet, po tani që ma mësuat ju këtë gjë, në qoftë se ma falni për këtë radhë, ju jap fjalën se kurrë nuk do të bëj më mëkat në këtë pikë, përkundrazi do të bëj ashtu sikundër ju pashë ju të bënit.

Abati, që ishte njeri i zgjuar, e kuptoi menjëherë që ai, jo vetëm qe më i zgjuar, por edhe kishte parë edhe se ç'kishte bërë ky, prandaj me ndërjegje të plagosur nga faji që kishte bërë vetë, pati turp t'i jepte murgut ndëshkimin që meritonte për vete dhe, kështu, ia fali, por e porositi të mos ia zinte ngoje njeriu tjetër mbi sa kishte parë, njëkohësisht qetazi nxori edhe vajzën përjashta. Duhet besuar se prej asaj dite e tutje, të dy e futën brenda vajzën dhe shumë herë të tjera.

Dita e parë, rrëfenja e pestë

Markezja e Monferratos me një gosti prej pulash dhe me disa fjalë plot hijeshi, shfuqizon dashurinë e çmendur të mbretit të Francës.

Rrëfenja që kallëzoi Dioneu, në të parë, i bëri vashat e ndershme të turpëroheshin pak. Atyre iu skuq përnjëherësh fytyra. Pastaj, sado që mezi e mbanin të qeshurin, e dëgjuan duke vështruar njëra-tjetrën në sy dhe duke qeshur dinakërisht nën buzë. Në mbarim të rrëfenjës, duke dashur t'i bënin të kuptonte Dioneut se të këtilla gjëra s'është e lejuar t'u tregohen vashave, e thumbuan tërthorazi me disa fjalë të këndshme. Ndërkohë, mbretëresha u drejtua nga Fjameta, që ishte shtruar mbi bar pranë Dioneut, dhe i dha urdhër të vijonte radhën. Kjo filloi me hijeshi e me fytyrë të qeshur:

Aq më pëlqen që i kemi hyrë kësaj pune që tregojmë me anë rrëfenjash se sa të fuqishme janë përgjigjet e bukura e të shpejta, si dhe sa i madh është kujdesi që tregojnë burrat për të dashuruar gra të një shkalle më të ulët se e tyrja, ndërsa gratë bëjnë çmos për të rënë në dashuri me burra të një shkalle më të lartë se e tyrja, saqë më ka rënë ndër mend, shoqe të bukura, t'ju kallëzoj se qysh, me ç'vepra e me ç'fjalë një grua fisnike e ruajti veten nga një dashuri e tillë dhe e largoi atë që e dashuronte.

Markezi i Monferratos, një burrë trim me fletë dhe gonfalonier¹ i kishës, kishte kaluar përtej detit me kryqëzatën që kishin ndërmarrë në atë kohë popujt e krishterë. Duke rënë një ditë fjala mbi trimërinë e tij në Oborrin e mbretit të Francës, Filip Bornit, i cili po ashtu përgatitej ta linte vendin e vet për të marrë pjesë në këtë kryqëzatë, një kalorës tha se s'kishte në botë një çift më të përsosur se markezi me të shoqen, sepse aq sa ishte markezi i përmendur si trim midis kalorësve, aq ishte dhe e shoqja e tij më e bukura dhe më e zgjuara midis grave të botës. Këto fjalë e prekën kaq fort në zemër mbretin e Francës, saqë, ndonëse s'e kishte parë kurrë, menjëherë filloi të ndizej për të dhe vendosi që, në udhëtimin që do të bënte për në kryqëzatë, anijen të mos e merrte gjetkë, veç në limanin e Gjenovës, me qëllim që, duke udhëtuar nëpër tokë në këtë vend, të gjente një shkak që të vente të shikonte markezën, me shpresë që të kënaqte dëshirën e tij në mungesë të markezit.

Dhe vendimin që mori e vuri shpejt në jetë. Nisi më parë të gjithë burrat, pastaj u vu dhe vetë në udhëtim me një grup të vogël bujarësh. Kur u afrua te tokat e markezit, i dërgoi fjalë markezës një ditë më parë, që ta priste të nesërmen në drekë. Gruaja e urtë dhe e mençur u përgjigj se do ta priste me

⁸ Mbrojtës i papës në grindjet midis papatit dhe perandorisë.

kënaqësi dhe se kjo vizitë ishte për të një nder shumë i madh, prandaj, tha: “Mirë se të vijë”. Pastaj hyri në mendim që një pikë mbret të vinte t’i bënte asaj vizitë në një kohë kur i shoqi i saj mungonte. Ajo nuk u gabua aspak, sepse mbretin vërtet e tërhiqte fama dhe bukuria e saj.

Megjithëkëtë, si grua e dhënë që ishte, mendoi ta nderonte. Më parë, dërgoi e thirri ata pak burra të mirë që kishin mbetur dhe, duke u këshilluar me ta, dha urdhrat e duhura për çdo punë të rastit, se për gostinë dhe gjellët, s’deshti të pyeste tjetër njeri. Pastaj, pa humbur kohë, dërgoi dhe mblodhi të gjitha pulat e asaj zone dhe u dha urdhër gjellëbërësve që me to të gatitnin gjellët e ndryshme për gostinë e mbretit.

Mbreti arriti të nesërmen dhe u prit me nderim e me gëzim të madh prej markezës. Atij, kur e pa, iu duk edhe më e bukur, edhe më e gjallë, edhe më e sjellshme nga ç’kishte kuptuar nga fjalët e kalorësit. Mbreti pa mend nga bukuria e saj, e mburri së tepërmi dhe sa më shumë e shihte, aq më e bukur i dukej nga ç’e kishte përfytyruar dhe aq më tepër ndizej për të. Si u çlodh pak në dhomat e stolisura, sikundër duhej për pritjen e një goxha mbreti, në kohën e drekës, markeza dhe ky u ulën në një tryezë, ndërsa të tjerët, sipas shkallës së tyre, u nderuan në tryeza të tjera.

Mbreti ndiente kënaqësi të madhe nga gjellët e shumta që i shtroheshin përpara njëra pas tjetrës, nga verërat e mira dhe fort të rralla dhe, sidomos, nga vështrimi i ëmbël që i hidhte ngandonjëherë markezës. Duke vijuar drekën me gjellë të njëpasnjëshme, mbreti filloi të çuditej disi, se po shihte se ato, sado që ndryshonin nga njëra-tjetra, të gjitha, pa përjashtim, ishin gatuar me mish pule dhe, meqenëse e njihte mirë vendin dhe e dinte se ai ishte i pasur në gjah gjithfarësh, çuditej se pse markeza, që e kishte marrë vesh një ditë më parë vajtjen e tij, nuk kishte marrë masa të dërgonte njeri për të gjuajtur. Megjithëkëtë, ndonëse një gjë e tillë e çudiste shumë, nuk desh të hapte biseda me markezën për këtë gjë. Ai desh të kufizohej vetëm te pulat e prandaj iu drejtua asaj me fytyrë të qeshur dhe i tha:

- Mos lindin vallë, zonjë, në këtë vend, vetëm pula pa këndesa?

Markeza, që e kuptoi se ku donte të godiste mbreti me këto fjalë, kur pa se Fuqimadhi Zot i kishte paraqitur rastin e volitshëm për të shfaqur mendimin e saj, duke iu drejtuar me gjallëri mbretit, që i bëri pyetjen, iu përgjigj:

- Jo madhështi, por femrat, sado që ndryshojnë pak nga petkat dhe nga shkalla njëra nga tjetra, të gjitha prej një brumi janë: si këtu, si gjetkë.

Mbreti, kur dëgjoji këto fjalë, e kuptoi mirë shkakun e gostisë me pula dhe domethënien e fjalëve të saj dhe pa se më kot do të harxhonte fjalë me një

këso gruaje. Sa për përdhunim nuk ish vendi, prandaj mendoj se, sikundër ishte ndezur për të pa e menduar mirë punën, ashtu, me urtësi, për hir të nderit të tij, duhej ta shuante zjarrin e pavend që e kishte zotëruar dhe, pa e ngacmuar më me fjalë, nga frika e përgjigjeve thumbuese të saj, u drekua duke hequr çdo shpresë. Kur mbaroi dreka, për të mbuluar vizitën e tij të pahijshme, e falënderoi për nderimin që i bëri, u nda me nxitim me të dhe u nis për në Gjenovë. Markeza i uroi udhë të mbarë.

Dita e parë, rrëfenja e gjashtë

Një burrë i mirë godet me një fjalë prekëse hipokrizinë e ligë të klerikëve.

Si u mburr prej të gjithëve zotësia e markezës dhe të vrarët me pambuk që i bëri mbretit të Francës, sipas dëshirës së mbretëreshës, Emilia, që ishte ulur pranë Fjamesës, filloi të thotë me gjallëri: edhe unë do t'ju flas se si një burrë i mirë laik thumboi një klerik cingun me ca fjalë sa për të qeshur, aq edhe për t'u lëvduar:

S'ka shumë kohë, pra, shoqe të dashura, që në qytetin tonë na paskësh qenë një frat nga inkuizitorët e vegjël të ligësisë heretike i cili, sado që përpiquej të tregojë i shenjtë e dashamirës i ëmbël i fesë së krishterë, sikundër bëjnë gjithë shokët e tij, prapë gjurmonte më tepër ata që e kishin kuletën plot, sesa ata që ishin të krishterë të mangët. Me anë të këtij kujdesi që tregonte, dëgjoi për një burrë të ndershëm, të pasur, më shumë me të holla sesa me mend, i cili, jo pse s'besonte në fe, por, kot, duke folur një ditë, pse ndofta ishte nxehur se kishte pirë, apo nga gëzimi i madh, u paskësh thënë ca shokëve të tij, se kishte një verë aq të mirë, saqë mund ta pinte dhe vetë Krishti.

Pasi këto fjalë ranë në vesh të inkuizitorit, i cili, duke ditur se pronat e atij burri ishin të mëdha dhe kuleta e ngrohtë valë *cum glaudiis et fustibus*⁹, nxitoi me vrull të madh t'i ngrejë një padi shumë të rëndë, duke pasur si qëllim jo forcimin e besimit të të paditurit në fe, por mbushjen e duarve të tij me florinj. Si dërgoi dhe e thirri, e pyeti nëse ish e vërtetë ajo për të cilën paditej.

Burri i mirë ia pohoi dhe ia tregoi se si i kishte qëlluar. Inkuizitori fort i shenjtëruar dhe shumë i devotshëm ndaj Shën Xhovani Barbadorit¹⁰, i tha:

⁹ Me shpatë e me shkopinj, domethënë me prapamendim.

- E paske bërë Krishtin pijanik dhe prej atyre të cilëve u pëlqejnë verërat e mira si të ish Çinçilioni a ndonjë tjetër nga lloji juaj i pijanikëve, dejmarakëve e mejhanexhinjve. Dhe tani, duke folur me përlësi, kërkuaqe të tregosh se një gjë e tillë qenka pa të keq. Po s'është aq e thjeshtë sa mendon ti. Ti meriton të digjesh i gjallë, po të duam të veprojmë sipas ligjit.

Këto dhe shumë fjalë të tjera i tha me zemërim, si të qe Epikuri që mohonte amshueshmërinë e shpirtrave. Dhe, në një copë herë, kaq shumë i dha datën, saqë burri i mirë, me anë të disa ndërmjetësve ia leu mirë duart me dhjamë nga të Shën Xhovani Barbadorit për t'u sjellë i mëshirshëm ndaj tij. Ky dhjamë bën efekt të mirë në sëmundjen e murtajës makutëri e, sidomos te fretërit e vegjël që nuk guxojnë të prekin para me dorë.

Kjo lyerje me dhjamë, si një bar i fortë shëndetdhënës, sado që Galeni s'e përmend në asnjë pjesë të shkrimeve të tij mbi barnat, veproi kaq mirë te frati, saqë zjarri me të cilin ai u kërcënua, mrekullisht u shndërrua në kryq mbi rrobat e tij. Ishte sikur frati t'i kishte dhënë një flamur për ta marrë në kryqëzatë dhe, për ta bërë më të bukur, duhej të ishte i verdhë mbi një sfond të zi.

Veç kësaj, si i mori të hollat, frati e mbajti nën vëzhgim për disa ditë, duke e detyruar që për pendesë, të dëgjonte çdo mëngjes një meshë në "Santa Croce" dhe në kohën e drekës të paraqitej tek ai, ndërsa në pjesën tjetër të ishte i lirë.

Duke zbatuar këto urdhra më përpikëri të madhe, qëlloi një mëngjes që burri i mirë na dëgjoi në meshë një pjesë të ungjillit që këndohej me këto fjalë: "Për atë që jepni, do të merrni njëqind për një dhe do të keni jetë të amshuar". Këto fjalë i nguli mirë në tru dhe, sipas urdhrut, në drekë u paraqit te inkuizitori që e gjeti tek po hante. Inkuizitori e pyeti nëse e kish dëgjuar meshën atë mëngjes. Ai iu përgjigj shpejt:

- Po, uratë.

- A dëgjove ndonjë gjë, që s'e ke kuptuar mirë, ose mos ke dyshuar mbi ndonjë pikë?

- Sigurisht - iu përgjigj burri i mirë, - s'dyshoj në asnjë nga ato që dëgjova, përkundrazi të gjitha i besova me bindje të vërtetë. Por kam dëgjuar diçka që më ka bërë t'ju qaj hallin juve e fretërve të tjerë, duke menduar mbi gjendjen e keqe që ju është ruajtur përtej, në botën tjetër.

- Në ç'fjalë ka qenë ajo, - pyeti inkuizitori, - që të ka shtyrë të na qash hallin?

¹⁰ Domethënë lakmues parash.

- Ajo, uratë, është fjala e Ungjillit që thotë: “Ju do të merrni për një, njëqind”.

- Kjo është e vërtetë, - i tha inkuizitori, - po përse të ka bërë kjo fjalë të të dhimbsemi?

- Do jua them, uratë, - iu përgjigj burri i mirë, - se nga koha që kam filluar të vij këtu, kam parë çdo ditë t’u jepni aty jashtë gjithë të vobektëve herë nga një, herë nga dy kazanë shumë të mëdhenj me lëng, që u hiqet si tepricë fretërve të këtij kuvendi dhe juve, prandaj, në qoftë se për një, do t’ju japin njëqind në botën tjetër, do ju bëhet aq shumë, sa keni për t’u mbytur të gjithë brenda në të.

Sado që të tjerët, që ishin në tryezën e inkuizitorit qeshën të gjithë, inkuizitori, duke ndier të goditur hipokrizinë e tyre me lëngurinat që u jepnin të varfërve, u shqetësua shumë dhe, po të mos ndiente mallkim për atë që kishte bërë, do të kishte ngritur një tjetër padi kundër tij, për arsye se me mënyrë tallëse, burri i mirë kishte thumbuar atë dhe përtacët e tjerë, shokë të tij. I mbushur me zemërim, dha urdhër të shihte punën e tij dhe të mos qasej më aty.

Dita e parë, rrëfenja e shtatë

Me një kallëzim mbi Primasin dhe abatin e Klinjës, Bergamini thumbon siç duhet koprracinë e lindur papandehur në shpirtin e zotit Kan della Skala.

Tregimi i Emilisë dhe mënyra plot shije e rrëfimit të saj, bëri mbretëreshën dhe gjithë të tjerët të qeshnin dhe të lëvdonin mençurinë e “kryqtarit”. Pasi u shuan të qeshurat dhe të gjithë heshtën, radha i përkiste Filostratit, i cili filloi të thoshte:

Gjë e bukur është, filloi ai, vasha të vyera, kur harkëtari qëllon një shenjë që qëndron e palëvizshme, por është thuajse e mrekullueshme kur ai qëllon përnjëherë një gjë që shfaqet papandehur dhe e godet. Jeta që bëjnë klerikët, plot vese dhe fëlliqësira, që në shumë pika është pothuaj shenjë e gjallë e shëmtimit, i jep rast pa vështirësi çdo njeriu t’i marrë nëpër gojë, t’i tallë e t’i qortojë. Ndërsa e mbështes njeriun e mirë që i dha një shuplakë të shëndoshë inkuizitorit mbi dorëhapësinë hipokrite të fretërve që u japin të varfërve sende, të cilat janë për derra e për t’u hedhur poshtë, prapë, e quaj më të

denjë për lavdërim njeriun për të cilin, i tërhequr nga rrëfenja e mëparshme, do të flasë tani. Ky zotëri, me anë të një rrëfenje të këndshme, tregoi përmes personazheve të tij, atë që donte të thoshte për vete dhe për bujarin e shquar Kan dela Skala, që u pushtua papritur prej një koprracie të pazakontë. Ja tani rrëfenja:

Sikundër që jehon zulma në të katërta anët e botës, zoti Kan dela Skala, të cilin e hoqi fati në shumë gjëra, ka qenë një nga më të shquarit dhe nga më të shkëlqyerit zotërinj që ka parë Italia që nga koha e Frederikut II e tëhu.

Ai kishte caktuar të bënte një festë të shkëlqyer e madhështore në Veronë dhe për të marrë pjesë në të, kishin ardhur njerëz të shumtë nga të gjitha anët dhe, sidomos, oborrtarë të çdo lloji, mirëpo s' dihet për ç' arsye, papritur e pa kujtuar, hoqi dorë prej saj dhe, si u fali gjë a gjë të ftuarve, i nisi të ardhurit prapë për në vendet e tyre. Vetëm njërit ndër ta, që quhej Bergamin e që ishte kuvendar i gatshëm dhe i këndshëm jashtë çdo hamendjeje të atij që s'e kishte dëgjuar ndonjëherë, nuk i fali gjë dhe nuk e nisi si të tjerët. Ky nuk u tund, duke shpresuar se më së fundi s'kishte për të mbetur krejt duarthatë. Por zoti Kan kishte vendosur që më mirë të hidhte në zjarr një gjë sesa ta bënte dëm duke ia dhënë atij, por këtë nuk ia thoshte as vetë, as me anë të tjetërkujt.

Bergamini, pas disa ditësh, duke parë se as e thërriste as e pyeste për ndonjë gjë që i përkiste e, veç kësaj, duke parë se po harxhohej në han me kuaj e me shërbëtorë, zuri të mërzhitej. Megjithëkëtë, po priste se s'i dukej punë e mirë që të ikte. Për të paguar hanxhiun që i kërkonte të hollat, së pari i dha një palë nga tri petkat e bukura dhe të çmuara që ia kishin falur zotërinj të tjerë dhe që i kishte marrë me vete për t'u dukur një çikë më shumë në festë, pastaj, duke vijuar të qëndronte, iu desh, për të bujtur dhe më, të jepte dhe petkat e dyta dhe filloi të hante me petkat e treta, i vendosur të qëndronte gjersa të shikonte sesi do të përfundonte puna dhe pastaj të shkonte.

Tani, kur po hante me petkat e treta, qëllloi të ndodhej shumë i mërzhitur në prani të zotit Kan dela Skala, që ishte duke ngrënë drekën. Zoti Kan, më tepër për ta vënë në lojë, sesa për t'u zbavitur me ndonjë nga fjalët e tij gjithë kripë, i tha:

- E, Bergamin, ç'ke? Më dukesh shumë i mërzhitur, pa më kallëzo gjëkafshë.

Bergamini, atëherë, pa menduar fare, sikurse ta kish menduar gjatë, çast më çast, në përputhje me gjendjen e tij, i kallëzoi këtë ngjarje:

Duhet ta dini ju, imzot, se Primasi ka qenë një njeri shumë i zoti në gjuhë dhe vjershëtor improvizues i përmendur, dhunti këto, që e bënë të dëgjuar e

të famshëm, saqë s'kishte vend ku të mos njihej, në mos për së pari, së paku, për emrin dhe zulmën e tij.

Tani qëllloi që, duke u ndodhur njëherë në Paris në gjendje ekonomike të keqe, sikundër e kalonte më të shumtën e kohës, për shkak të virtytit të tij, që s'para u pëlqente atyre që ishin të pushtetshëm, dëgjoi të bëhej fjalë mbi abatin e Klinjës, i cili besohej se për të ardhurat e tij ishte, pas papës, prelati më i pasur i krishterimit dhe rreth tij dëgjoi gjëra të mrekullueshme e të shkëlqyera për derën e tij të hapur si dhe për gostitë e pashqitura. Ai s'i mohonte kurrë njeriut që i shkonte në shtëpi, as të ngrënët, as të pirët, veç t'ia kërkonte në kohë kur hante vetë. Kur dëgjoi këto gjëra Primasi, si njeri që kënaqej të shihte burra të mirë dhe bujarë, vendosi të vente të shihte shkëlqimin e këtij abati dhe, si pyeti, mësoi se ai banonte në një pronë të tij nja gjashtë milje larg Parisit. Primasi mendoi se, po të nisej në mëngjes herët, në kohën e drekës do të arrinte në vend.

Si pyeti se nga duhej të shkonte dhe si s'gjeti njeri me të cilin të bënte udhëtimin, nga frika se mos humbiste rrugën dhe arrinte te ndonjë vend ku s'do gjente të hante, për të mos vuajtur nga uria, mendoi të merrte me vete tri bukë se, sa për ujë, do të gjente diku. I futi bukët në gji dhe nisi udhëtimin që i shkoi mbarë dhe përpara se të shtrohej dreka, arriti tek abati.

Kur hyri brenda dhe pa gjithë ato tryeza të shtruara, gjithë ato të mira në kuzhinë dhe të tjera gjëra të përgatitura për drekë, tha me vete: “Me të vërtetë qenka i shkëlqyer siç thonë”. Kur ishte duke vërejtur me kujdes këto sende në dhomën e të ngrënit, qehajai i abatit dha urdhër që të gjithë të shpëlanin duart dhe pastaj i uli në tryezë. Për fat, Primasin qëllloi ta ulnin pikërisht përkundrajt derës së odës nga e cila do të vinte abati për në sallë ku do të hante drekën.

Në atë oborr paskësh qenë zakon të mos viheshin kurrë mbi tryezë as verë as bukë e as gjë tjetër për të ngrënë e për të pirë, përpara se të vinte e të shtrohej abati. Si i shtroi tryezat, qehajai i dërgoi fjalë abatit se, kur t'i pëlqente, buka qe gati.

Abati hapi derën për të hyrë në sallë dhe, duke ardhur, vështroi drejt përpara. Për fat, njeriu i parë që i ra në sy qe Primasi, i veshur me lecka, të cilin nuk e njihte për së pari por, sapo e pa, i shkoi ndër mend një mendim i keq që s'i kishte qëlluar kurrë më parë dhe tha: “Shih se kujt ia jap të hajë mallin tim”. Përnjëherë, pastaj, u kthye prapë dhe dha urdhër të mbyllej dera

e dhomës e të pyeteshin ata që i rrinin afër se cili që ai brashnjar, që rrinte në tryezë kundruall derës së odës së tij. Të gjithë iu përgjigjën se nuk e njihnin.

Primasi, që kishte uri, se kish udhëtuar dhe s'qe mësuar të rrinte pa ngrënë, si priti ca dhe pa se abati s'po vinte, nxori nga gjiri njëren nga të tria bukët që kishte sjellë me vete dhe filloi të hante. Abati, si qëndroi ca, i dha urdhër njërit prej shërbëtorëve, të shikonte nëse Primasi kishte ikur.

Në fund, meqë abati s'po vinte, Primasi që kish mbaruar dhe bukën e dytë, filloi të hante të tretën. Edhe për këtë u lajmërua abati i cili mendoi dhe tha vetëm: “Eh, po ç'kam pësuar sot unë, pse të më jetë ngushtuar kaq shumë zemra, pse gjithë ky zemërim, dhe për kë pa? Unë u kam dhënë të hanë nga gjiri im prej shumë kohësh të gjithë atyre që kanë dashur, pa shikuar se ishin të mirë a berbeculë, të vobektë a të pasur, tregtarë a matrapazë. Kam parë me sytë e mi të hanë nga gjiri im kushedi sa të ligj dhe kurrë s'më ka shkuar nëpër mend një mendim i keq, si më ndodhi sot me këtë njeri. Dikush i rëndësishëm do të jetë ky që më duket i lig, duke mos më dashur zemra që ta nderoj”.

Si tha këto, deshi të dinte se kush ishte dhe kur dëgjoji që ishte Primasi, që kishte ardhur për të shikuar me sy ato që kish dëgjuar mbi shkëlqimin e tij, meqenëse ia kishte dëgjuar famën që prej shumë kohësh që ish njeri i zoti, mbeti i turpëruar dhe për të mbuluar fajin, u përpoq ta nderonte në shumë mënyra. Pas dreke, ashtu sikundër i kish hije një njeriu si Primasi, e veshi me petka të mira dhe pasi i fali shumë të holla dhe një kalë, ia la në dëshirën e tij që të rrinte a të shkonte. Primasi i kënaqur, dukë falënderuar me gjithë shpirt, u kthye kaluar në Paris prej nga ishte nisur më këmbë.

Zoti Kan, që ishte njeri i kuptueshëm, pa të tjera kthjellime, i mori me mend fare mirë se ku donte të qëllonte Bergamini dhe i tha, duke vënë buzën në gaz:

- Bergamin, shumë bukur e tregove dëmin që pësove, virtytin tënd dhe koprracinë time. Çfarë dëshiron prej meje? Me të vërtetë, përveç kësaj radhe, kurrë s'më është ngushtuar zemra, kurrë s'më ka kapur koprracia, por unë këtë do ta përzë me atë shkop që më dhe ti.

Dhe si dërgoi e pagoi hanxhiun e Bergaminit, e veshi atë si zotëri me një palë petka të vetat, i fali të holla, i fali një kalë dhe e la në dorë të tij për këtë radhë që të shkonte a të rrinte.

Dita e parë, rrëfenja e tetë

Guljelm Borsjeri me një fjalë të goditur thumbon koprracinë e zotit Ermin të Grimaldëve.

Pranë Filostratit rrinte Laureta e cila, si dëgjoi që u mburr shkathtësia e Bergaminut dhe si pa se i përkiste asaj radha për të kallëzuar, pa pritur urdhër, filloi këndshëm të fliste:

Rrëfenja e mëparshme, të dashura shoqe, më shtyn t'ju tregoj se si, në të njëjtën mënyrë dhe jo pa përfitim, një oborrtar i zoti goditi lakminë e një tregtari shumë të pasur. Rrëfenja që do t'ju kallëzoj, sado që përfundon si e mëparshmeja, prapë besoj se do t'ju pëlqejë jo më pak se ajo, duke menduar se në mbarim prej saj do të dalë një e mirë.

Ka qenë pranë Gjenovës, shumë kohë përpara, një bujar i quajtur Ermin i Grimaldëve, i cili, sipas mendimit të të gjithëve, me pronat e tij shumë të mëdha dhe me të hollat që kishte, ia kalonte tej së tejmi nga pasuria çdo qytetari tjetër të pasur që njihej aso kohe në Itali dhe, po ashtu, ia kalonte jashtë çdo mase për koprraci e makutëri çdo tjetër koprraci e makuti që njihej në botë. Ky njeri e mbante shtrënguar kuletën jo vetëm kur duhej të nderonte tjetrin, por në vetë sendet më të nevojshme që i duheshin për veten e tij, në kundërshtim me prirjen në përgjithësi të gjenovezëve që vishen mirë e me sqimë. Për të mos harxhuar, kursente edhe me të ngrënët e me të pirët. Për këtë shkak dhe me arsye të gjithë ia kishin humbur mbiemrin e Grimaldëve dhe e thërrisnin Ermin Koprraci.

Në ato kohë, kur ky po kursente kështu, duke shtuar pasurinë e vet, qëlloi të vinte në Gjenovë një burrë i urtë oborri, i sjellshëm e kuvendar i rrallë, i quajtur Guljelm Borsjeri. Ky zotëri nuk u përngjante oborrtarëve të sotëm, të cilët, për turp e faqe të zezë, ndonëse duan të thirren dhe të mbahen për bujarë dhe zotërinj, të rritur më shumë në fëlliqësitë e njerëzve më të poshtër e të ligj, sesa nëpër oborre, për sjelljet e shëmtuara e të neveritshme, duhen quajtur më mirë gomarë. Në kohë të para oborrtarët përpiqeshin si e si, duke harxhuar gjithë energjinë e tyre, të vendosnin paqen në rast se lindnin luftëra e armiqësi midis bujarësh, të bënin krushqi e miqësi dhe të sillnin vëllazërimin e, me shaka të bukura e të këndshme, orvateshin të zbavitnin shpirtrat e të lodhurve dhe të dëfrenin oborret. Me qortime, si prindër të mirë, goditnin të metat e të ligjve dhe të gjitha këto i bënin me shpërblime fare të vogla, ndërsa këta të sotmit e harxhojnë kohën për të shpurë e për

të prurë fjalë të liga nga njëri te tjetri, për të shkaktuar grindje, për të thënë gjëra të shëmtuara e të dobëta. Dhe, më e keqja është se të gjitha këto i bëjnë në sy të njerëzisë. Por, s'mjafton me kaq, këta ia përflasin të ligat dhe turpet, poshtërsitë e vërteta dhe jo të vërteta, njëri-tjetrit dhe me lajka tërheqin burrat fisnikë në punë të dobëta e të këqija. Sa më shumë një prej tyre thotë fjalë e bën vepra të neveritshme, aq më tepër nderohet dhe shpërblehet me dhurata të çmuara nga bujarë faqezinj e të paturpshëm: turp i madh dhe poshtëruës i ditëve tona dhe shenjë e gjallë e largimit të virtyteve së këtejmi dhe i braktisjes së të mjerëve njerëz në ndyrësinë e veseve.

Por, që të kthehem nga kisha filluar, se një zemërim i drejtë më shmangu aq sa s'munda ta pandehja, them se i përmenduri Guljelm nderohej nga të gjithë burrat fisnikë të Gjenovës, të cilët e pritën me kënaqësi. Zotëria e tij, si ndenji ca ditë në qytet dhe dëgjoi shumë çudira mbi makutërinë dhe koprracinë e zotit Ermin, deshi ta shihte vetë.

Z. Ermin kishte dëgjuar se ky farë Guljelm Borsjeri ishte një burrë i urtë dhe, duke qenë se s'i qe shuar fare çdo shkëndijë mikpritjeje, sado koprrac që ishte, e priti miqësisht e me gëzim dhe hyri me të në gjithfarë bisedash. Së bashku me disa gjenovezë të tjerë, e mori atë dhe e shpuri te një shtëpi e tij e re dhe e bukur dhe, si i dëftoi çdo pjesë të saj, i tha:

- E, zoti Guljelm, ju që keni parë e dëgjuar shumë gjëra, dini të më tregoni ndonjë gjë që s'është parë kurrë që ta pikturoj në sallën e kësaj shtëpie?

- Gjë që të mos jetë parë kurrë, zotëri, unë nuk mund t'ju tregoj, veç në qoftë kjo ndonjë teshtimë a gjësendi tjetër si kjo, por, po të doni, do t'ju tregoj një gjë tjetër që besoj se ju nuk e keni parë kurrë.

Zoti Ermin, duke mos pritur përgjigjen që i dha, vazhdoi:

- Pa hë, ma thuaj çfarë është.

Atëherë, Guljelmi me të shpejtë i tha:

- Pikturoni oborrësinë, zotëri.

Me të dëgjuar këtë fjalë, Ermini u prek shumë dhe u pushtua prej një turpi që e bëri të ndërronte krejt në të kundërt natyrën që kish pasur deri në atë orë dhe tha:

- Zoti Guljelm, unë do ta pikturoj në mënyrë që kurrë as ju e as tjetërkush s'do të mund të më thotë se unë s'e paskam parë dhe s'e paskam njohur.

Kaq fuqi të madhe pati fjala e Guljelmit mbi këtë njeri, saqë që nga ajo ditë ai u bë bujari më dorëhapët e më tërheqës dhe nderoi të huajt dhe qytetarët më tepër se çdo gjenovez tjetër i kohës së tij.

Dita e parë, rrëfenja e nëntë

Mbreti i Qipros, i prekur nga një fjalë thumbuese që i thotë një grua nga Guaskonja, nga i plogët bëhet energjik.

Urdhri i fundit i mbretëreshës ishte për Elizën, e cila, papritur që t'i jepej fjala, filloi plot gëzim:

Ka qëlluar shumë herë, shoqet e mia të reja, se vetëm një fjalë e thënë rastësisht dhe jo *ex proposito*¹¹, ka vepruar më mirë në shpirtin e njeriut, sesa qortimet e ndryshme dhe ndëshkimet e shumta që ka pësuar, gjë që shihet fare mirë në rrëfenjën që kallëzoi Laureta. Po këtë gjë dua t'ju tregoj edhe unë me një rrëfenjë fare të shkurtër. Meqenëse rrëfenjat e mira janë kurdoherë të dobishme, duhen dëgjuar me vëmendje cilido qoftë ai që i kallëzon.

Them pra se në kohët e mbretit të parë të Qipros, pasi Godfred de Builloni pati pushtuar Tokën e Shenjtë, qëlloi të na vejë në pelegrinazh te Varri i Shenjtë një zonjë bujare nga Guaskonja, e cila, duke u kthyer prej andej, arriti në Qipro, ku disa njerëz të ligj e fyen keqas. Ajo, e hidhëruar dhe pa shpresë që të merrte hakën, mendoi të vente të ankohej te mbreti, por dikush i tha se do të mundohej kot, pasi ai ishte aq i dobët dhe i paaftë, saqë, jo vetëm të tjerëve nuk ua merrte hakën me drejtësi, por, përkundrazi, i duronte poshtërsitë dhe fyerjet e panumërta që i qenë bërë atij vetë, prandaj, cilido që t'i kishte ndonjë inat, e shfrente duke e turpëruar e sharë.

Duke dëgjuar këto fjalë zonja, e dëshpëruar që s'mund të merrte hakën, për t'u ngushëlluar pak nga mërzia që e kish pushtuar, vendosi të godiste dobësinë e mbretit të përmendur. I vajti, pra, duke qarë dhe i tha:

- Madhështi, s'kam ardhur këtu për të kërkuar hakmarrje për dhunën që më është bërë në mbretërinë tuaj, por si shpërblim, në vend të kësaj, të lutem, të më mësosh se si i duron ti të gjitha ato fyerje që kam dëgjuar që të janë bërë që, kështu, duke mësuar prej teje, të mund dhe unë të duroj poshtërimin që më është bërë, të cilin, sikur të kisha mundësi do të ta falja ty me gjithë zemër, meqenëse e paske kaq të regjur kurrizin.

Mbreti, që gjer atëherë kishte qenë i plogët dhe i ngadalshëm, sikurse të ishte zgjuar nga gjumi, duke filluar nga dhuna që i qe bërë kësaj gruaje, e cila

¹¹ Me qëllim.

i dha një shuplakë të rëndë, ndoqi me rreptësi këdo që andej e tutje guxoi të prekte nderin e kurorës së tij.

Dita e parë, rrëfenja e dhjetë

Dr. Alberti nga Bolonja, me një përgjigje thumbuese, bën të turpërohet një grua, që kërkon të tallet me të, ngase ai e dashuron.

Si mbaroi Eliza, mundimi i fundit i të kallëzuarit të rrëfenjës i mbetej mbretëreshës që, me mënyrën e saj prej femre, filloi të flasë kështu:

Vasha të hijshme, sikundër në natën e kthjellët stolia e qiellit janë yjet dhe në pranverë janë lulet dhe livadhet e gjelbëruara, ashtu janë fjalët e hijshme thumbuese, stolia e sjelljeve të lavdërueshme dhe e bisedave të këndshme. Të folurit me thumba, duke qenë zakonisht i shkurtër, iu përshtatet më tepër grave sesa burrave, ndërsa të folurit e shumtë dhe të zgjatur, u përshtatet më tepër burrave sesa grave. Sot janë të pakta ato gra, ose s'ka fare, që i kuptojnë fjalët e hijshme e thumbuese dhe, edhe në qoftë se i kuptojnë, s'dinë të japin përgjigje me vend. Turp i madh, për Zotin, për ne dhe për të gjitha gratë e sotme! Përkujdesjen që dikur gratë e kohëve të lashta tregonin për zbukurimin e shpirtit, gratë e kohëve moderne e kanë kthyer në zbukurimin e trupit dhe sot, ajo grua që vesh rroba të shumëngjyrshme, me garnitura e zbukurime të shumta, pandeh se vlen më shumë, kërkon të nderohet më tepër nga të tjerat dhe nuk mendon se, po të kishte gomari një njeri që ta vishte, mund të mbante në kurriz më shumë nga këto rroba, por, megjithatë, nuk do të nderohej, për këtë shkak, më shumë nga ç'mund të nderohej gomari.

Mua më vjen turp që i them këto, se nuk mund të flas kundër të tjerave, pa folur për vete, por këto gra me kaq stoli, të lyera e të përlyera, ose rrinë si përmendore mermeri, memece e të pandjeshme, ose, në qoftë se i pyet kush, përgjigjen në mënyrë që do të ishte më mirë të mos përgjigjeshin fare. Ato gënjejnë veten kur besojnë se mosaftësia e tyre për të biseduar me zonja dhe me burra të urtë, vjen nga pastërtia e shpirtit, duke quajtur budallallëkun e tyre modesti, sikur gra modeste të ishin vetëm ato që bisedojnë me shërbëtoren, me teshalarësen e me kuzhinieren e tyre. Por, sikur të kishte dashur natyra një gjë të tillë, sikur duan të japin të kuptosh ato, do t'ua kufizonte në tjetër mënyrë të cicëriturit e tyre.

Sikundër në çdo punë, edhe në të folurit me thumba është e vërtetë se duhet pasur parasysh koha, vendi dhe njeriu me të cilin bisedon se, ngandonjëherë qëllon që një grua ose burrë qoftë, për shkak se nuk i ka matur fuqitë e veta me të atij me të cilin bisedon, duke pandehur se tallet me të, mbetet i tallur vetë. Prandaj, që të kemi mendjen nga kjo gjë, dhe veç kësaj, që të përgënjeshtrojmë atë që thuhet zakonisht se grave u vete pisk çdo punë, dua të merrni mësim nga kjo rrëfenjë e fundit e ditës së sotme që më përket mua ta kallëzoj, kështu që, sikurse doni të dalloni nga të tjerat për fisnikëri shpirti, të dalloni edhe për sjellje të shquara.

S'kanë shkuar shumë vjet që në Bolonjë ka qenë një mjek i përmendur, i quajtur dr. Alberti, i cili ndofta është gjallë edhe sot. Zotëria e tij, duke qenë plak afër shtatëdhjetë vjeç, qëlloi të na shohë në një festë një grua të ve të bukur fort, të quajtur, sikundër thonë disa, Malgeritë e Gisoljerëve, e cila i pëlqeu fort dhe, si njeri me zemër bujare që ishte, u rrëmbye përnjëherë nga dashuria për të, sado që i qe venitur në trup çdo ndjenjë burrërie por, sikur të ishte djalë i ri, zemra s'i pushonte së rrahuri për të. Natën s'e zinte gjumi, po të mos kishte parë ditën fytyrën e këndshme dhe delikate të gruas së bukur.

Për këtë arsye, filloi të kalonte dendur përpara shtëpisë së saj, herë më këmbë e herë kaluar, si t'i vinte për mbarë. Gruaja dhe shumë shoqe të saj e kuptuan shkakun se pse kalonte andej dhe shumë herë qeshën së bashku, duke parë të binte në dashuri një burrë i pjekur dhe i moshuar. Ato mendonin se pasioni i ëmbël i dashurisë u dashkësh të prekte vetëm shpirtrat e lehtë të djemve dhe jo të burrave të vjetër.

Ndërsa dr. Alberti vijonte të kalonte s'andejmi, në një ditë feste, kur kjo grua dhe shumë shoqe të tjera të saj kishin dalë dhe rrinin përpara portës, qëlloi ta shohin atë prej së largu që po afrohej dhe vendosën ta ftonin, ta nderonin dhe pastaj të luanin me të e ta thumbonin për dashurinë e tij. Sapo që arriti ai, u ngritën në këmbë, e ftuan dhe e shpunë në një oborr të freskët, ku i nxorën verëra nga më të mirat dhe ëmbëlsira. Së fundi, me fjalë të bukura dhe të zgjedhura, Malgerita e pyeti se si ishte e mundur që ai të dashurohej me një grua të bukur, të cilën e dinte se e dashuronin shumë djem të rinj, të bukur e të hijshëm.

Doktori që e ndjeu veten të thumbuar në mënyrë të njerëzishme, vuri buzën në gaz dhe u përgjigj:

- Të qenët unë i dashuruar, zonjë, s'duhet të çudisë njeriun e urtë dhe sidomos atë që dashuroj, sepse ju e meritoni dashurinë. Sado që burrat e vjetër i ka lënë fuqia e nevojshme në veprime dashurore, kjo nuk do të thotë

se u është shuar, për këtë shkak, as dashamirësia e as të kuptuarit e asaj që duhet dashuruar. Përkundrazi, meqenëse ata kanë më shumë përvojë, e kuptojnë këtë gjë më mirë se të rinjtë. Shpresa që më shtyn mua, një burrë të vjetër, t'ju dashuroj juve që ju dashurojnë shumë trima, është kjo: jam ndodhur shumë herë në raste ku kam parë zonja të hanë dhe kam parë që ato hanë thjerrëza dhe presh. Dihet se asnjë pjesë e prarit nuk është e shijshme. Por megjithëkëtë, koka është disi më e mirë se gjethet e tij. Prapë, ju përgjithësisht, të nxitura nga një uri e keqe, e kapni prasin nga koka dhe i hani gjethet, të cilat jo vetëm që s'janë fare për të qenë, por kanë dhe shije të keqe. Tani, kush mund ta dijë, zonjë, se ju nuk bëni këtë gabim dhe në zgjedhjen e të dashurit? Dhe, po të bëni kështu, do të isha unë ai që do të zgjidhesha prej jush dhe të tjerët do të hidheshin poshtë.

Gratë mbetën pak të turpëruara dhe bujaresha tha:

- Fort mirë doktor, na qortuat njerëzisht për qëndrimin tonë të pamatur, megjithatë, dashuria juaj më pëlqen, sepse jeni njeri i urtë dhe i zoti, prandaj veç nderit tim, mos u ndruani të kërkoni prej meje çdo gjë tjetër që mund t'ju kënaqë dhe ajo do të jetë juaja.

Doktori, si u ngrit nga shoqërimi me zonjat, falënderoi gruan dhe, i qeshur, mori leje prej saj midis gëzimit dhe iku. Kështu, gruaja, duke nënvlerësuar atë me të cilin desh të tallej, pandehi të dilte fituese dhe mbeti e mundur. Prandaj, ju, në doni të jeni të urta, të keni mendjen shumë të mos bëni të njëjtin gabim.

Përfundimi

Dielli kish filluar të ulej nga perëndimi dhe vapa qe pakësuar mjaft në kohën kur morën fund rrëfenjat e vashave dhe trimave. Në këtë kohë, mbretëresha u tha me ëmbëlsi:

- Tani, shoqe të dashura, s'më mbetet të bëj tjetër gjë si mbretëreshë për ditën e sotme, veç t'ju jap një mbretëreshë të re, e cila të caktojë për të ardhmen, për vete dhe për ne të gjithë, dëfrime të përshtatshme, si ta shohë më mirë, ndonëse s'mund të themi se dita e sotme ka mbaruar, gjersa s'ka ardhur nata. Është mirë të marrim pak kohë nga dita e sotme, se ndryshe, s'është e mundur të merren të gjitha masat për nesër. Që të ketë mundësi të përgatitet me kohë çdo gjë e nevojshme që do të caktojnë mbretëreshat e reja këtej e tutje, jam e mendimit që zgjedhja e tyre të bëhet në këtë orë.

- Për hir të Atij që mban në jetë gjithçka shohim dhe për kënaqësinë tonë, ditën e nesërme, mbretërinë tonë, do ta udhëheqë vasha jonë shumë e matur, Filomena.

Si tha këto fjalë, hoqi kurorën prej dafine dhe ia vuri mbi krye me përlësi Filomenës dhe, së pari, ajo, e pastaj të tjerat bashkë me tre trimat, e përshëndetën mbretëreshën dhe iu nënshtruan me kënaqësi zotërimit të saj.

Filomena, e skuqur pak nga turpi, kur pa se u kurorëzua mbretëreshë, duke kujtuar fjalët që i kish thënë më parë Pampineja, për të mos u dukur e plogët, mori guxim dhe së pari sanksionoi të gjitha ligjet që kishte vënë paraardhësja e saj, pastaj caktoi gjithë ç'duhej bërë të nesërmen që nga mëngjesi e gjer në darkë, duke vendosur që të mbeteshin te vendi ku gjendeshin. Në fund, u mbajti këtë fjalim:

- Fort të dashura shoqe, sado që Pampineja, më shumë për oborrësinë e saj, sesa për vlerën time, më zgjodhi mbretëreshë për ju të gjitha, nuk jam e mendimit që për kujdesin e shoqërisë sonë të shkoj vetëm pas mendjes sime, por do të ndjek edhe mendimin tuaj. Po jua bëj të ditur me pak fjalë se ç'duhet bërë që të keni mundësi të shtoni a të hiqni sipas dëshirës suaj. Unë, me sa pashë sot, rregullat që vuri Pampineja m'u dukën sa të lavdërueshme, aq dhe zbavitëse dhe prandaj nuk kam qëllim t'i ndryshoj, gjersa ato të mos bëhen të mërzitshme nga përdorimi i zgjatuar a nga ndonjë shkak tjetër.

- Si të kem dhënë urdhër për të bërë ato gjëra që kemi filluar, me t'u ngritur këtej, do të vemi të dëfrehemi pak dhe në mbrëmje do ta bëjmë darkën në një vend të freskët. Pas kësaj, si të kemi kënduar ndoca këngë dhe të kemi bërë të tjera dëfrime, do të jetë mirë të vemi të flemë. Nesër në mëngjes do

të ngrihemi herët në të freskët dhe po ashtu si sot, do të vemi gjëkund për t'u zbavitur. Si të bëjë secili si t'i pëlqejë, sikurse bëme edhe sot, në orën e caktuar do të kthehemi për të bërë drekën, do të heqim valle dhe, pasi të ngrihemi nga gjumi, ashtu siç bëme edhe sot, do të vijmë prapë këtu në këtë vend për të kallëzuar rrëfenja, sepse më duket se në këto gjejmë kënaqësinë dhe dobinë më të madhe.

- Vetëm dua të shtoj se, një gjë që s'mundi ta bënte Papineja se u zgjodh vonë, mendoj të filloj ta bëj unë. Dua të them të kufizoj brenda një qarku të caktuar thënien e rrëfenjave, të cilën do t'jua njoftoj që më parë, që kështu secilit të ketë kohë të mjaftë të mendojë një rrëfënjë të bukur për të kallëzuar. Meqenëse njerëzit, që nga krijimi i botës dhe gjer sot, kanë qenë gjithnjë lojë e fatit dhe kështu do të jenë sa të jetë bota, në qoftë se ju pëlqen edhe juve, kam menduar që tema të jetë: "Mbi ata njerëz të cilët, pas shumë fatkeqësish që kanë pësuar në jetë dhe që kanë humbur çdo shpresë, kanë arritur në një përfundim të lumtur".

Si e pëlqyen këtë urdhëresë si vashat edhe trimat, u zotuan se do ta zbatonin. Por, Dioneu, kur heshtën të gjithë, tha këto fjalë:

- Madhështi, sikundër thanë të gjithë të tjerët se urdhri që dhatë është plotësisht i pëlqyer dhe i lavdërueshëm, ashtu them dhe unë. Por, megjithëkëtë, ju kërkoj me lutje të jashtëzakonshme të bëni një përjashtim për mua, duke më dhënë një privilegj që dëshiroj të më njihet gjersa të zgjasë shoqëria jonë. Privilegji që kërkoj është që të mos jem i detyruar, në qoftë se nuk dëshiroj vetë, t'i nënshtrohem ligjit, sipas të cilit të ndjek temën e caktuar, por të jem i lirë të kallëztoj ç'të dua vetë. Që të mos pandehë njeri se unë e kërkoj këtë privilegj ngase s'di shumë rrëfenja, nga tani e tutje le të jem i fundit që të flas.

Mbretëresha që e njihte atë që ish njeri i brohorive dhe i gëzimeve, e kuptoi fare mirë se këtë përjashtim e kërkonte me qëllim që të dëfrente shoqërinë në rast se mërzhitej, duke dëgjuar ndonjë rrëfënjë të tij të bukur e gazmore dhe, prandaj, me pëlqimin edhe të të tjerëve, ia dhanë këtë të drejtë me kënaqësi.

Pas kësaj, u ngritën dhe me hapa të ngadalshëm shkuan drejt një vije uji shumë të kulluar që zbriste nga një mal në një luginë të hijeshuar nga shumë drurë midis gurësh e bari të njomë. Këtu, duke shkuar nëpër ujë zbathur dhe me llërë përveshur, u dëfryen dhe brohoritën midis tyre. Kur afroi ora e darkës, u kthyen në vilë dhe bënë darkën me kënaqësi.

Pas buke, dërguan e morën veglat dhe mbretëresha dha urdhër që të nisnin një valle që do ta udhëhiqte Laureta, ndërsa Emilia do të këndonte një këngë

të shoqëruar me lahutë nga Dioneu. Sipas këtij urdhri, Laureta menjëherë filloi të udhëhiqte vallen dhe Emilia ia mori përmallshëm kësaj kënge:

Jam kaq e dashuruar me bukurinë time, sa që për tjetër dashuri kurrë s'do më shkojë mendja, as besoj se dëshiroj.

Unë shoh tek ajo, sado herë që shihem në pasqyrë, atë mirësi që më kënaq mendjen dhe, as rasti i ri, as mendimi i vjetër nuk mund të më shqitet nga kjo kënaqësi e ëmbël. Ç'gjë tjetër të kënaqshme mund të shihja që të më ngjallte në zemër një dashuri të re?

S'më shqitet nga sytë kjo mirësi, kur dëshiroj ta sodis për kënaqësinë time, dhe është aq e ëmbël, sa as fjala e njeriut nuk mund ta shprehë e as nuk mund ta kuptojë kënaqësinë që unë ndiej.

Sa më tepër ia ngjis sytë, aq më tepër ndizem për të. E tëra i dhurohem, e tëra i jepem. Duke shijuar gjithçka që ajo më ka premtuar, shpresoj prej saj gëzim të madh, aq sa një i tillë gëzim dashurie nuk është ndier ndonjëherë në botë.

Edhe pse kjo këngë i bëri disa të mendonin për kuptimin e saj, të gjithë kënduan bashkë me Emilinë, dhe pasi disa të tjerë e kaluan natën me vallëzime, mbretëreshës i pëlqeu t'i jepte fund ditës së parë. U tha të ndiznin kandilat dhe dha urdhër që secili të shkonte të pushonte gjer të nesërmen në mëngjes. Kështu, gjithkush shkoi në dhomën e vet dhe ra e fjeti.

Fundi i ditës së parë

Dita e dytë

Fillon dita e dytë e Dekameronit në të cilën nën kujdesin e Filomenës, bëhet fjalë për ata njerëz që, pas shumë fatkeqësish që kanë pësuar, kanë arritur në një përfundim të lumtur.

Hyrje

Drita e diellit kish filluar të përhapej në gjithë horizontin dhe zogjtë me këngët e tyre të këndshme nga degët e gjelbëruara lajmëronin lindjen e ditës së re, kur vashat të gjitha si dhe tre trimat që ishin ngritur nga gjumi, u shpërndanë nëpër kopshte, ku, duke baritur nga njëra anë te tjetra mbi barin e njomë me vesë, po dëfreheshin dhe po bënë kurora të bukura me lule. Dëfrimet e kësaj dite të këtij grupi janë të njëllojta me ato të ditës së mëparshme: bënë drekën në të freskët, hodhën valle dhe pastaj vajtën për të fjetur. Aty nga ora tre, kur u ngritën, sipas dëshirës së mbretëreshës, vajtën përsëri në livadhin e freskët dhe u ulën rreth e qark tij.

Mbretëresha, e cila ishte e bëshme dhe tërheqëse në fytyrë, e kurorëzuar me kurorën prej dafine, iu drejtoi të gjithëve një vështrim të ëmbël dhe pastaj i dha urdhër Neifilës të niste kallëzimin e rrëfenjës së parë të kësaj dite. E sigurt në zotësinë e saj, Neifila filloi të thoshte rrëfenjën.

Dita e dytë, rrëfenja e parë

Martelini bën sikur është i kruspulluar dhe sikur shërohet mbi kufomën e Shën Enrikut. Kur merret vesh gënjeshtria e tij, kapet, kopaniset e rrezikohet të varet në litar. Në fund shpëton.

Shumë herë, shoqe të dashura, ka ndodhur që kush ka dashur të tallet me tjetrin dhe, sidomos me ndonjë nga ata që duhen adhuruar, ka mbetur i tallur dhe, ngandonjëherë, i dëmtuar. Tani dua t'ju jap një provë të kësaj të vërtete me rrëfenjën që do t'ju kallëzoj, e cila përputhet pikërisht edhe me temën që na ka caktuar mbretëresha. Do të shihni se qysh një bashkëqytetari ynë, në të parë pësoi një fatkeqësi të madhe, pastaj, pa pasur asnjë shpresë, përfundoi në gëzim.

Pak kohë më parë në Trevizo ka qenë një austriak që quhej Enrik i cili, i shtrënguar nga varfëria, robtohej duke mbartur në krahë gjëra të njerit e tjetrit që kishin nevojë. Me gjithë gjendjen e tij të keqe, të gjithë e njihnin si njeri të fortë, të shenjtë dhe të mirë. Nga ky shkak, nuk e dimë nëse është e vërtetë apo jo por, sipas thënieve të trevizonasve, kur erdhi dita e vdekjes, në orën kur jepte e merrte shpirt, qëlloi të binin të gjitha kambanat e “Kishës së Madhe” të Trevizos pa i tundur njeri.

Kjo ngjarje u gjykua si mrekulli. Të gjithë thoshin se Enriku ishte i shenjtë. I tërë populli i qytetit u lëshua për në shtëpinë ku gjendej kufoma e tij, e morën si një trup të shenjtë dhe e shpunë te “Kisha e Madhe”. Aty grahën të çalë e të verbër, të kruspulluar me gjithfarëlloj sëmundjesh e të gjymtë nga trupi, duke pandehur se do të shëroheshin me një të prekur të asaj kufome.

Në mes të kësaj zhurme të madhe dhe të rendjes së popullit, qëlloi të vinin në Trevizo tre nga bashkëqytetarët tanë prej të cilëve, njëri quhej Steki, tjetri Martelin dhe i treti Markez, njerëz të cilët kur vizitonin oborret e zotërinjve dëfrenin gjindjen duke shtrembëruar fytyrat në mënyrë që të mos njiheshin ose t'i shëmbëllenin ndonjë tjetri si dhe duke imituar me gjeste të tjera cilindo. Këta, meqë s'kishin qenë kurrë këtu, kur panë njerëzinë që po vraponte, mbetën pa gojë dhe kur morën vesh se ç'ishte shkak, me kënaqësi vendosën të venin të shikonin. Si lanë plaçkat në një hotel, Markezi tha:

- Ne duam të vemi të shohim këtë shenjt, por unë, për pjesën time, nuk di sesi mund të hymë, pasi dëgjova se sheshi është mbushur me austriakë e me njerëz të tjerë të armatosur që ka vënë Kryezoti i këtij vendi që të kujdesen që të mos bëhet zhurmë dhe, veç kësaj, me sa flitet, në kishë kanë vajtur kaq shumë njerëz, sa thuhet se kurrkush s'mundet të hyjë më brenda.

- Për këtë mos u bëj merak, - i tha Martelini, të cilit i pëlqente të shihte këtë ngjarje, - se, sa për të arritur gjer te trupi i shenjtë, e gjej unë mënyrën.

- Qysh? - tha Markezi.

- Ta them unë - iu përgjigj Martelini, - unë do të bëhem si i kruspulluar dhe ti nga njëra anë e Steki nga tjetra do të më mbani, sikur të mos mundja dot të vija vetë, dhe do të bëni sikur doni të më shpini aty që të më shërojë shenjt. Kështu, kushdo që do të na shohë, ka për të na hapur vendin dhe ka për të na liruar rrugën të shkojmë.

Markezit dhe Stekit u pëlqeu ky mendim. Pa humbur kohë, dolën nga hoteli dhe të tre burrat u tërhoqën në një vend të mënjanuar ku Martelini shtrembëroi duart, gishtërinjtë, krahët e kërcinjtë dhe, veç këtyre, gojën, sytë e gjithë fytyrën, në mënyrë që të dukej i ngjethshëm. Kështu si qe bërë, kurrkush s'mund të mos thoshte se ky qe i paralizuar dhe i vajtur. Pastaj Markezi dhe Steki e morën kështu të shtrembëruar dhe u drejtuan nga kisha. Pamja e tij i mallëngjeu të gjithë. Të gjithë atyre që takonin u luteshin me përvullësia që për hir të Perëndisë t'u hapnin rrugën. Kështu, ndërsa të gjithë po i vështronin e thërrisnin "Hapuni, hapuni", arritën te vendi ku qe vendosur kufoma e shën Enrikut. Disa bujarë, që ishin aty rrotull, e morën Martelinin me të shpejtë dhe e vunë përmbi kufomën për të fituar shëndetin.

Ndërsa njerëzia rrinin e vështronin më vërejtje se ç'do ngjante, Martelini, pasi qëndroi pak, si i shkathët që ishte në këto punë, filloi të nderte njërin prej gishtërinjve, pastaj dorën, më pas krahët dhe kështu të gjitha. Kur njerëzia pa këtë gjë, bëri një zhurmë kaq të madhe për lavdi të shën Enrikut, saqë as bubullimat s'mund të dëgjoheshin.

Për fat të keq, afër këtij vendi u ndodh një fjorentin që e njihte fare mirë Martelinin, por s'e kish njohur kur e prunë shokët pasi qe shtrembëruar. Ky zotëri, kur e pa me gjymtyrë të drejtuara, e njohu, qeshi dhe me të shpejtë i tha:

- Të vraftë Zoti, të vraftë! Kush nuk do të besonte se nuk ishe vërtetë i kruspulluar kur të panë duke ardhur?

Këto fjalë i dëgjuan disa trevizonas që menjëherë e pyetën:

- Si, nuk qenkej i kruspulluar?

- S'e ka dhënë Zoti, - iu përgjigj fjorentini, - ai ka qenë përherë i drejtë si kushdo nga ne, por, si e patë vetë, ka zotësi më shumë se kushdo në të bërët e lojërave të tilla, duke u shndërruar në çdo trajtë që të dojë.

Me të dëgjuar këta këto fjalë, nuk patën nevojë për më shumë, u shtynë përpara me rrëmbim dhe zunë të bëritnin:

- Kapeni tradhtarin se tallet me Zotin dhe me shenjtorët, nuk është i kruspulluar, por ka ardhur ashtu këtu për të vënë në lojë shenjtin tonë dhe ne bashkë.

Dhe, duke thënë kështu, e rrëmbyen nga vendi ku ishte e, duke e përplasur përdhe, e kapën prej flokësh, ia grisën të gjitha rrobat e trupit dhe e zunë me grushte e me shkelma. Të mjerit i dukej sikur të gjithë sa ishin, merrnin pjesë në rrahjen e tij dhe thërriste: “Mosni, në daçi Perëndinë!” dhe, me sa mundej, përpiquej të mbrohej, por më kot. Grumbulli i njerëzve shtoej gjithnjë e më shumë në kurriz të tij.

Kur panë këtë Steki dhe Markezi, e kuptuan se s’ e kishin mirë punën. Për ta ndihmuar, nuk guxonin se i trembeshin kokës, dhe prandaj, edhe këta, së bashku me të tjerët, thërritnin: “Vrajeni, vajeni!” por, megjithëkëtë, kishin mendjen që ta hiqnin nga duart e popullit që kishte për ta vrarë me siguri, po të mos kishin përdorur me të shpejtë një dredhi. Duke qenë aty përjashta gjithë xhandarët e Sinjorisë, Markezi, me sa mund pati, vajti tek ai që ishte zëvendës podestà¹ dhe i tha:

- Paç Perëndi, aty brenda është një hajdut që më ka vjedhur kuletën me treqind florinsa në të, ju lutem kapeni dhe merrjani.

Me të dëgjuar këto fjalë, me të shpejtë, plot dymbëdhjetë xhandarë vrapuan të vendi ku fatkeqi Martelini ishte duke u rrahur. Me një mijë mundime çanë turmën, e hoqën prej duarve të tyre të copëtuar e të shtypur dhe e shpunë në pallatin e qeverisë, ku e ndoqën nga pas shumë veta që thoshin se kishte gënjyer. Kur dëgjuan këta se qe kapur për vjedhje kulete, duke mos e gjetur t’i ngarkonin faj më të rëndë, thanë se edhe këtyre u kishte vjedhur kuletat.

Kur dëgjoi këto fjalë gjykatësi i podestasë, i cili ish njeri i ashpër, e hoqi me të shpejtë mënjatë dhe zuri ta hetonte mbi këtë gjë. Mirëpo Martelini i përgjigjej si me tallje dhe dukej sikur s’ e çante fort kryet që ishte kapur. Gjykatësi u egërsua nga kjo sjellje dhe, që të rrëfente fajin për të cilin paditej dhe pastaj ta varte nga zverku, e lidhi me litar dhe i hoqi plot shuplaka të mira. Pastaj, si u vu përdhe dhe gjykatësi e pyeti nëse ishte e vërtetë ajo që thoshin paditësit për të dhe si e pa që do të ishte i kotë mohimi, Martelini tha:

- Zot i mirë, jam gati t’ju tregoj të vërtetën, por më parë pyetni të gjithë ata që më paditën se kur dhe ku ua kam vjedhur kuletat, pastaj kam për t’ju thënë ç’kam e ç’ nuk kam bërë.

- Kjo më pëlqen, - tha gjykatësi. - Pastaj dërgoi e thirri disa nga paditësit dhe i pyeti. Prej këtyre, njëri thoshte se ia kish vjedhur tetë ditë përpara, tjetri gjashtë, kush shtatë dhe disa thoshin atë ditë.

¹ Podestá - kryeqeveritar, kryegjykatës në atë kohë.

- Zot i mirë, - tha Martelini, kur dëgjoi këto fjalë, - ata të gjithë gënjejnë pa pikën e turpit dhe, që të them të vërtetën, mund t'ju jap këtë provë (që të mos kisha thyer këmbën të vija kurrë në këtë vend, sikundër s'kam ardhur ndonjëherë, veç kësaj radhe) që, si arrita për të zezën time, vajta dhe unë të shihja këtë trup të shenjtë ku më kashaisën kështu si më shihni dhe, që është e vërtetë kjo që ju them, mund t'jua ndriçojë nëpunësi i zyrës së të huajve e regjistri i tij si dhe hanxhiu. Prandaj, po të jetë kështu si them unë, mos më mundoni dhe mos më vritni për qejfin e këtyre njerëzve të ligj.

Ndërsa punët po venin kështu, Markezi e Steki, të cilët kishin dëgjuar se gjykatësi i podestasë po merrte masa të rrepta kundër shokut të tyre dhe e kishte vënë edhe nën torturë, ndienë frikë të madhe dhe thanë me njëri-tjetrin "Kemi bërë keq, e hoqëm nga shiu, e hodhëm në breshër". Prandaj, me kujdes të madh, dolën rrotull, gjetën hanxhiun dhe i kallëzuan se ç'kishte ngjarë. Ky qeshi kur dëgjoi këtë gjë dhe i shpuri te njëfarë Sandër Agolanti që banonte në Trevizo dhe që e kishte shumë të grunjte me guvernatorin e vendit, të cilit ia kallëzoi të gjitha me radhë dhe iu lut bashkë me ta që të kujdesej për punën e Martelinit.

Sandri, pas shumë të qeshurash, shkoi te guvernatori dhe iu lut të dërgonte njerëz për Martelinin. Kështu u bë. Të dërguarit e gjetën të gjorin vetëm me këmishë përpara gjykatësit, krejt të mahnitur dhe të frikësuar, se gjykatësi s'donte të merrte parasysh asgjë për shpëtimin e tij dhe, meqë kishte njëfarë urrejtje për fjorentinët, e kish mbledhur top që ta varte në litar. Gjykatësi nuk donte t'ua dorëzonte kurrsesi Martelinin, veç kur u shtrëngua me pahir. Martelini, kur u paraqit te guvernatori ia rrëfeu të gjitha me radhë dhe iu lut që si mirësinë më të madhe që mund t'i bënte, ishte ta linte të lirë, pasi gjithnjë i dukej sikur do të kish litarin në qafë gjersa të arrinte në Firence. Guvernatori u shkul së qeshuri nga një e tillë ngjarje dhe si iu fali nga një palë rroba për shoq, gjë krejt e papritur, i la të lirë. Kështu, të tre bashkë, si shpëtuan nga ky rrezik i madh, u kthyen në shtëpi shëndosh e mirë.

Dita e dytë, rrëfenja e dytë

Rinaldi prej Asti, si plaçkitet prej hajdutësh, gjendet në Kështjellën Guljelm, ku gjen strehë pranë një gruaje të ve. Aty hedh prapë në dorë gjithçka që i qe plaçkitur dhe kthehet në shtëpi shëndoshë e mirë.

Vajzat u shkullën së qeshuri me fatkeqësitë e Martelinit, të kallëzuara nga Neifila dhe, midis meshkujve, u zbavit më shumë Filostrati. Meqenëse ky qe në krah të Neifiles, mbretëresha i dha urdhër të vijonte me rrëfenjën e tij. Dhe ai filloi menjëherë:

Dëshiroj vajza të bukura, t'ju kallëzoj një rrëfenjë që ka lidhje me punë fetare. Përmbajtja e saj është një gërshetim mëshire, fatkeqësie dhe dashurie dhe besoj se do të jetë e dobishme që ta dëgjojnë, sidomos ato që kanë hyrë nëpër rrugët e rrezikshme të dashurisë, se shumë herë qëllon që, po të mos thonë *patërnostrin*² dhe shën Julianit³, edhe po të kenë shtrat të mirë, kalojnë natë të keqe.

Në kohët e markezit Aco nga Ferrara, ishte një tregtar që quhej Rinaldo prej Astit e që kishte vajtur në Bolonjë për disa punë. Ky, pasi kreu punët dhe po kthehej kaluar në shtëpi, duke dalë nga Ferrara, në rrugën që të shpie për në Veronë, qëllloi të haste disa njerëz që dukeshin si tregtarë, po që, në të vërtetë, ishin kusarë dhe keqbërës të ligj, me të cilët u shoqërua pa i shkuar mendja për keq.

Ata, si e njohën që ishte tregtar dhe kuptuan që do kishte pará me vete, vendosën me njëri-tjetrin ta plaçkitnin posa t'i gjenin rastin dhe, që ai të mos kishte ndonjë dyshim për ta, si të ishin njerëz të mirë dhe të fisëm, bisedonin me të mbi punë të nderuara e mbi besnikërinë, duke iu treguar kështu, me sa iu vinte doresh, të përlulët dhe dashamirës ndaj tij. Për këtë arsye tregtari e quante fatbardhësi që i kishte hasur, pasi s'kishte dhe ndonjë tjetër me vete, veç një shërbëtori kaluar. Duke udhëtuar kështu e duke kaluar nga njëra bisedë në tjetrën, si ndodh në të tilla raste, zunë të bënin fjalë mbi lutjet që njerëzit i bëjnë Perëndisë dhe njëri prej tre kusarëve i tha Rinaldit.

- Po ju, zot i mirë, çfarë lutje bëni kur jeni në udhëtim?

- Të them të drejtën, iu përgjigj Renaldi, unë në të tilla gjëra jam njeri i thjeshtë dhe pak i ditur. Unë i thashë lutjet që di, që janë të pakta, pasi unë heq si të vjetrit dhe s'hyj në stërhollime por, megjithëkëtë, e kam pasur për zakon kurdoherë të them në mëngjes, kur dal nga bujtina për udhëtim, një *patërmostër* e një *avemaria*⁴ për shpirt të atit dhe s'ëmës së shën Juljanit dhe pas kësaj i lutem Perëndisë dhe shën Julianit që të më falin bujtje të mirë në mbrëmjen e asaj dite. Nëpër udhëtime jeta ime ka qenë shumë herë në rreziqe

² Paternoster - lutje në katolicizëm

³ Shën Juljani - mbrojtës i udhëtarëve. Udhëtarët i luteshin atij për të gjetur bujtje të mirë gjatë udhëtimit.

⁴ Avemaria – lutje në katolicizëm.

të mëdha, të cilat të gjitha i kam kapërcyer dhe natën e kam kaluar në vende dhe bujtina të mira. Nga ky shkak jam fare i bindur se shën Julianit, për nder të të cilit i them lutjet, më ka siguruar këto të mira nga ana e Perëndisë. Po të mos i bëja në mëngjes këto lutje, dita më dukej se s'do të më shkonte mbarë dhe nata po ashtu.

- Po sot në mëngjes i bëtë lutjet? - i tha ai që e kishte pyetur.

- Po i bëra, - iu përgjigj Rinaldi.

Atëherë, ai që e dinte se si kishte për t'i shkuar puna, tha me vete: “Të ardhhtë në ndihmë shën Juliani se, në qoftë se s'na vete huq, me sa ma pret mendja, s'ke gjë në udhë, natën e ke për të shkuar si mos më keq” dhe pastaj i tha:

- Edhe unë, ashtu si ju, kam udhëtuar shumë dhe, ndonëse kurrë s'i kam bërë lutje këtij shenjti, edhe pse kam dëgjuar shumë njerëz ta lëvdojnë tepër, kurrë në jetën time s'më ka qëlluar të kaloj natë të keqe. Sonte keni për të parë se kush ka për të bujtur më mirë, ju që keni bërë lutjet, apo unë që s'i kam bërë. Por, është e vërtetë se unë, në vend të asaj lutjeje, përdor *Dirupistin a Intenerata* ose *De profundin*⁵ që, siç më thoshte gjyshi, janë shumë dobiprurëse.

Dhe, kështu, me bisedime mbi sende të ndryshme, udhëtonin duke pritur vendin e kohën për të përmbushur qëllimin e tyre të poshtër. Në të errur, përtej Kështjellës Guljelm, ku do të kapërcenin një lumë, këta të tre, si panë që ora kishte kaluar dhe vendi ishte i mënjanuar dhe i mbyllur, iu vërsulën, e grabitën, i morën dhe kalin dhe, si e lanë vetëm me këmishë, ikën duke i thënë:

- Shko dhe mëso nëse ka për të të ndihmuar të bujtësh mirë sonte shën Juliani yt, se ai yni na ka siguruar prehje si jo më mirë.

Kapërcyen lumin e u larguan.

Shërbëtori i Rinaldit, kur pa që iu vërsulën të zotit të tij, si frikacak që ishte, nuk u përpoq fare ta mbronte, por ktheu kalin dhe ia ngrehu vrapit gjersa arriti në Kështjellën Guljelm, ku hyri në të muzgët dhe e kaloi natën pa çarë më kryet. Rinaldi, i mbetur vetëm me këmishë e zbathur në një të ftohtë të hidhur, nën borën që po binte pareshtur, dridhej e kërciste dhëmbët dhe, duke mos ditur ç'të bënte, zuri të vështronte se mos gjente ndonjë strehë

⁵ *Dirupistin a Intenerata* ose *De profundin* - fillim lutjesh në gjuhën latine që përdoren shumë.

andej rrotull, ku të mund të shkonte natën që të mos ngrinte nga të ftohtit, por në atë vend pak kohë më parë kishte ngjarë një luftë dhe çdo gjë ishte shkretuar prandaj, si nuk i zuri syri ndonjë strehë, i shtyrë nga të ftohtit, u drejtua duke ecur me të shpejtë për në Kështjellën Guljelm, duke menduar se po të mund të hynte brenda, Perëndia do t'i jepte ndonjë ndihmë.

Por nata e errët e zuri ndonjë milje larg nga kështjella e, nga ky shkak, kur arriti nën portat e saj, i gjeti të mbyllura, urat të ngritura e kështu, s'mundi të hynte brenda. I hidhëruar dhe i mërzhitur nga kjo gjë, vështronte përreth duke qarë, për të gjetur një vend ku të rrinte që, të paktën, të mos i binte bora sipër. Për fat, pa një shtëpi mbi muret e kështjellës, të dalë pak përjashta dhe nën atë të dalë vendosi të rrinte gjersa të gdhihej. Aty, nën atë të dalë, gjeti një derë të mbyllur, përpara së cilës, shtroi disa kashturina që gjeti nën dhë dhe, i brengosur e i hidhëruar, u struk në to për të shkuar natën, duke u ankuar shpesh kundër shën Julianit dhe duke thënë se ky nuk e meritonte besimin që kishte pasur për të. Por shën Juliani nuk e kishte harruar se, pa vonuar shumë, i përgatiti një bujtje të mirë.

Në këtë kështjellë na ishte një grua e ve, e bukur nga trupi sa s'kish shoqe, të cilën e dashuronte me kohë markezi Aco, që e mbante aty për ta pasur kur ta donte. Kjo grua banonte në atë shtëpi, nën të dalën e së cilës po qëndronte Rinaldi. Në mëngjesin e asaj dite gruas i kishte vajtur markezi ta lajmëronte se atë natë do të flinte me të, dhe e kishte porositur t'i përgatiste një banjë dhe t'i bënte një darkë madhështore. Gruaja i kishte bërë gati të gjitha këto dhe s'priste gjë tjetër, veç ardhjes së markezit por, ndërkohë, markezit i kishte vajtur te porta një shërbëtor, i cili, me lajmet që i solli, e detyroi markezin t'ia shalonte kalit e të shkonte. Kështu, markezi i dërgoi fjalë gruas që të mos e priste. Nga ky shkak gruaja mbeti pak e dëshpëruar dhe, duke mos ditur se ç'të bënte, vendosi të hynte vetë në banjën që kishte përgatitur për markezin dhe pastaj të vente të hante bukë e të flinte. Kështu, ajo hyri në banjë.

Kjo banjë gjendej afër derës ku i gjori Rinald rrinte përjashta. Duke bërë banjë, gruaja dëgjoi të qarët e të dredhurit e Rinaldit, i cili bënte si lejlek. Atëherë, thirri shërbëtoreshën dhe i tha:

- Shko sipër dhe shiko nga dritarja se kush është prapa kësaj dërrë dhe se ç'bën.

Shërbëtoresha vajti dhe, e ndihmuar nga kthjelltësia e natës, e pa të gjorin me këmishë vetëm e zbathur që po dridhej. E pyeti se kush ish, por Rinaldi

dridhej aq tepër sa mezi nxirrte fjalën nga goja. Mezi i tregoi shkurtazi se kush ishte dhe pse ndodhej aty, pastaj zuri t'i lutej dhembshurisht që, po të qe e mundur, të mos e linte aty natën të vdiste nga të ftohtit.

Shërbëtores iu dhimbs, u kthye te zonja dhe ia tha të gjitha. Po ashtu, edhe kësaj i erdhi keq dhe, kur iu kujtua që çelësin e asaj dere e kishte ajo, se ia hapte ngandonjëherë fshehurazi markezit, i tha:

- Shko dhe hapja derën me ngadalë. Këtu darkën e kemi dhe s'ka kush ta hajë, sa për shtresa e mbulesa kemi plot.

Shërbëtorja e lavdëroi shumë sjelljen e njerëzishme të zonjës së saj dhe vajti ia hapi derën dhe e solli brenda. Kur e pa gruaja thuajse të ngrirë, i tha:

- Shpejt, o zot i mirë, futu në atë banjë se është edhe e ngrohtë.

Dhe ai, pa pritur ftesa të tjera, hyri me gjithë këmishë në banjë dhe kur e mori veten mirë nga ngrohtësia e banjës, iu duk sikur kishte vdekur dhe u ngjall. Gruaja i solli rroba nga të shoqit, që kish vdekur ca kohë përpara. Rinaldi i veshi dhe ato i qëndruan aq mirë në trup, sa dukeshin sikur ishin bërë enkas për të. Pastaj, duke pritur ç'urdhër do t'i jepte gruaja, zuri të falënderonte Perëndinë dhe shën Julianin që e kishin shpëtuar nga një natë aq e keqe dhe, me sa dukej, i kishin përgatitur bujtje të mirë.

Pas kësaj, si pushoi pak, gruaja vajti në odën e zjarrit, në të cilën kishte porositur shërbëtoren të bënte një zjarr të madh dhe pyeti për të mjerin udhëtar se ç'po bënte. Shërbëtorja iu përgjigj:

- Zonjë, ai u vesh. Është një burrë i bukur dhe duket njeri bujar dhe i njerëzishëm.

- Shko, - i tha gruaja, - thirre dhe thuaj të vijë këtu ndanë zjarrit e të hajë se e di që është pa ngrënë.

Kur hyri Rinaldi në odën e zjarrit dhe pa gruan që iu duk shumë e mirë, e përshëndeti me përlulesi dhe e falënderoi shumë për të mirat që i kishte bërë. Kur e pa dhe dëgjoi fjalët e tij, gruas iu duk pikërisht ashtu sikundër ia pati përshkruar shërbëtorja. Ajo e priti me gëzim, e uli ndanë zjarrit pranë saj, si njeri të shtëpisë dhe e pyeti se për ç'shkak kishte vajtur e rrinte aty. Rinaldi ia tregoi të gjitha fill e për pe.

Kur kishte vajtur shërbëtori i Rinaldit në kështjellë, gruaja kishte dëgjuar diçka për këtë ngjarje, prandaj i besoi të gjitha sa i tha Rinaldi, i tregoi gjithë ç'dinte për shërbëtorin e tij dhe se qysh mund ta gjente lehtë të nesërmen në mëngjes. Po, si u shtrua tryeza, sipas dëshirës së gruas, Rinaldi lau duart dhe u ul bashkë me të të hanin. Gruaja i nguli sytë shumë herë dhe i pëlqeu fort

dhe, meqenëse e kishte të zgjuar epshin se atë mbrëmje do t'i vinte markezi të shkonte natën me të, i hyri shumë në zemër.

Pas buke, si u ngritën nga tryeza, gruaja pyeti dhe shërbëtoreshen nëse i dukej i mirë edhe asaj Rinaldi, që të përfitonte nga e mira që i kish sjelli fati përpara. Shërbëtorja, që e njihte dëshirën e zonjës, me sa mundi ia ngrohu zemrën. Atëherë gruaja u kthye te zjarri ku kishte lënë vetëm Rinaldin, zuri ta vështronte përmallshëm dhe i tha:

- Rinald, pse rrini kaq i menduar? Nuk besoni se mund të vini prapë në vend një kalë e disa tesha që keni humbur? Bëhuni burrë, jini i gëzuar, jeni këtu, jeni si në shtëpinë tuaj. Doja t'jua thosha më parë se, kur ju pashë veshur me këto rroba që kanë qenë të t'iu shoqi, ndjesë pastë, më shëmbëllyet krejt si ai dhe sonte më ka ardhur mbase njëqind herë dëshira t'ju përqafoja dhe t'ju puthja dhe, sikur të isha e sigurt se s'do t'ju bezdisja, pa fjalë, kisha për ta bërë.

Kur dëgjoi këto fjalë Rinaldi, si njeri i kuptuar që ishte, iu drejtua me duar hapur dhe i tha:

- Zonjë, duke menduar që unë mund të them se jetën e kam vetëm nga ju, se e pashë nga ç'mjerim më hoqët, do të ishte një poshtërsi nga ana ime, po të mos orvatesha të bëja çdo gjë që t'ju pëlqente, prandaj kënaqeni dëshirën tuaj, përqafo mëni e puth mëni, se dhe unë do t'ju përqafoj e do t'ju puth me gjithë shpirt.

Veç këtyre nuk pat nevojë për fjalë të tjera. Gruaja që ishte e ndezur nga dëshira për dashuri, iu hodh menjëherë në prehër dhe pasi e shtrëngoi me epsh dhe pasi u puthën me njëri-tjetrin nja një mijë herë, u ngritën s'andejmi dhe vajtën në dhomë, ku, menjëherë, sa u shtrinë dhe gjer ndaj të gdhirë, përmbushën plotësisht dhe shumë herë dëshirat e tyre.

Kur filloi të shfaqej agimi, sipas dëshirës së gruas, u ngritën nga dysheku. Gruaja i dha disa petka të këqija dhe i mbushi kuletën me të holla, duke iu lutur që të mos ia thoshte njeriu dhe që të mos i shkonte mendja kujt për këtë gjë, i tregoi më parë ç'rrugë duhej të merrte që të gjente shërbëtorin. Pastaj e nxori jashtë nga deriça nga e cila e kishte futur.

Kur u gdhi mirë, duke bërë sikur vinte së largu, Rinaldi hyri në kështjellë nga portat që ishin hapur, gjeti shërbëtorin dhe, kështu, si u vesh me petkat e veta që i kishte në valixhe dhe tek po përgatitej t'ia hipte kalit të shërbëtorit, thaujse për mrekulli të Zotit, qëllloi që të tre hajdutët që e kishin plaçkitur një natë më parë qenë kapur aty pak përpara për një tjetër vjedhje që kishin kryer dhe ishin sjellë në atë kështjellë. Dhe, meqenëse i treguan vetë tërë

hajdutëritë që kishin kryer, Rinaldit iu kthyen prapë kali, petkat dhe të hollat dhe nuk i humbi gjë tjetër veç dy rripa të vegjël, të cilët hajdutët nuk dinin se ç’i kishin bërë.

Rinaldi, duke falënderuar Perëndinë dhe shën Julianin, ia shaloi kalit dhe u kthye shëndosh e mirë në shtëpinë e tij. Të tre hajdutët të nesërmen u vunë në litar.

Dita e dytë, rrëfenja e tretë

Tre vëllezër në moshë të re harxhojnë kot pasurinë e tyre dhe varfërohen. Një nip i tyre, duke u kthyer në shtëpi i dëshpëruar, shoqërohet rrugës me një abat, që pastaj del të jetë e bija e mbretit të Anglisë. Me të martohet dhe me ndihmën e saj i ngre përsëri ungjit në gjendjen e përparshme.

Vajzat i dëgjuan me ëndje aventurat e Rinaldit prej Asti, e lavdëruan devocionin e tij dhe falënderuan Perëndinë dhe Shën Julianin për ndihmën e bukur që i dhanë në një kohë kur kishte pasur nevojë shumë të madhe, por mos mendohet se s’e përmendën gruan. Dhe për këtë thanë, ndonëse fshehurazi me njëra-tjetrën, se nuk qe treguar budallaçkë, se kishte ditur të përfitonte nga e mira që Fuqimadhi Zot i kishte dërguar. Dhe, ndërsa po bisedonin, duke vënë buzën në gaz me dinakëri, mbi natën e mirë që kishte kaluar ajo grua, Pampineja, që kish qëndruar pranë Filostratit, duke e marrë me mend se do t’i binte radha asaj të fliste, sikundër ndodhi me të vërtetë, u përqendrua dhe filloi të mendonte mbi rrëfenjën që do të kallëzonte dhe, kur i dha urdhër mbretëresha, filloi me guxim dhe me gëzim të flasë në këtë mënyrë:

Të dashura shoqet e mia, sa më tepër të flitet për punët e fatit, aq më shumë mbetet për të folur për kë kërkon të zbulojë misteret e tij dhe për këtë gjë s’duhet të çuditet njeri, po qe se bindet se të gjitha gjërat, të cilat ne me mendjehetësinë tonë i pandehim tonat, janë në duart e tij dhe, për pasojë, ai, sipas gjykimit të tij, i bën të kalojnë pareshtur nga njëri te tjetri dhe anasjelltas, pa ndonjë rregull të njohur prej nesh. Sado që kjo që thashë shihet plotësisht në çdo gjë dhe çdo ditë dhe, sado që është provuar me disa nga rrëfenjat e mëparshme, megjithëkëtë, duke qenë se mbretëreshës sonë i pëlqen të flasim mbi një temë të tillë, do të shtoj edhe unë një rrëfim si ato që janë kallëzuar, i cili besoj ka për t’ju pëlqyer dhe do t’ju shërbejë.

Ka qenë njëherë në qytetin tonë një kalorës, i quajtur zoti Tebald, për të cilin disa thoshin se ishte nga familja e Lambertëve e disa të tjerë ngulnin këmbë se ishte nga Agolantët, ndofta, duke u mbështetur më shumë se në çdo gjë tjetër në mjeshtërinë që kanë pasur bijtë e tyre dhe që është e njëjtë me atë që kanë edhe sot e gjithë ditën Agolantët. Tani, duke lënë mënjanë se nga cila prej të dyja familjeve rridhte, ai ishte një kalorës shumë i pasur që pati tre bij të bukur e të hijshëm, prej të cilëve i pari quhej Lambert, i dyti Tedald dhe i treti Agolant, të tre të pashëm e të sjellshëm. Por, pa mbushur më i madhi tetëmbëdhjetë vjeç, z. Tebald vdiq dhe tërë pasurinë e tij, të tundshme e të patundshme, ua la bijve si trashëgimtarë të ligjshëm që ishin.

Këta, si panë që u bënë mjaft të pasur si nga paratë, ashtu dhe nga tokat, nuk menduan gjë tjetër, veç dëfrimeve dhe zunë të harxhonin pa menduar e pa kursyer, duke mbajtur një numër të madh shërbëtoresh, kuajsh të shumtë e të bukur, qenë e zogj, gostitë i kishin të pashqitura, ishin dorë hapur dhe bënë udhëtime. S' u mjaftonte të bënin vetëm sende që u kanë hije bujarëve, por, si të rinj që ishin, të shtyrë nga dëshira djalërie, binin dhe në gabime. Por, një të tillë rrojtje nuk mundën ta vijonin për shumë kohë, se thesari që u kish lënë i ati u pakësua dhe, meqenëse nuk u mjaftonin të ardhurat për t'iu bërë ballë shpenzimeve të tepruara që kishin nisur, filluan të shitnin dhe të vinin peng edhe pronat kur, pasi i shitnin një pjesë sot e një pjesë nesër, kuptuan që kishin mbetur me gisht në gojë dhe sytë që ua kishte mbyllur pasuria, ua hapi varfëria.

Nga ky shkak, Lamberti një ditë thirri të dy vëllezërit dhe u tha se si kishte qenë gjendja ekonomike e shkëlqyer e t'et dhe sa kishte rënë poshtë ajo e tyrja, se si kishte qenë pasuria e tyre dhe ku e kishin çuar vetë me shpenzimet e tyre të kota. Ai i këshilloi, me sa i erdhi përdore që, para se t' u shtohet më tepër fatkeqësia, të shitnin atë pak mall që u kishte mbetur dhe të merrnin sytë e të iknin. Kështu bënë. Pa i lënë njeriut shëndetin e pa bujë, dolën nga Firencja dhe, pa ndalur, shkuan për në Angli, ku në Londër zunë një shtëpi të vogël, shpenzimet i pakësuan fare dhe zunë me kujdes të jepnin pará me kamatë. Fati iu ndihua kaq shumë në këtë punë, sa që në pak vite iu mbeti si fitim një shumë e madhe të hollash.

Kështu, duke u kthyer herë pas here njëri pas tjetrit në Firence, me të hollat e fituara blenë një pjesë të madhe të tokave të tyre dhe u martuan por, duke qenë se vijonin të huanin në Angli, dërguan aty nipin e tyre, të quajtur Aleksandër, që t'ua këqyrte punët. Ata në Firence, meqë e kishin harruar mjerimin ku i kishin shtyrë shpenzimet e tepërta herën e parë, ndonëse të

gjithë u bënë me fëmijë, prapë kishin zënë të harxhonin fare pa mend, dhe çdo tregtar u besonte, pa u ndrojtur fare e u jepte hua shuma të mëdha të hollash që u kërkonin. Këto shpenzime i përballuan për disa vjet me të hollat që u dërgonte Aleksandri, i cili huante ndër banorë, duke marrë si garanci kështjellat e tyre dhe të tjera të ardhura, prej të cilave i mbetej një fitim mjaft i madh.

Të tre vëllezërit, duke pasur shpresë të patundur në Angli, vazhduan të harxhonin paratë pa menduar. Mirëpo, asokohe, në Angli plasi papandehur një luftë midis mbretit dhe të birit, luftë që shkaktoi të ndahej në dy pjesë i tërë ishulli: njëra pjesë anonte për njërin e tjetra për tjetrin. Nga ky shkak Aleksandrit iu morën të gjitha kështjellat e baronëve, dhe nuk i mbeti asnjë e ardhur tjetër. Ai, duke pasur shprese nga dita në ditë se mbreti do të pajtohej me të birin dhe do t'i kthehej prapë çdo gjë që i qe marrë, nuk u largua nga ishulli. Të tre vëllezërit që gjendeshin në Firence, nuk i pakësonin shpenzimet e tyre të tepruara, dhe përditë e më tepër ngarkoheshin në borxhe.

Por, pasi shkuan disa vite dhe shpresa e tyre u doli huq, të tre vëllezërit jo vetëm që s'i besonte më njeri, por meqenëse duheshin paguar huadhënësit, u kapën menjëherë dhe u burgosën. Duke qenë se pasuria e tyre nuk mjaftonte për të paguar huat, për atë që u mbeti për të paguar i lanë në burg. Nga gratë dhe fëmijët e tyre të vegjël, ca vajtën në fshat dhe ca tej e tëhu të rreckosur, duke mos pritur veç jetë të mjerueshme për sa të qenë gjallë.

Aleksandri që kishte pritur vite me radhë në Angli të bëhej ndonjë gjë, si pa që paqja s'bëhej, se aty e kishte veten në rrezik dhe që qëndrimi i tij qe i kotë, vendosi të kthehej në Itali dhe u vu në udhëtim fill vetëm. Për fat, duke dalë nga Bruzhi, pa që dilte s'andejmi dhe një abat bardhosh, i shoqëruar prej shumë murgjish, prej plot shërbëtorësh dhe kuajsh, të ngarkuar me plaçka, pas tij vinin dy kalorës të moshuar dhe kushërinj të mbretit. Aleksandri, sikurse t'i kish njohur, iu afrua këtyre dhe këta e pranuan të udhëtonte së bashku me ta.

Duke ecur me ta bashkë, Aleksandri i pyeti me ëmbëlsi kalorësit se kush ishin ata murgj me kaq shërbëtorë kaluar përpara dhe ku venin.

- Ai që shkon kaluar në ballë, - iu përgjigj njëri prej kalorësve, - është një kushëri ynë, i zgjedhur tani afër abat i një prej më të mëdhenjve manastire të Anglisë por, pasi është tepër i ri dhe ligji e ndalon për të marrë një të tillë shkallë, vemi ne bashkë me të në Romë t'i lutemi Atit të Shenjtë që t'ia falë të qenët tepër i vogël nga mosha dhe ta vendosë në detyrën që i është caktuar. Por mos ia tregoni njeriut këtë që ju thashë.

Duke kaluar abati i ri herë përpara e herë prapa shërbëtorëve të tij, si shohim shpeshherë të qëllorë në udhëtime me zotërinj, takoi të shohë rrugës afër tij Aleksandrin, që ishte mjaft i ri, me shtat e me fytyrë të derdhur, i arsyeshëm, tërheqës dhe me sjellje më të mira nga të gjithë. E pa, i hyri në sy sakaqherë, dhe ndjeu në shpirt një kënaqësi që s'e kish ndier ndonjëherë nga ndonjë tjetër gjë dhe, si i foli, filloi të fjalosej me të me ëmbëlsi dhe ta pyeste se kush ishte, nga vinte dhe ku po shkonte. Aleksandri ia hapi lirisht zemrën dhe iu përgjigj të gjitha pyetjeve që i bëri, pastaj i dha fjalën se ishte gati të bënte për të çdo gjë që të dëshironte, me gjithë fuqinë e tij të paktë.

Abati, kur dëgjoi bisedimin e tij të bukur dhe të matur dhe veçanërisht kur pa sjelljet e tij, mendoi me vete se do të ishte bujar dhe, sado që puna e tij kishte qenë e neveritshme, i hyri në zemër, iu dhimbs për fatkeqësitë e tij dhe e ngushëlloi me një mënyrë shumë miqësore. I tha të mos humbiste shpresën, pasi po të ishte i zoti, Perëndia kishte për ta vënë prapë aty prej nga e kish rrëzuar fati, në mos dhe më lart; iu lut që, meqenëse po shkonte në Toskanë, të udhëtonin së bashku, pasi edhe ai për atje qe nisur. Aleksandri e falënderoi për ngushëllimin dhe i tha se ish gati për çdo urdhër që t'i jepte.

Duke ecur, abati, i cili ndiente dëshira të reja në zemër qëkurse pa Aleksandrin, pas shumë ditësh udhëtimi arriti në një qytet, i cili nuk kish bujtina të mira. Abati deshi të zinte vend në një nga këto bujtina, por Aleksandri e ndaloi në shtëpinë e një bujtari që e kishte të njohur dhe ia përgatiti dhomën në vendin më të mirë të shtëpisë. Si u bë thuajse kujdestar i abatit, si njeri mjaft i dhënë ndër të tilla punë, me sa mundi, ia rregulloi gjithë shërbëtorët e tij nëpër qytet: kë atje e kë këtu. Pastaj, pasi abati hëngri darkën dhe shkoi një pjesë e natës, kur të gjithë vajtën të flinin, Aleksandri pyeti bujtarin se ku do të flinte vetë.

- Të them të drejtën, i tha bujtari, nuk e di, ti e sheh se të gjitha vendet janë zëna, dhe mund të më shikosh dhe mua me gjithë familjen që do të fle mbi frone. Megjithëkëtë, në odën e abatit, janë disa hambarë, në të cilat mund të të shpie. Aty do të të vë dhe ndonjë shtrat të vogël dhe, në të pëlqeftë, shkoje si ta shkosh natën aty.

- Qysh do të vete unë në dhomën e abatit? - tha Aleksandri, - ti e di që ajo është e vogël dhe nga ngushtësia s'mund të flinte as ndonjë nga murgjit e tjerë. Sikur ta dija këtë gjë kur shtruat, do të kisha vënë të flinin aty murgjit mbi hambarë dhe vetë do të flija ku flenë murgjit.

- S'ke ç'bën, - ia bëri bujtari, - tani, po të duash, mund të rrih këtu fare mirë, abati fle dhe perdet i ka të mbyllura. Mbulesat i ke përpara, të vë me ngadalë dhe një shilte të vogël dhe fli.

Aleksandri, si pa që këtë mund ta bënte pa i dhënë ndonjë shqetësim abatit, shtroi shtresat e fjetjes dhe qetë-qetë u mbështet.

Abati, të cilit jo vetëm nuk i hynte gjumë në sy, por i shkonin nëpër mend edhe dëshirat e reja, i dëgjoi fjalët e bujtarit e të Aleksandrit dhe kishte marrë vesh edhe se ku do të shtrihej të flinte Aleksandri, gjë që e kënaqi tepër dhe zuri të thoshte me vete: "Perëndia u dha rast dëshirave të mia, dhe në qoftë se nuk do të përfitoj nga rasti, një fat i tillë s'ka për të më takuar për shumë kohë". Dhe, si e mblodhi mendjen që të përfitonte, kur pa se në bujtinë asgjë nuk pipëtinte, thirri Aleksandrin me zë të ulët dhe e ftoi të binte të flinte me të. Aleksandri, pas shumë kundërshtimesh, u zhvesh dhe vajti e ra. Abati atëherë i hodhi dorën mbi kraharor, dhe zuri ta prekte, ashtu sikundër bëjnë të rejat e dashuruara me të dashurit e tyre. Aleksandri mbeti tepër i habitur dhe dyshoi se mos abati ishte i shtyrë nga ndonjë dëshirë e turpshme që ta prekte në të tillë mënyrë. Abati e mori me mend habinë e Aleksandrit nga gjestet që bëri, vuri buzën në gaz, nxori me të shpejtë këmishën nga trupi, mori dorën e Aleksandrit dhe e vuri mbi kraharorin e tij, duke thënë:

- Aleksandër, largoje mendimin tënd prej budallai dhe kërko të gjesh se ç'kam fshehur këtu.

Aleksandri hodhi dorën në kraharor të abatit dhe gjeti dy cicëza rrumbullake, të forta e delikate, si prej fildishti. Me të gjetur këto, e njohu menjëherë që ishte femër dhe papritur që ta ftonte, me të shpejtë e përqafoi dhe deshi ta puthte, kur ajo i tha:

- Para se të më afroresh më shumë, prit të të them një fjalë. Sikundër më sheh, unë jam femër dhe jo mashkull, ika e virgjër prej shtëpisë sime dhe po shkoja te Papa që të më martojë. Ndofta për fatin e mirë tëndin, apo për fatin e keq timin, kur të pashë pardje, kaq u rrëmbeva prej teje nga dashuria, sa s'besoj t'i ketë ndodhur gruaja tjetër që të ketë dashuruar ndonjë burrë. Në qoftë se s'më do për grua, largohu së këtejmi sa më shpejt dhe shko te vendi yt.

Ndonëse nuk e njihte, Aleksandri, duke pasur parasysh turmën e madhe që e shoqëronte, tha me vete se kjo do ish ndonjë vajzë bujare dhe e pasur, këtë gjë e dëshmonte dhe bukuria e saj e rrallë. Prandaj, pa u menduar shumë, iu përgjigj se, po t'ia kish ënda asaj, ai ishte fort i kënaqur. Ajo atëherë u ngrit dhe qëndroi mbi shtrat përpara një pikturë të Gynjotit për Perëndinë, i vuri

në gisht një unazë si shenjë kurorëzimi, pastaj u përqaftuan së bashku dhe u dëfryen tërë pjesën e natës që kish mbetur me kënaqësi të madhe të të dyja palëve. Pastaj, si u morën vesh ndërmjet tyre se ç'duhej të bënin, porsa u gdhi, Aleksandri u ngrit dhe doli jashtë nga ai vend prej të cilit kishte hyrë. Kurrkush nuk e mori vesh se ku e kishte shkuar natën. I gëzuar pamasë, u vu në udhëtim me abatin dhe me shokët e tij, dhe pas disa ditësh arritën në Romë. Aty, si qëndruan ca ditë, abati me dy kalorësit dhe me Aleksandrin bashkë, papritur më, vajtën te Papa dhe pasi i bënë nderimet e zakonshme, abati filloi të fliste:

- At i shenjtë, sikundër duhet ta dini më mirë nga të gjithë, kushdo që dëshiron të jetojë mirë dhe me nder me sa t'i vijë doresh, ka për detyrë të thyejë çdo pengesë që mund ta detyrojë të ndryshojë drejtimin e jetës, edhe unë, meqenëse dëshiroj të jetoj me nder, e pata përmbushur si duhet këtë detyrë. Sikundër më shihni, me petka prej fetari, pasi ika fshehurazi, u vura në udhëtim me një pjesë të madhe të thesarit të tim ati, mbretit të Anglisë, për të ardhur këtu, me qëllim që të më martojë Shenjtëria juaj, pasi im atë, kundër dëshirës sime desh të më jepte te mbreti i Skocisë, që është një burrë shumë i vjetër, ndërsa unë, siç më shihni jam vajzë e re. Dhe mos pandehni se ika se pata frikë nga pleqëria e mbretit të Skocisë, jo, por më shumë u frikësova se, po të merrja atë për burrë, duke qenë unë vajzë e re, mund të më ngjante ndonjë fatkeqësi në kundërshtim me ligjet e Perëndisë dhe me nderin e gjakut mbretëror të tim ati.

- Dhe, duke ardhur me këtë qëllim, Perëndia që i njeh fort mirë nevojat e secilit, besoj se për mëshirë të tij, më solli përpara syve atë që i pëlqeu të ishte burri im, dhe ai është ky djaloshi (dhe i tregon Aleksandrin) që po shihni afër meje, sjelljet dhe trimëria e të cilit e bëjnë të denjë për çdo zonjë të madhe, megjithëqë, mbase, fisnikëria e gjakut të tij nuk është aq e lartë sa fisnikëria e derës mbretërore. Këtë, pra, kam marrë dhe këtë dua, dhe kurrë s'do të pranoj ndonjë tjetër, sido që ta gjykojë im atë a ndonjë tjetër. Prandaj qëllimin kryesor për të cilin u vura në udhëtim e kam plotësuar, por prapë më pëlqen ta mbaroj udhëtimin, si për të vizituar vendet e shenjta dhe të adhurueshme, që janë me shumicë në këtë qytet dhe Shenjtërinë tuaj, kështu që përpara jush kontrata e martesës midis meje dhe Aleksandrit, në prani vetëm të Zotit, të mund të shpallet publikisht. Prandaj ju lutem përulësisht që atë që deshi Perëndia dhe unë, ta pëlqeni dhe ju dhe të na jepni bekimin, që me të, të jemi të sigurt për një vepër të pëlqyer nga Ai, përfaqësuesi i të cilit jeni ju këtu në tokë, që të mundim së

bashku, të rrojmë shumë e së fundi të vdesim me nderin e Perëndisë dhe tuajin.

Aleksandri mbeti pa mend kur dëgjoji se e shoqja ishte e bij e mbretit të Anglisë dhe i gufoi zemra nga një gëzim i fshehur, por më shumë u çuditën dy kalorësit, të cilët u tronditën aq shumë saqë, sikur të mos kishin qenë përpara Papës, do t'i kishin bërë ndonjë poshtërim Aleksandrit e, ndofta, edhe gruas. Nga ana tjetër, Papa u habit shumë si prej veshjes së gruas, ashtu dhe prej zgjedhjes që kishte bërë, por, duke ditur se s'mund t'i kthente praptazi punët, vendosi t'ua plotësonte kërkesën. Së pari, qetësoi kalorësit, që i pa të nervozuar dhe i pajtoi me gruan e me Aleksandrin dhe pastaj dha urdhër për gjithçka duhej bërë.

Në ditën e caktuar, Papa, në një festë të madhe, që kishte përgatitur vetë, ftoi përpara gjithë kardinalëve dhe shumë njerëzve fisnikë dhe të shquar, gruan, e cila qe veshur si mbretëreshë dhe dukej kaq e bukur dhe kaq e këndshme, sa të gjithë e lavdëruan ashtu siç e meritonte e, po kështu edhe Aleksandrin, të veshur me petka të shndritshme, që, prej pamjes dhe prej sjelljes, nuk dukej si një që kishte pasur për detyrë të huante të holla me kamatë, por si një djalë prej dere mbretërore, të shoqëruar prej dy kalorësve. Pastaj pasi i kurorëzoi me madhështi të dy dhe, si mori fund ceremonia e bukur dhe e shkëlqyer e martesës, Papa u dha bekimin dhe i lejoi të shkonin.

Aleksandrit, sikundër edhe gruas, u pëlqeu të linin Romën dhe të venin në Firence, ku ishte përhapur që me kohë ky lajm. Atje u pritën me nderime të mëdha nga ana e qytetarëve. Nusja, pasi ua shleu dënimin me të holla të gjithëve, i liroi të tre vëllezërit nga burgu dhe, së bashku me gratë e tyre, i vendosi përsëri në pronat e tyre. Pastaj, me uratën e të gjithëve, Aleksandri bashkë me të shoqen, u nis nga Firencja, duke marrë me vete edhe Agolantin e vajtën në Paris, ku u pritën me nderime nga ana e mbretit.

Pastaj të dy kalorësit vajtën në Angli dhe u sollën në të tillë mënyre me mbretin, saqë ky i fali dhe me brohori të madhe priti vajzën dhe dhëndrin e tij, të cilët pak më pas me nderime të mëdha i bëri kalorës dhe u dhuroi kontenë e Kornuollit. Aleksandri ishte kaq i zoti dhe u përpoq kaq shumë, saqë e pajtoi birin me t'anë, punë e cila solli lumturinë në ishull, dhe ai vetë fitoi dashurinë dhe adhurimin e vendasve. Agolanti i mblodhi të gjitha të holla që kishte dhënë me kamatë dhe i begatë sa s'thuhet, u kthye në Firence. Ai mori titullin kalorës nga konti Aleksandër. Konti shkoi me gruan e tij

jetë të lumtur dhe, sikundër duan të thonë disa, me mendjen dhe trimërinë e tij dhe me ndihmën e vetë mbretit pushtoi pastaj Skocinë dhe u kurorëzua mbret i saj.

Dita e dytë, rrëfenja e katërt

Landolf Rufoli varfërohet, bëhet pirat dhe kapet prej një anijeje gjenoveze. Anija fundoset dhe ai, duke u mbajtur pas një arke që ishte plot me sende të çmuara, shpëton dhe del në Korfuz, ku e pret një grua dhe pastaj kthehet në shtëpi i pasur.

Laureta, që qe ulur në krah të Pampinesë, kur kjo arriti në mbarimin e lavdishëm të rrëfenjës së saj, filloi të fliste:

Fort të hijshme shoqe, pas mendimit tim, s'ka veprim më të çuditshëm se sa të na paraqesë në gjendje të lartë mbretërore një njeri, të cilin pak më parë fati e kishte përplasur në mjerimin më të zi, ashtu sikurse pamë që i ngjau protagonistit të rrëfenjës së Pampinesë. Ky është kulmi i mrekullive të fatit dhe, po të mos isha e detyruar t'i përmbahesha temës së caktuar, do të druhesha të flitja prapë mbi një çështje të tillë. Megjithëkëtë, do t'ju kallëzoj edhe unë një rrëfenjë e cila, sado që nuk përmban një përfundim aq të shkëlqyer si ai që pamë, prapë është prekëse, sepse përmban mjerime të mëdha. E di fort mirë se kujtimi i së parës, nuk do t'ju lejë ta dëgjoni me interes rrëfenjën time, por, meqenëse s'mund të bëj ndryshe, besoj se do të më falni.

Besohet se bregdeti nga Rexhio në Gaeta është pjesa më e bukur e Italisë. Këtu, në afërsi të Salernos, gjendet një rrip toke përmbi det me plot qyteza, me kopshte e me kroje që vendasit e quajnë Bregdeti i Amalfit. Banorët e këtij vendi janë të begatë dhe merren me tregti si gjithë banorët e çdo qendre tjetër të zhvilluar. Midis qyteteve të përmendura, është një i quajtur Ravello, në të cilin gjenden edhe sot njerëz të pasur. Këtu ka jetuar dikur një burrë shumë i pasur, Landolf Rufoli, i cili, duke mos qenë i kënaqur nga pasuria që kishte dhe duke dashur ta dyfishonte, për pak humbi, me gjithë të, edhe kokën.

Ky pra, sipas zakonit të tregtarëve, pas një llogarie që bëri, me paret e veta, bleu një karavelë shumë të madhe, e ngarkoi me plaçka të ndryshme për tregti e me të u nis për në Qipro. Mirëpo aty na gjeti shumë karavela

të tjera që kishin sjellë të njëjtat plaçka që kishte sjellë edhe ai dhe nga ky shkak, iu desh jo vetëm t'i shiste plaçkat e tij për një copë bukë por, që të mbaronte punë shpejt, iu desh të hidhte poshtë një pjesë të tyre. Kështu iu afrua greminës.

Kjo fatkeqësi e dëshpëroi shumë, kishte rënë në mendime dhe s'dinte ç'të bënte. Nga një njeri shumë i pasur që kishte qenë, brenda një kohe fare të shkurtër tashti e shihte veten shumë të varfër. E vetmja gjë që mund të bënte ishte ose t'ia hiqte vetes, ose të vidhte për të vënë në vend humbjet që kish pësuar dhe të mos kthehej i vobektë në vendin nga i cili kishte ikur. Dhe, si gjeti blerës për karavelën e tij të madhe, me të hollat që mori prej saj dhe me ato që kishte siguruar nga të shiturit e pak plaçke, bleu një anije të hollë kusarie, të cilën e armatosi mirë e mirë dhe e mbushi me gjithë ç'i duheshin një kusari. Me të u lëshua të plaçkiste kë të mundte dhe sidomos turqit. Në kusari fati i punoi ndryshe nga sa i kishte punuar në tregti.

Në një vit e sipër, plaçkiti dhe hodhi në dorë kaq shumë anije të turqve, sa jo vetëm e vuri prapë në vend atë që i kishte humbur në tregti, por dhe e shtoi pamasë. Tani, si e pa veten mjaft të pasur, meqë pësimi i qe bërë mësim, për të mos rënë edhe herën e dytë në grackë, i tha vetes se ajo që kishte i mjaftonte e nuk donte më, prandaj i dha fund të kthehej në shtëpi dhe, i trembur nga tregtia, nuk desh i rrezikonte të hollat më me atë punë, por me anijen me të cilën i kishte fituar lëshoi lopatat në ujë dhe u nis për t'u kthyer në vendin e vet. Si arriti në arkipelag, në mbrëmje u ngrit një erë e jugut që jo vetëm e godiste në ballë anijen dhe e pengonte të voziste, por fryu dhe detin aq, sa anija e tij e vogël s'do t'i bënte dot ballë. Për këtë arsye hyri në një gji deti që hapej në një ishull të vogël dhe që ishte i mbrojtur nga era. Këtu mendoi të priste gjersa të qetësohej moti. Pas pak kohe, në këtë gji arritën me mundim të madh prej Stambollit dhe dy anije të mëdha tregtare norvegjeze, për të shpëtuar nga furtuna, ashtu si dhe anija e Landolfit.

Njerëzit e këtyre anijeve e panë anijen e vogël dhe i mbyllën shtegun për të mos mundur të largohej dhe, kur mësuuan se e kujt ishte, duke ditur se Landolfi ishte njeri shumë i pasur, ata, si njerëz prej natyre lakmues paraje dhe grabitqarë, vendosën ta shtrëngonin t'u dorëzohej. Zbritën në tokë disa prej njerëzve të tyre të armatosur mirë me harqe dhe i zunë pritë në një vend nga i cili të qëllonin me shigjeta në rast se do të përpiqej njeri të dilte nga anijeza e Landolfit. Të tjerët me varkëza dhe të ndihmuar nga deti, iu afruan anijes së tij dhe me fare pak mundim, në pak kohë, pa pësuar asnjë humbje, e shtinë në dorë anijen me të gjithë njerëzit. Si i morën gjitha ç'kishte dhe e lanë me një

xhaketë të vjetër, ia fundosën anijen dhe atë e hipën në një nga anijet e tyre.

Të nesërmen, si u ndërrua era, anijet tregtare hapën pëlhurat dhe morën drejt perëndimit. Tërë atë ditë udhëtuan pa hasur asnjë pengesë, po aty nga mbrëmja u ngrit përsëri një erë e marrë, e cila e trazoi shumë detin dhe i largoi të dyja anijet njëra nga tjetra. Nga rreptësia e kësaj furtune qëllloi që anija ku ndodhej fatkeqi dhe i mjeri Landolf, u vërvit me rrëmbim shumë të madh në një zallishte në ishullin e Qefalonisë, u ça dhe u thërrmua e tëra si ndonjë qelq i përpjekur në mur. Deti u mbush me plaçka tregtie, me arka e me dërrasa që vinin rreth mbi ujë, si qëllon në të tilla raste. Të mjerët dhe fatkëqijtë që ndodheshin në këtë anije, në mes të errësirës së madhe të natës, në detin e egërsuar dhe të fryrë, duke notuar ata që dinin, zunë të kapeshin prej gjërave që u dilnin përpara.

Midis këtyre, Landolfi, i cili një ditë më parë e pati thirrur vdekjen shumë herë, se donte më mirë t'i priste Perëndia ditën, sesa të kthehej në shtëpi i varfër, sikundër ishte katandisur, u frikësua kur e pa vdekjen pranë dhe posa i erdhi përdore një dërrasë, si dhe të tjerët, iu kap asaj, për të mos u mbytur shpejt dhe për të parë se mos i sillte ndonjë ndihmë Zoti që ta shpëtonte. Hipur mbi këtë dërrasë, u mbajt me sa mundi, i shtyrë prej valëve herë nga njëra anë e herë nga tjetra, gjersa u gdhi dita. Kur zbardhi mirë, hodhi sytë rreth e rrotull dhe s'pa gjë tjetër, veçse re, det dhe një arkë që, duke notuar mbi valët e detit, i avitej ngandonjëherë, duke i kallur tmerrin në zemër. Trembej se mos ajo arkë e godiste dhe pësonte ndonjë tjetër hall dhe, sado herë që i afrohej, me fuqi të prera si ç'ishte, përpiquej ta largonte me dorë.

Por, me gjithë këto që ndodhën, qëllloi të përhapej befas në qiell një erë e fortë, e cila e shtyu arkën me rrëmbim të tmerrshëm dhe e vërtiti mbi dërrasën në të cilën mbahej Landolfi. Ai u fundos nën valë, por doli prapë me not përsipër, i ndihmuar më tepër nga frika sesa nga fuqia. Dërrasa iu largua shumë dhe, duke pasur frikë se mos nuk e arrinte, iu afrua arkës që kishte fare pranë, mbështeti kraharorin mbi kapakun e saj dhe po përpiquej ta mbante drejt me duar. Kështu, i hedhur prej detit herë këndeje e herë andej, i pangrënë, meqë s'kishte ç'të hante dhe i ngopur me ujë deti sa mend po i pëlcoiste barku, pa ditur se ku gjendej dhe pa i zënë tjetër syri veçse det, qëndroi tërë atë ditë dhe natën e ardhshme.

Të nesërmen, i bërë thuajse si sfungjer, duke mbajtur fort me të dyja duart anët e arkës, ashtu siç bën njeriu me ndonjë gjë kur është duke u mbytur, ose mëshira e Perëndisë, ose fuqia e erës, e ndihmoi të arrinte në bregun e detit

të ishullit të Korfuzit, ku, për fat, një grua e varfër lante e shkëlqente me rërë e me ujë të kripur enët e saj. Ajo, kur e pa që po i afrohej, duke mos e shquar mirë se ç'qe, u tremb dhe u praps duke ulëritur.

Ai s'mund të fliste dhe s'shifte mirë, prandaj s'bëri zë, por kur deti e shtyu afër tokës, ajo njohu trajtën e arkës, e vërejtë me kujdes dhe, së pari, shqoi krahët të nderura mbi arkë, pastaj pa fytyrën dhe mori me mend se ç'mund të ishte. Kjo pamje e mallëngjeu dhe hyri në det, që tani ishte i qetë, e kapi të mjerin prej flokësh dhe e tërhoqi në anë bashkë me arkën. Pastaj, ia shqiti me mundim duart prej arkës, të cilën ia vuri mbi kokë një vajze që kishte me vete për ta shpurë në shtëpi. Atë e mori vetë si ndonjë foshnje të vogël dhe, si e nxori në tokë, e futi në një banjë të ngrohtë dhe e lau dhe e fërkoj kaq shumë, saqë atij iu kthye nxehtësia e bjerrë dhe pak a shumë fuqia e humbur. Kur pa pastaj se s'ishte më nevojë, e nxori s'andejmi dhe e pruri në vete me ca verëra të mira e me ca ëmbëlsira. E mbajti ca ditë mirë me sa mudi, gjersa mori veten dhe kuptoi se ku gjendej. Atëherë gruaja zemërbardhë mendoi se i duhej kthyer arka dhe i duhej thënë të vente në punën e tij. Kështu bëri.

Landolfi, që s'e mbante mend fare arkën, e mori kur ia dha gruaja e mirë se mendoi që mund të vlente aq sa të jetonte për disa ditë, por kur pa se ishte shumë e lehtë, e humbi fare shpresën. Megjithëkëtë, në mungesë të gruas zemërbardhë, e zbërtheu të shifte ç'kishte brenda dhe gjeti në të shumë gurë të çmuar të lidhur e të pa lidhur të cilët i njihte pak a shumë. Kur i pa dhe njohu vlerën e madhe të tyre, ndjeu një ngushëllim të patregueshëm dhe lëvdoi Perëndinë që s'kishte dashur ta braktiste. Por, meqenëse në një kohë fare të shkurtër fati e kish goditur tmerrsisht dy herë, duke pasur frikë nga e treta, mendoi se duhej të tregonte kujdes të madh për t'i shpurë këto gjëra gjer në shtëpi. Kështu, i mbështolli ato me sa mudi me disa lecka dhe i tha gruas zemërbardhë se s'kishte më nevojë për arkën. "Po të duash, - i tha, - mbaje për vete dhe në vend të saj më jep një torbë."

Gruaja e mirë ia dha menjëherë torbën që i kërkoi dhe ai, si e falënderoi nga zemra për mirësinë që i kishte bërë, hodhi torbën në krah dhe shkoi. Pastaj hipi në një varkë dhe u drejtua për në Brindisi. S'andejmi, duke marrë anën e detit, arriti gjer në Trani, ku gjeti disa bashkëqytetarë të tij pëlhurëpunues. Atyre u erdhi keq dhe e veshën kur dëgjuan nga goja e tij, përveç arkës që s'e zuri në gojë, gjithë fatkeqësitë që i kishin ngjarë. Veç kësaj, i huajtën një kalë, i dhanë shokë dhe e përcollën gjer në Ravello, ku do të vente.

Këtu, si pa që ishte i sigurt, duke falënderuar Perëndinë që e kish sjellë shëndoshë e mirë, zgjidhi torbën dhe, si i pa të gjitha gjërat më me kujdes

se më parë, kuptoi se kishte kaq shumë të tillë gurë që, sikur t'i shiste me çmim të arsyeshëm, ose dhe më të ulët, bëhej dy herë më i pasur se sa kishte qenë kur ishte nisur për tregti. Kur gjeti mënyrën t'i shiste gurët, dërgoi gjer në Korfuz një shumë të mirë parash për të shpërblyer, për të mirat që i bëri, gruan zemërbardhë, e cila e kishte nxjerrë nga deti. Kështu bëri edhe në Trani me ata që i kishin dhënë petkat. Ato që i mbetën, i mbajti për vete dhe, pa dashur të merrej më me tregti, jetoi si zot i madh për pjesën tjetër të jetës.

Dita e dytë, rrëfenja e pestë

Andreuçi nga Peruxhia shkon në Napoli për të blerë kuaj. Aty, brenda një nate, shpëton nga tri fatkeqësi dhe kthehet në shtëpi me një rubin.

Gurët e çmuar që gjeti Landolfi, filloi Fjameta, që kishte radhën e rrëfenjës, më sjellin ndër mend një ngjarje që përmban po aq rreziqe, sa dëgjuam prej Lauretës. Ndryshimi është vetëm ngase, ndërsa veprimi i rrëfenjës së parë zgjatet për disa vjet, këtu merr fund brenda një nate të vetme, sikundër do ta shihni.

Me sa kam dëgjuar, në Peruxhia ka qenë dikur një djalosh, xhambaz kuajsh, i quajtur Andreuçi i Pjetrit, i cili, si kishte dëgjuar se në Napoli kuajt hiqeshin të lirë, vuri në kuletë pesëqind florinsa ari dhe, duke dalë për herë të parë nga shtëpia, bashkë me disa tregtarë të tjerë, u nis për në atë qytet, ku arriti një të diel në muzg. Që atë natë kërkoi informata nga i zoti i bujtinës dhe të nesërmen në mëngjes doli në treg, ku pa shumë kuaj që i pëlqyen së tepërmi dhe hyri në pazarllëqe. Meqenëse nuk ra në ujdi me asnjë, si i trashë dhe mendjelehtë që ishte, për të treguar se kishte qëllim të blinte vërtet, nxori shumë herë në sy të njerëzve që venin e vinin, kuletën e tij me florinsa.

Në këto pazarllëqe e sipër, tek po nxirrte kuletën, na i shkoi afër, pa e vënë re, një e re siciliane shumë e bukur, por e gatshme t'ia kënaqte dëshirën çdo burri me fare pak pará. Ajo, sapo i pa kuletën, tha me vete:

- Sa e lumtur do të isha, sikur të ishin të miat ato të holla, - dhe bëri tutje.

E reja ishte me një plakë, edhe kjo siciliane, e cila, sapo e pa Andreuçin, iu turr me mall ta përqafonte. Kur e reja pa këtë gjë, pa bërë zë, mbajti këmbët dhe e priti mënjandë. Andreuçi u kthye nga plaka, e njohu dhe e përshëndeti me gëzim të madh. Plaka i dha fjalën se do të vente ta vizitonte në bujtinë dhe iku pa e zgjatur shumë. Andreuçi u kthye prapë në treg, por atë mëngjes nuk bleu gjë.

E reja, e cila më parë i kishte parë kuletën dhe pastaj kishte parë miqësinë që kishte plaka me të, me qëllim që të bënte një provë se mos mundej t'i hidhte në dorë ato pará, zuri ta pyeste plakën me kujdes se kush dhe prej nga ishte ai, ç'punë bënte dhe ku e njihte. Plaka i tregoi fill e për pe për gjendjen e Andreuçit, ashtu siç mund t'ia tregonte ai vetë, meqenëse plaka kishte qenë për një kohë të gjatë me t'anë e tij në Sicili dhe pastaj në Peruxhia. Ajo i tregoi dhe se ku banonte dhe përse kishte ardhur.

Gruaja e re, si mori lajme të plota mbi farefisnin e tij dhe mbi emrat e tyre, për t'i dalë ndanë punës, me një dhëlpëri të hollë, bazuar në farefisnin dhe në emrat e tyre, kur u kthye në shtëpi, e vuri në punë plakën tërë ditën që të mos mund të vente te Andreuçi. Vetë thirri shërbyesën e saj, të cilën e kishte stërvitur mirë në të tilla dallavere dhe, ndaj mbrëmjes e dërgoi në bujtinën ku kishte rënë Andreuçi. Vashëza vajti aty dhe fatmirësisht e gjeti Andreuçin tek po rrinte vetëm te porta dhe e pyeti nëse ish brenda njëfarë Andreuçi. Kur ai i tha se ishte dora vetë, vajza e hoqi mënjanë dhe i tha:

- Zotëri, po të pranoni, një vendase bujare dëshironte të flasë me ju.

Kur dëgjoi fjalët e vajzës, Andreuçit iu duk vetja trim e i bukur dhe prandaj kjo grua qe dashuruar me të, sikur të mos kishte tjetër djalë të bukur në Napoli. Pa humbur kohë, iu përgjigj se ishte gati dhe e pyeti se kur dhe ku do të fliste me të kjo grua.

- Zotëri, - iu përgjigj kopilia, - po të keni qejf të veni, ajo ju pret në shtëpinë e saj.

Andreuçi, menjëherë, pa lënë fjalë në bujtinë, i tha:

- Shko përpara, se po të vij pas.

Kështu, kopilia e shpuri në shtëpinë e gruas, e cila banonte në një lagje që quhej "Vrimëkeqe". Se sa e fisme ishte kjo lagje, e tregonte vetë emri. Por ai, duke mos ditur gjë fare për këtë dhe duke mos dyshuar aspak, pandehte se vente në ndonjë vend shumë të ndershëm dhe te ndonjë grua e dashur. Duke vajtur pas kopiles, hyri me qetësi në shtëpinë e gruas. Aty, tek po ngjitej shkallëve dhe pasi kopilja i foli gruas e i tha ja Andreuçi, Andreuçit i zuri syri gruan që doli ta priste në krye të shkallëve.

Ajo ishte ende mjaft e re, trupmadhe e me fytyrë që i shkëlqente, e veshur dhe e stolitur si zonjë e madhe. Kur iu afrua Andreuçi, ajo iu turr me krahë hapur, duke zbritur tri shkallë njëherësh, e përqafoi fort e fort, qëndroi pak pa nxjerrë fjalë nga goja, si e penguar nga një mallëngjim i pakufishëm, pastaj, me lot në sy, e puthi në ballë dhe i tha më zë të ngashëryer:

- Mirë se erdhe Andreuçi im.

- Mirë se ju gjeta zonjë.

Ajo, pastaj, e mori prej dore dhe e shpuri lart në sallon. Së këtejmi, pa i thënë asnjë fjalë, e çoi në dhomën e saj që kundërmonte e tëra erë trëndafil, lule portokalli e aroma të tjera. Andreuçi pa në këtë dhomë një shtrat të shtruar e të mbuluar bukur, shumë tesha të varura në shule, sipas zakonit të atjeshëm, si dhe shumë sende të tjera të bukura e të vyera. Për të gjitha këto, si i ri që ishte në këto anë, iu mbush mendja se ajo qe një zonjë e madhe. Gruaja u ul bashkë me të mbi një arkë që ishte në fund të shtratit dhe filloi të fliste:

- Jam fare e sigurt, Andreuç, që ti u çuditë dhe nga përkëdheljet e mia dhe nga lotët që po derdh, se nuk më njeh dhe mbase s'më ke dëgjuar kurrë. Por ti tani do të çuditësh edhe më shumë kur të dëgjosh se unë jam jot motër dhe po të them se tani që desh Perëndia të shoh një nga vëllezërit e mi para se të vdes (sado që unë dëshiroj t'ju shoh të gjithëve), ndo e afërme, ndo e largët qoftë vdekja ime, unë do të vdes e gëzuar dhe, në s'e ke dëgjuar ndofta këtë, ja ku po ta them unë: Pjetri, ati im dhe yti, si besoj se do ta kesh dëgjuar, ka ndenjor në Palermo një kohë të gjatë. Për shpirtmirësinë e tij dhe për shkuarjen e mirë, të gjithë sa e njihnin, e kanë dashur fort dhe e duan edhe sot e gjithë ditën. Por, ndërmjet atyre të cilëve u kish hyrë shumë në zemër, ishte dhe ime më, që ishte një grua bujare e cila, pa marrë parasysh frikën e t'et e të vëllezërve dhe nderin e saj, u lidh kaq ngushtë me të, sa që linda unë dhe jam kështu si më sheh. Pastaj, nuk di për ç'arsye, Pjetri u largua nga Palermoja dhe shkoi në Peruxhia. Mua më la foshnje me t'ime më dhe, me sa kam dëgjuar, s'na kujtoi kurrë as mua as atë, prandaj, sikur të mos ta kisha baba, duhej ta qortoja shumë, duke parë mosmirënjohjen që tregoi ndaj s'ime mëje, pa marrë parasysh dashurinë që duhej të kishte për mua, që më kish bijë dhe që s'kisha pasur për nënë ndonjë shërbëtores ose ndonjë grua e aq. E gjora mëma ime, pa ditur fare se kush qe ai, e gudulisur nga një dashuri tepër besnike, i fali duarve të tij mallin dhe veten e saj.

- Po, ç'ta zgjasim, punët e bëra keq në të shkuarën është më lehtë të qortohen, sesa të rregullohen. Punët kështu ndodhin. Më la vajzë të vogël në Palermo dhe më rriti dhe më bëri kaq ime më, që ishte grua e pasur, dhe më martoi me një nga Agrixhento, njeri bujar e zemërbardhë, i cili, për t'i bërë qejfin s'ime mëje dhe mua, erdhi të banonte në Palermo, mirëpo këtu, si guelf⁶

⁶ Guelf - Përkrahës i papatit.

i flakët që ishte, zuri të hynte në marrëdhënie të fshehta me mbretin tonë, Karlin. Këto marrëdhënie, para se të mbaronin në ndonjë përfundim, ranë në vesh të mbret Frederikut. Për gjithë këto arsye u detyruam të arratiseshim nga Sicilia, në një kohë që shpresoja të isha zonja më e madhe që mund të ketë pasur ky ishull. Kështu, si morëm ato pak plaçka që mundëm (them pak ndaj plaçkës së shumtë që kisha), lamë pronat dhe pallatet dhe erdhëm në këtë vend ku mbreti Karl u tregua tepër mirënjohës kundrejt nesh dhe na shleu një pjesë të dëmeve që kishim pësuar për të. Ai na dha toka e shtëpi dhe i jep gjithnjë tim shoqi dhe yt kunati, gjithë gjërat e nevojshme, sikundër ke për ta parë, dhe ja tashti jam këtu, me ndihmën e Perëndisë dhe jo tënden, o vëlla i dashur, të jem e lumtur të të shoh ty.

Si tha këto, e përqafoi përsëri dhe, duke qarë me mallëngjim, e puthi në ballë.

Andreuçi, kur dëgjoji këtë përrallë të trilluar kaq bukur që kallëzoi me kaq mjeshtëri gruaja, e cila as e humbiste fjalën nga goja e as nuk belbëzonte, e pruri ndër mend që, me të vërtetë, babai i tij kish qenë në Palermo dhe, duke e ditur sesa e ndezur është djalëria për dashuri, dhe duke parë lotët e mallëngjyeshëm, përqafoi dhe puthjet e matura të gruas, i besoi të gjitha si të vërteta. Kur mbaroi gruaja, iu përgjigj:

- Nuk duhet t'ju duket gjë e tepërt, zonjë, që çuditim, meqenëse, me të vërtetë, im atë, kushedi për ç'arsye, s'ju ka prurë kurrë në gojë, ose edhe nëse ju ka përmendur ndonjëherë, unë s'e kam dëgjuar. Prandaj, nga ana ime, nuk ju di fare, sikur të mos kishit qenë, dhe e ndiej veten tepër të lumtur që po ju gjej këtu si motër, sidomos tani që gjendem vetëm dhe që po ju gjej papritur. Edhe sikur të isha një njeri me rëndësi të madhe, do të gëzohesha shumë nga ju, pa le që unë jam një tregtar i vogël. Por, një gjë vetëm ju lutem të më shkoqitni, si e keni marrë vesh që unë ndodhesha këtu?

- Më tha sot në mëngjes, - iu përgjigj ajo, - një grua e varfër e cila vjen dendur tek unë. Me sa më tha, ajo paskësh qenë për shumë kohë me babanë tonë në Palermo e në Peruxhia dhe do të kisha ardhur që më parë te ti, por m'u duk më e nderuar të vije ti tek unë në shtëpinë tënde, sesa të vija unë te ti në shtëpinë e botës.

Pas këtyre fjalëve zuri të pyeste me radhë për të gjithë farefisnin emër për emër. Andreuçi iu përgjigj çdo pyetjeje, duke besuar prej kësaj edhe më shumë, çka duhej të besonte më pak.

Meqenëse fjalët po zgjateshin dhe vapa ishte e madhe, gruaja dërgoi e solli verë greke dhe ëmbëlsira dhe i dha Andreuçit të pinte. Pas kësaj,

Andreuçi desh të ikte, pasi ish ora e darkës. Ajo nuk e mbajti fare, por duke bërë sikur ishte tronditur, i hodhi duart e i tha:

- Mjerë unë e mjera! Po e shoh shfaqur se s'të hëngërka fare malli për mua. Oh, sa e çuditshme është ta mendosh, të gjendesh në shtëpinë e sat motre që s'e kishe parë kurrë, ku duhej të shkarkoje me rastin e ardhjes sate këtu, dhe kërkon të ikësh për të bërë darkën në hotel. Ti sonte do ta bësh patjetër darkën këtu me mua dhe, ndonëse s'është im shoq, gjë që më hidhëron shumë, me sa të më jepet, si grua që jam, do të di të të bëj pak nder.

Andreuçi, duke mos ditur ç'përgjigje t'i jepte, i tha:

- Unë të dua sa mund të duhet një motër, por në qoftë se nuk vete në bujtinë, shokët kanë për të më pritur me darkë përpara dhe s'do të jetë sjellje e mirë nga ana ime të mos shkoj.

- Po pse, mos mendon ti se s'kam njeri unë ta dërgoj t'i lajmëroj që mos të të presin? Pa më mirë do të ishte, pas mendjes sime, t'u dërgoj haber edhe atyre të vinë e të hanë me ne. Në këtë mënyrë do të tregohesh shumë i njerëzishëm dhe do të kryeje një detyrë ndaj tyre. Si të bënim darkën, mund të shkoje me ta bashkë.

Andreuçi i tha se nuk donte që atë natë të vinin shokët. Sa për veten e tij, e linte në pëlqimin e saj që të rrinte a të mos rrinte, meqenëse asaj ia donte zemra. Ajo bëri sikur dërgoi një njeri në hotel për të lajmëruar shokët e tij që të mos e pritnin për darkë dhe, kështu, pas shumë bisedash të tjera, u ulën të hanin dhe u shërbyen në mënyrë të shkëlqyer më gjithfarë gjellësh. Ajo, gjatë darkës, e mbajti me fjalë të zgjatura qëllimisht gjersa kaloi një pjesë e natës. Kur u ngritën nga tryeza, Andreuçi desh të ikte, por ajo i tha se kjo gjë s'mund të bëhej kurrsesi, pasi Napoli, siç tha ajo, nuk ish një qytet ku njeriu mund të lëvizte natën, sidomos një i huaj. Siç tha se kishte dërguar të lajmëronte që shokët të mos e pritnin për darkë, kishte bërë dhe me bujtinën që të mos e pritnin për të fjetur.

Ai i besoi këto dhe, i gënjyer nga një besim i rremë, ndjeu kënaqësi të ishte me të dhe ndenji. Pas buke nisën prapë bisedime të shumta e të gjata, por, si shkoi një pjesë e madhe e natës, ajo la Andreuçin të flinte në dhomën e saj me një djalë të vogël që t'i tregonte, po të kishte nevojë për gjëkafshë, dhe vetë, bashkë me gratë e tjera, vajtën në një dhomë tjetër.

Si pa që mbeti vetëm dhe vapa ishte e madhe, Andreuçi, u zhvesh gjer në mes dhe pantallonat i nxori e i vuri në krye të shtratit. Më pas, kur e mori nevoja, pyeti djalin se ku ish nevojtorja. Ai i tregoi një derë në një qoshe të dhomës dhe i tha:

- Shkoni aty brenda.

Andreuçi hyri brenda pa frikë, por kur vuri këmbën në një dërrasë, ajo u shqye në anën e tejme dhe ra bashkë me të andej poshtë. Zoti e ndihmoi kaq shumë në të rënë sa nuk u vra fare, ndonëse u rrëzua nga një vend mjaft i lartë. U fëlliq i tëri me të pëgëra me të cilat qe mbushur ai vend. Që ta kuptoni më mirë atë që kam thënë dhe atë që do të them, do t'ju tregoj se si ishte ky vend. Në një sokak të ngushtë, si qëllon të shohim shpesh, midis dy shtëpive, ishin vendosur dy trarë që bashkonin një shtëpi me tjetrën. Aty ishin mbërthyer disa copa dërrasa dhe ishte bërë vendi për të qëndruar. Njëra nga këto dërrasa u shkëput e ra me gjithë Andreuçin.

Kur u gjet poshtë në sokak, Andreuçi, i hidhëruar nga fatkeqësia që i ndodhi, zuri të thërriste djalin, por ai, me të dëgjuar që ra, me të shpejtë vajti lajmëroi gruan. Kjo vrapoi te dhoma e tij dhe kërkoi të gjente petkat e tij dhe bashkë me to gjeti dhe paratë që Andreuçi, nga mosbesimi, i mbante me vete si budalla. Dhe, kur gruaja nga Palermoja i vuri në dorë ato të cilave u kish ngrehur grackën, duke u bërë motër e peruxhianit, s'ia vuri më veshin atij, por me të shpejtë vajti mbylli derën prej së cilës ai kish dalë kur ra.

Andreuçi thërriti djalin, por meqenëse ai nuk i përgjigjej, zuri të thërriste me të fortë, por më kot. Kur më vonë dyshoi dhe filloi të merrte vesh se ishte gënjyer, hipi mbi një mur të vogël, që ndante sokakun nga rruga, zbriti në rrugë dhe vajti te porta e shtëpisë të cilën e njohu fare mirë, thirri së këtejmi një copë herë, i ra portës dhe e shtyu. Porta nuk hapej. Tani që kishte filluar të shihte shquar fatkeqësinë e tij, zuri të thoshte duke qarë:

- Oh, qyqari unë, në sa pak kohë i paskam humbur pesëqind florinsat dhe një motër!

Dhe, pas shumë fjalësh të tjera, zuri nga e para t'i binte portës dhe të bërtiste aq tepër, sa shumë prej fqinjëve rrotull u zgjuan dhe u ngritën. Një prej shërbëtorëve të gruas doli në dritare si e përgjumur dhe tha me zemërim:

- Kush troket aty?

- Si, s'më njohke? Unë jam Andreuçi, vëllai i zonjës Fiordalizë.

- Në ke pirë shumë o i uruar, ik fli dhe eja nesër. Unë nuk e njoh këtë Andreuç as profkat që më thua ti. Shko, shiko punën dhe lërna të flemë, në ke besuar Perëndinë.

- Qysh, - tha Andreuçi, - nuk ditke se ç'po them unë? S'ka dyshim që e di, po në janë të këtillë kushërinjtë e Sicilisë që të harrohen në një kohë kaq të shkurtër, më jep së paku rrobat e mia që i kam lënë aty dhe do të shkoj me gjithë qejf të shikoj punën time.

- Më duket se ëndërron, - i tha ajo gati me të qeshur dhe sa të hapësh e të mbyllësh sytë u fut brenda dhe mbylli dritaren. Atëherë Andreuçi, i sigurt për dëmet që kishte pësuar, nga dëshpërimi, thajse e ndërroi në tërbim zemërimin e tij dhe vendosi t'ia merrte me përdhunë ato që s'mund t'i merrte me fjalë. Mori një popël të madh dhe zuri t'i binte portës me egërsi, duke e goditur me shumë forcë. Nga ky shkak, shumë prej fqinjëve, që ishin zgjuar dhe ngritur që më parë, duke pandehur se ky do të ish ndonjë njeri i bezdisshëm, i cili këto fjalë i shpifte me qëllim që të shqetësonte gruan e mirë, të mërzhitur edhe nga të trokiturat e tij, dolën nëpër dritare, dhe mu si qentë e një lagjeje që i turren duke lehur një qeni të huaj, zunë t'i thoshin:

- Të vish në këtë orë në shtëpinë e grave të nderhme dhe të thuash këto profka, është një fyerje e madhe. Të lutemi, shko shiko punën tënde. Zot i mirë, lërna të flemë, në ke besuar Perëndinë. Në ke ndonjë gjë me të, eja nesër dhe mos na çaj kokën sonte.

Si mori zemër ndofta nga këto fjalë, një burrë që ishte brenda në shtëpi, si kodosh i gruas së mirë, të cilin Andreuçi as e kish parë e as e kish dëgjuar, doli në dritare dhe me një zë të trashë, të tmerrshëm dhe të egër, tha:

- Kush është aty te porta?

Andreuçi, kur dëgjoi këtë zë, ngriti kryet dhe pa këtë njeri me mjekër të zezë e të dendur, i cili, me sa mund të kuptohej, dukej se do ish me shumë rëndësi dhe, sikur të ishte ngritur nga shtrati ose nga gjumi i rëndë, gogësinte dhe fërkonte sytë. Andreuçi iu përgjigj me frikë në zemër:

- Unë jam vëllai i gruas që është aty brenda.

Por, pa pritur që Andreuçi të mbaronte përgjigjen, ai i foli me një egërsi më të madhe së më parë:

- Në të ardhsha dot aty, kam për të ta bërë kurrizin më të butë se barkun, gomar i mërzhitshëm dhe dejmarak i keq që s'na le të flemë, - hyri brenda dhe mbylli dritaren.

Disa prej fqinjëve që e njihnin mirë çfarë kriminel i lig ishte ai njeri, i folën Andreuçit me të mirë dhe i thanë:

- Në ke besuar Perëndi, zot i mirë, shko shiko punën, mos u bëj shkak të të vrasë sonte mu aty, shko për të mirën tënde.

Kështu, Andreuçi, i tmerruar nga zëri dhe pamja e tij dhe i shtyrë nga këshillat e fqinjëve që dukej se u vinte keq për të, me pikëllim të thellë në zemër dhe i dëshpëruar për humbjen e parave, pa ditur se ku shkonte, mori rrugën për të vajtur në bujtinë nga ajo anë nga ku një ditë më parë kish ndjekur gjurmët e shërbëtores. Meqenëse i vinte ndot nga era e qelbur

që kishte, me qëllim që të shkonte të lahej në det, mori krahun e mëngjër dhe mori një rrugë që quhej “Rruga Katalane”, por duke shkuar përpjetë qytetit, pa për fat që po vinin kundrejt tij dy veta me një fener në dorë. Duke pasur frikë se mos këta ishin agjentë të policisë, ose njerëz keqbërës, që t’u shpëtonte, qetazi e qetazi u fut në një haur që ndodhej aty pranë. Por, ata, sikur të ishin nisur drejt për në atë vend, hynë po në atë haur dhe njëri prej tyre, si shkarkoi disa hekurishte që kishte në krah, zuri t’i vështronte bashkë me tjetrin, duke biseduar për to. Ndërsa po bisedonin, njëri prej tyre tha:

- Ç’është kështu? Këtu ndiej një erë të qelbur që s’e kam ndier kurrë, - dhe, si tha këto, duke ngritur pak fenerin pa të mjerin Andreuç. Mbetën të habitur dhe e pyetën:

- Kush je ti aty?

- Andreuçi nuk bëri fare zë, por ata iu afruan me dritë dhe e pyetën se përse rrinte aty ashtu i fëlliqur. Andreuçi ua kallëzoi gjithë ç’kishte ngjarë. Ata, duke marrë me mend se ku mund t’i kish ndodhur ajo fatkeqësi, thanë midis tyre “sigurisht në shtëpinë e Brumbull Zjarrhedhësit”. Njëri iu drejtua dhe i tha:

- Megjithëqë humbe paratë, zot i mirë, duhet t’ia dish shumë për nder Zotit që të qëlloi të bije poshtë dhe të mos mund të ktheheshe më brenda, se po të mos kishe rënë, të jesh i sigurt se do të të kishin vlarë sapo të të zinte gjumi dhe, bashkë me të hollat, do të kishe humbur edhe jetën. Sa pará bën tani të qash? Me sa mund të kapësh yjet e qiellit, aq mund të hedhësh prapë në dorë paratë që humbe dhe, po të dëgjoji ai burri ta marrësh nëpër gojë, me siguri ka për të të vlarë.

Pas këtyre fjalëve, u morën vesh midis tyre dhe i thanë:

- Neve na vjen keq për ty, prandaj, po të duash të vish me ne në një punë për të cilën jemi nisur, jemi fare të sigurt se do të të bjerë një shumë tepër më e madhe nga ajo që ke humbur.

Andreuçi, si i dëshpëruar që ishte, u përgjigj se ishte gati.

Atë ditë ishte varrosur arkipeshkvi i Napolit, i quajtur Imzot Filip Minutoli, të cilin e kishin varrosur me gjëra shumë të çmuara dhe me një rubin në gisht që vlente më shumë se pesëqind florinsa ari. Ata donin të venin ta plaçkitnin imzotin e përmendur dhe qëllimin e tyre ia thanë Andreuçit. Kështu, ky, i shtyrë më tepër prej lakmisë se prej arsyes, u vu bashkë me ta në udhëtim, por, duke vajtur drejt “Kishës së Madhe”, meqenëse Andreuçi kutërbonte, njëri prej tyre tha:

- Nuk mund të gjejmë mënyrën të lahet pak ky që të mos qelbet kaq shumë?

- Po, - tha tjetri, - këtu afër është një pus në të cilin gjendet përherë çikriku dhe një kovë e madhe. Të vemi aty dhe ta lajmë shpejt e shpejt.

Kur arritën te pusi, litarin e gjetën në vend, por kova që hequr, kështu, vendosën ta lidhnin me litar Andreuçin dhe ta lëshonin në pus të lahej. Si të mbaronte së lari, ta tundte litarin që ta ngrinin përpjetë. Kështu bënë.

Tek po e lëshonin në pus, qëlloi të vinin aty për të pirë ujë disa xhandarë të qeverisë, të cilët i kishte marrë etja ose nga vapa, ose pse kishin ndjekur ndofta ndonjë. Të dy kusarët, sapo i panë, me të shpejtë ua dhanë këmbëve, po xhandarët nuk e vunë re këtë.

Andreuçi, si u la mirë e mirë në fund të pusit, lëvizti pakëz litarin. Xhandarët të etur, mbështetën përdhe mburojat, armët e gunat e tyre dhe zunë të nginin litarin, duke pandehur se në të ish lidhur kova me ujë.

Andreuçi, posa pa që iu afrua buzës së pusit, lëshoi litarin dhe kërceu mbi pus. Xhandarët u llahtarisen dhe, pa nxjerrë fare zë, ia ngrehën vrapit me sa mundën. Andreuçi mbeti pa mend nga kjo pamje dhe, sikur të mos që mbajtur mirë, do të kish rënë prapë në fund të pusit dhe do të ish shembur e do të kish vdekur fare. Por, prapë, si doli dhe gjeti këto armë, të cilat ishte i sigurt se s'ishin të shokëve të tij, u çudit edhe më shumë. Por, i trembur dhe pa ditur se ç'të bënte, duke u ankuar për fatin e tij, pa prekur gjë me dorë, vendosi të ikte dhe filloi të ecte pa ditur se ku vente.

Tek po ecte kështu, takoi të dy shokët e tij që vinin ta nxirrnin nga pusi. Ata, kur e panë, mbetën me gojë hapur dhe e pyetën se kush e kishte nxjerrë nga pusi. Andreuçi iu përgjigj se nuk e dinte dhe iu tregoi me radhë se ç'i kish ndodhur si dhe për ato që kish gjetur jashtë pusit. Nga këto ata e morën me mend se si kish ndodhur puna dhe i treguan me të qeshur se përse kishin ikur dhe se cilët kishin qenë ata që e kishin nxjerrë nga pusi. Pastaj, i prenë fjalët dhe, pasi ishte mesi i natës, vajtën te "Kisha e Madhe", hynë brenda pa ndonjë pengim dhe arritën tek arka e madhe që ishte prej mermeri. Me një levë që kishin sjellë me vete, e ngritën kapakun e rëndë, aq sa mund të hynte një njeri dhe i vunë një kunj për ta mbajtur të hapur. Pas kësaj, njëri prej tyre, tha:

- Kush do të hyjë brenda?

- Unë jo, - tha njëri.

- As unë, - tha tjetri, - le të hyjë Andreuçi.

- Këtë s'mund ta bëj unë, - tha Andreuçi.

Atëherë, iu drejtuan të dy bashkë dhe i thanë:

- Si nuk hyn? Për Zotin e vërtetë, sikur të mos hysh, do të kemi për të të dhënë kaq të goditura kokës me këtë hekur, sa të biesh plasur i vdekur përdhe.

Andreuçi hyri nga frika, por duke hyrë, tha me vete: “Këta më futin këtu që të më gënjejnë, se, si t’u kem dhënë të gjitha gjërat, sa të përpiqem të dal unë nga arka, kanë për të krisur e ikur dhe unë kam për të mbetur duarthatë”. Prandaj vendosi ta hiqte mënjane pjesën e tij. I ra ndër mend për unazën e çmuar për të cilën kishin bërë fjalë shokët e tij dhe, posa zbriti, ia hoqi unazën arkipeshkvi nga gishti dhe e vuri në gishtin e tij, pastaj, si u dha stapin, mitrën dhe dorezat, dhe si e zhveshi të vdekurin gjer në këmishë, të gjitha gjërat ua dha atyre dhe u tha se s’kishte gjë tjetër.

Ata ngulën këmbë se duhej të ish unaza dhe i thanë që të kërkonte nga të gjitha anët, por Andreuçi u përgjigjej se nuk e gjente dhe bënte sikur po kërkonte duke i mbajtur shokët në këmbë për një copë herë. Kusarët që ishin tinëzakë jo më pak se ai, i thanë të kërkonte prapë mirë dhe gjetën rastin e hoqën kunjin që mbante të ngritur kapakun e arkës dhe krisën e ikën, duke e lënë të mbyllur brenda në arkë.

Kur dëgjoi këtë, Andreuçi, e mori me mend se ç’ndodhi. Shumë herë provoi me kokë e me shpatulla ta ngrinte kapakun, por mundohej kot. I mundur nga hidhërimi i madh, i ra të fikët mbi trupin e vdekur të arkipeshkvi. Sikur t’i shihte njeri në atë kohë, me vështirësi do mund të dallonte se kush ishte i vdekuri, arkipeshkvi apo ai. Por, kur u përmend, ia dha një të qari me ngashërim, pasi e shihte veten që do të arrinte patjetër në një prej këtyre përfundimeve: ose s’do ta shihte njeri që t’ia hapte kapakun dhe do të vdiste brenda nga uria e nga kutërbimi midis krimbave të kufomës, ose do vente njeri ta gjente brenda dhe do ta varnin si kusar.

Duke qenë me të tilla mendime dhe tepër i dëshpëruar, dëgjoi njerëz që ecnin nëpër kishë dhe zëra të shumtë. Me sa i hante mendja edhe këta venin të bënin atë që kishte bërë ai me shokët e tij më parë dhe kjo ia shtoi edhe më shumë frikën. Pasi ata hapën arkën dhe i vunë kunjin, ranë në kundërshtim se kush të hynte, sepse asnjë nuk donte. Megjithatë, pas shumë kundërshtimesh, një prift tha:

- Ç’frikë keni? Mos trembeni se mos ju hajë? Të vdekurit nuk i hanë kurrë të gjallët. Do të hyj vetë dhe, me të thënë këtë, mbështeti gjoksin te buza e arkës, e ktheu kokën së jashtmi dhe brenda futi këmbët për të kërcyer poshtë.

Kur Andreuçi pa këtë, u ngrit, e kapi prej një këmbe edhe bëri sikur ta tërhiqte poshtë. Prifti lëshoi një klithmë si oshtimë dhe më njësh kërcëu

jashtë. Kjo skenë u dha datën të gjithë të tjerëve të cilët, duke lënë arkën hapur, ia ngrehën vrapit sikur t'i ndiqnin pas një qind mijë djaj. Kur pa këtë gjë Andreuçi, i gëzuar aq sa s'ia priste mendja, kërceu me të shpejtë dhe doli jashtë arkës, duke marrë rrugën prej së cilës kishte ardhur në kishë.

Aty, ndaj të gdhirë, duke ecur tej e këtej me unazën në gisht, arriti ndanë detit e s'andejmi u gjend në bujtinë ku gjeti shokët e tij dhe të zonë e bujtinës. Ata kishin qenë të shqetësuar tërë natën për shkakun e tij. Kur u tregoi se ç'kishte ndodhur, i zoti i bujtinës e këshilloi të largohej sa më parë nga Napoli. Andreuçi e dëgjoi dhe iku menjëherë. Kur u kthye në Peruxhia, pati si kapital një unazë, në vend të një kali.

Dita e dytë, rrëfenja e gjashtë

Zonja Beritola, pasi humbet dy bij, gjendet në një ishull ku dikush e gjen me dy kaproj të vegjël dhe e shpie në Lunixhianë. Këtu, njëri prej bijve i panjohur prej së ëmës, hyn në shërbim të të zotit të saj, dashurohet me të bijën e tij e bie në burg. Ndërkohë Sicilia ngre krye kundër mbretit Karl, e ëma njih të birin që martohet me të bijën e të zotit të saj dhe njëkohësisht gjendet dhe biri tjetër. Të gjithë kthehen të lumtur në shtëpinë e tyre.

Si vashat, ashtu dhe trimat ishin shqyer së qeshuri me ndodhitë e Andreuçit që kishte treguar Fjameta. Kur Emilia pa se rrëfenja mori fund, sipas urdhrin të mbretëreshës, mori fjalën:

Lëvizjet e shpeshta të fatit janë të dhimbshme dhe shqetësuese. Megjithëkëtë, duke ditur se po t'i dëgjojmë përherë na zgjohet mendja e mpirë nga përkëdheljet e tij, mendoj se kallëzimi i këtyre ndryshimeve është i nevojshëm si për të lumturit, ashtu dhe për të mjerët, sepse të parët i bën të kenë mendjen dhe të dytët i ngushëllon. Prandaj, sado që gjer tani janë treguar plot ngjarje prekëse, dua t'ju kallëzoj edhe unë një tjetër që është sa e vërtetë, aq dhe e dhimbshme. Sado që përfundimi është i gëzueshëm, s'më bëhet të besoj se hidhërimin e madh e të zgjatur të saj do ta ketë zbutur ndopak përfundimi i gëzueshëm.

Duhet të dini, fort të dashura shoqe, se pas vdekjes së perandorit Frederiku II, u kurorëzua mbret i Sicilisë Manfredi. Ky mbante në shkallë shumë të lartë një burrë fisnik nga Napoli, të quajtur Arriget Kapaçe, që kishte për grua